

**KOMPETENCA DIGJITALE E MËSIMDHËNËSVE  
DHE PËRFSHIRJA NË TEKSTET  
SHKOLLORE**





**KOMPETENCA DIGJITALE E  
MËSIMDHËNËSVE DHE PËRFSHIRJA  
NË TEKSTET SHKOLLORE**

Prishtinë, 2023

## **Niveli i kompetencës digjitale te mësimeve dhe përfshirja e saj në programet e zhvillimit profesional të mësimeve**

### **Autorët e studimit:**

Haxhere Zylyfi

Sahare Reçica-Havolli

Bekim Morina

## **Përfshirja e kompetencës digjitale në tekstet shkollore të lëndës Shkathësi për jetë (klasat 1 - 5)**

### **Autore e studimit:**

Arbnesha Mexhuani

### **Botues:**

Instituti Pedagogjik i Kosovës

### **Për botuesin:**

Ismet Potera, zv. drejtor

### **Këshilli Shkencor i IPK-së:**

Prof. asoc. dr. Hatixhe Ismajli

Prof. asoc. dr. Naser Zabeli

Prof. asoc. dr. Linda Grapci

### **Korrektues gjuhësor:**

Bekim Morina

### **Përgatitja teknike:**

Skender Mekolli

### **Shtypi:**

Shtypshkronja “Blendi”, Prishtinë

## **Përmbajtja**

Lista e tabelave.....	5
Lista e figurave.....	7
Lista e shkurtesave .....	8
Parathënie.....	9
<b>NIVELI I KOMPETENCËS DIGJITALE TE MËSIMDHËNËSIT DHE PËRFSHIRJA E SAJ NË PROGRAMET E ZHVILLIMIT PROFESIONAL TË MËSIMDHËNËSVE .....</b>	<b>11</b>
Abstrakt.....	13
Hyrje.....	14
1.1. Konteksti teorik.....	17
II. Metodologjia .....	38
2.1. Modeli i hulumtimit .....	38
2.2. Popullacioni dhe mostra.....	38
2.4. Procedura e mbledhjes dhe analizës së të dhënave .....	41
III. Rezultatet e studimit .....	41
3.1. Niveli i kompetencave digjitale te mësimdhënësit e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët (klasat 1- 9) karshi kërkesave të Kornizës referuese DigCompEdu.....	42
3.2. Qëndrimet e mësimdhënësve për përdorimin e teknologjive digjitale në praktikat e tyre të mësimdhënies .....	58
3.3. Përfshirja e kompetencës digjitale në programet e ZHPM-së, të akredituara në MASHTI në vitet e fundit .....	62
IV. Diskutimi i rezultateve .....	79
4.1. Kompetencat digjitale te mësimdhënësit e arsimit parauniversitar në Kosovë, karshi kërkesave të Kornizës DigCompEdu.....	79
V. Përfundime dhe rekomandime .....	89
5.1. Përfundime .....	90
5.2. Rekomandime .....	95
Referencat: .....	99

<b>PËRFSHIRJA E KOMPETENCËS DIGJITALE NË TEKSTET SHKOLLORE TË LËNDËS SHKATHTËSI PËR JETË (KLASAT 1-5) .....</b>	<b>103</b>
Abstrakt.....	105
Hyrje.....	106
Konteksti teorik.....	107
Metodologjia.....	115
Qëllimi i hulumtimit .....	115
Modeli i hulumtimit.....	115
Rezultatet .....	117
I. Përfshirja e kompetencës digjitale në kapitujt e teksteve shkollore të lëndës shkathtësi për jetë (klasat 1- 5).....	117
1.1. Libri Shkathtësi për jetë i klasës së parë .....	117
1.2. Libri Shkathtësi për jetë i klasës së dytë .....	117
1.3. Libri Shkathtësi për jetë i klasës së tretë .....	118
1.4. Libri Shkathtësi për jetë i klasës së katërt.....	119
1.5. Libri Shkathtësi për jetë i klasës së pestë.....	122
II. Shpërndarja e kompetencave digjitale në përmbajtjet e teksteve shkollore të klasave (1 -5).....	126
III. Kultivimi i kompetencës digjitale në tekstet shkollore dhe përputhshmëria e tyre me kërkesat digjitale të kornizës evropiane për qytetarë (digcomp 2.1) .....	134
Diskutim i rezultateve .....	136
Përfundim.....	142
Rekomandime .....	143
Literatura:.....	145
Shtojcat.....	148

## Lista e tabelave

<i>Tabela 1</i>	<i>Programet e akredituara sipas viteve, të prezantuara në katalogë</i>	<i>15</i>
<i>Tabela 2</i>	<i>Korniza e përgjithshme e fushave dhe standardeve të profesionit/ kompetencave të përgjithshme për ZhPM</i>	<i>27</i>
<i>Tabela 3</i>	<i>Fushat dhe kompetencat përkatëse të Kornizës DigCompEdu</i>	<i>30</i>
<i>Tabela 4.</i>	<i>Nivelet e arritjes sipas fushave të DigComEdu</i>	<i>33</i>
<i>Tabela 5.</i>	<i>Progresi dhe deklaratat e niveleve të arritjes për kompetencën Komunikimi organizativ</i>	<i>34</i>
<i>Tabela 6</i>	<i>Struktura e mostres sipas specifikave përkatës</i>	<i>39</i>
<i>Tabela 7</i>	<i>Perceptimet e mësimeve për kompetencën digjitale – Paratesti</i>	<i>43</i>
<i>Tabela 8</i>	<i>Mesataret e rezultateve sipas fushave të DigCompEdu</i>	<i>44</i>
<i>Tabela 9</i>	<i>Analiza Independent Samples Test dhe signifikanca në dallime statistikore</i>	<i>46</i>
<i>Tabela 10</i>	<i>Mesataret e vetëvlerësimit sipas fushave kurrikulare</i>	<i>46</i>
<i>Tabela 11</i>	<i>Mesataret e vetëvlerësimit sipas përvojës së punës</i>	<i>47</i>
<i>Tabela 12</i>	<i>Mesatarja dhe devijimi standard per nëntë kërkesat/deklaratat e fushës së parë</i>	<i>48</i>
<i>Tabela 13</i>	<i>Mesatarja dhe devijimi standard per nëntë kërkesat/deklaratat e fushës së dytë</i>	<i>50</i>
<i>Tabela 14</i>	<i>Mesatarja dhe devijimi standard per nëntë kërkesat/deklaratat e fushës së tretë</i>	<i>51</i>
<i>Tabela 15</i>	<i>Mesatarja dhe devijimi standard per nëntë .15 kërkesat/deklaratat e fushës së katërt</i>	<i>53</i>
<i>Tabela 16</i>	<i>Mesatarja dhe devijimi standard per nëntë . kërkesat/deklaratat e fushës së pestë</i>	<i>54</i>
<i>Tabela 17</i>	<i>Mesatarja dhe devijimi standard per nëntë kërkesat/deklaratat e fushës së gjashtë</i>	<i>56</i>

<i>Tabela 18</i>	<i>Perceptimet e mësimdhënësve për kompetencën digjitale - paratesti</i>	<i>57</i>
<i>Tabela 19</i>	<i>Opinionet e mësimdhënësve për përdorimin e teknologjive dhe burimeve digjitale</i>	<i>59</i>
<i>Tabela 20</i>	<i>Opinionet e mësimdhënësve për kushtet ekzistuese për zbatimin e mjeteve dhe përmbajtjeve digjitale</i>	<i>60</i>
<i>Tabela 21</i>	<i>Lista e programeve të akredituara për zhvillimin e TIK-ut - 2021</i>	<i>63</i>
<i>Tabela 22</i>	<i>Lista e programeve të akredituara për zhvillimin e TIK-ut - 2022</i>	<i>69</i>
<i>Tabela 1</i>	<i>Fushat e kompetencës digjitale të Kornizës Evropiane (DigComp 2.1) dhe kompetencat specifike</i>	<i>110</i>
<i>Tabela 2</i>	<i>Shpërndarja e kompetencave digjitale në tekste shkollore të lëndës Shkathtësi për jetë (klasat 1 dhe 2)</i>	<i>126</i>
<i>Tabela 3</i>	<i>Shpërndarja e kompetencave digjitale në tekste shkollore të lëndës Shkathtësi për jetë (klasat 3, 4, 5)</i>	<i>131</i>
<i>Tabela 4</i>	<i>Fushat e Kompetencës digjitale të Kornizës Evropiane për Qytetarët (DigComp 2.1), të përfshira në tekstet shkollore të lëndës Shkathtësi për jetë (klasat 1 - 5).</i>	<i>136</i>

## Lista e figurave

Figura 1	<i>TPACK: Technological Pedagogical Content Knowledge Framework.</i>	20
Figura 2	<i>Niveli i kompetencave të mësimdhënësve për pesë fushat e DigCompEdu</i>	45
Figura 3	<i>Niveli i kompetencave të mësimdhënësve për fushën e parë - Angazhimi profesional</i>	49
Figura 4	<i>Niveli i kompetencave të mësimdhënësve për fushën e dytë</i>	50
Figura 5	<i>Niveli i kompetencave të mësimdhënësve për fushën e tretë - Mësimdhënia dhe të nxënit</i>	52
Figura 6	<i>Niveli i kompetencave të mësimdhënësve për fushën katërt - Vlerësimi</i>	53
Figura 7	<i>Niveli i kompetencave të mësimdhënësve për fushën e pestë - Fuqizimi i nxënësve</i>	55
Figura 8	<i>Niveli i kompetencave të mësimdhënësve për fushën e gjashtë - Lehtësimi i kompetencës digjitale të nxënësve</i>	56
Figura 9	<i>Nivelet e perceptimeve për kompetencat digjitale para dhe pas testit</i>	58
Figura 10	<i>Përdorimi i teknologjive digjitale nga mësimdhënësit e vetëvlerësuar</i>	59
Figura 11	<i>Përdorimi i teknologjisë digjitale nga mësimdhënësit e vetëvlerësuar</i>	81
Figura 12	<i>Përdorimit të teknologjive digjitale për të avancuar praktikat e mësimdhënies</i>	83

## **Lista e shkurtesave**

<b>AF</b>	Arsimi Fillor
<b>AMU</b>	Arsimi i Mesëm i Ulët
<b>DKA</b>	Drejtoria Komunale e Arsimit
<b>IPK</b>	Instituti Pedagogjik i Kosovës
<b>MASHTI</b>	Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit
<b>OECD</b>	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
<b>PISA</b>	Programi Ndërkombëtar për Vlerësimin e Nxënësve
<b>RNK</b>	Rezultatet e të nxënit për kompetenca
<b>RNL/T</b>	Rezultatet e të nxënit të lëndës/temës mësimore
<b>RNSh</b>	Rezultatet e të nxënit të shkallës për fusha kurrikulare
<b>SMIA</b>	Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim
<b>ShFMU</b>	Shkolla Fillore dhe e Mesme e Ulët
<b>TIK</b>	Teknologji e Informimit dhe Komunikimit
<b>UNICEF</b>	Fondi i Emergjencës i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
<b>ZhPM</b>	Zhvillimi profesional i mësimeve

## **Parathënie**

Studimi lidhur me kompetencën digjitale te mësimitdhënësist, përfshirja e saj në programet e zhvillimit profesional të mësimitdhënësve dhe adresimi në tekstet shkollore, është në vazhden e studimeve të IPK-së, por më i veçantë sa i përket kontekstit të tij. Ky studim, të cilin po e paraqesim para lexuesve dhe studiuesve të kësaj fushe, është një kontribut modest në këtë drejtim.

Organizimi i Konferencës, me përmbajtje dedikuar një fushe të rëndësishme, po bëhet tradicional, siç është aftësia e mësimitdhënësve për përdorimin dhe zbatimin e teknologjisë në mësimitdhënie, por edhe aftësimi i nxënësve për shfrytëzimin e saj në gjetjen dhe shfrytëzimin e burimeve mësimore.

Kosova ka një nivel të lartë të qasjes në burimet digjitale, sidomos në internet, prandaj, duke u ndërlidhur me këtë fakt, qëllimi i studimit të hulumtuesve të IPK-së ishte eksplorimi i nivelit të shkathtësive të mësimitdhënësve për përdorimin e saj, si dhe adresimi i kësaj kompetence në tekstet shkollore.

Epoka digjitale sot është bërë domosdoshmëri dhe përditshmëri, thuajse në të gjitha portet e jetës, në sistemin arsimor sidomos, prandaj edhe studimi dhe konferenca janë moment i veçantë për adresimin e kësaj kërkese.

Mësimitdhënësi, si ndërmjetësues dhe lehtësues ndërmjet programit arsimor dhe nxënësit, është më i sfiduari sot. Në një rën anë zhvillimi i hovshëm i teknologjisë, si dhe brezi i ri i nxënësve me shkathtësi të larta për përdorimin e teknologjisë në anën tjetër. Këtë sfidë është bërë përpjekje ta zbusim nëpërmjet programeve të zhvillimit profesional, si dhe përfshirjes së këtij komponenti në përmbajtjet shkollore. Këto dy aspekte u trajtuan në studim. Qasja studimore është në përputhje me Kornizën Evropiane të Kompetencës Digjitale të Këshillit të Evropës.

Disa të dhëna me interes sjell analiza e teksteve shkollore Jeta dhe puna, të cilat kanë një bazament të adresimit të çështjes së aftësimit të nxënësve për përdorimin dhe zbatimin në praktikë të kësaj kompetence.

Studimi ofron të dhëna të mira për studiuesit dhe hartuesit e politikave arsimore në vend.



Haxhere Zylfiu, Sahare Reçica-Havolli,  
Bekim Morina

**NIVELI I KOMPETENCËS DIGJITALE TE MËSIMDHËNËSIT DHE  
PËRFSHIRJA E SAJ NË PROGRAMET E ZHVILLIMIT  
PROFESIONAL TË MËSIMDHËNËSVE**

Prishtinë, 2023



# **Niveli i kompetencës digjitale te mësimeve dhe përfshirja e saj në programet e zhvillimit profesional të mësimeve**

## **Abstrakt**

*Në nivel botëror, zhvillimet e hovshme teknologjike konsiderohen si “Revolucioni i katërt industrial”. Mënyra e vetme për t’u përshtatur me kërkesat ndodh nëpërmjet zhvillimit të kompetencës digjitale, përfshirë edhe fushën e arsimit. Korniza Evropiane e Kompetencave Digjitale për Mësimdhënësit DigCompEdu (Komisionit Evropian, 2017) synon që të mbështesë përpjekjet e shteteve për të zhvilluar këto kompetenca te qytetarët e tyre dhe të nxisë inovacionin në arsim, duke ofruar një kornizë të përbashkët referimi. Kosova, në politikat strategjike të fushës së arsimit, ka paraparë përfshirjen e kësaj kornize në proceset e zhvillimit të kompetencës digjitale te mësimeve, por jo vetëm.*

*Qëllimi i studimit ishte të identifikojë dhe të pasqyrojë nivelin e kompetencave digjitale te mësimeve karshi kërkesave të Kornizës, si dhe gjendjen, nevojat dhe mundësitë e zhvillimit të këtyre kompetencave përmes programeve të trajnimit.*

*Studimi është realizuar përmes qasjes hulumtuese të kombinuar (mikse), modelit përshkrues dhe vlerësues. Është bazuar në analizën e literaturës relevante, në vetëvlerësimin e mësimeve përmes instrumentit të Komisionit Evropian SELFIEforTEACHERS, si dhe në shqyrtimin e programeve të akredituara dhe të publikuara në dy katalogët e fundit. Pjesëmarrës në studim ishin 445 mësimeve, të nivelit 1-9, nga shtatë rajonet e Kosovës. Përpunimi i të dhënave cilësore është bazuar në modelin e prezantuar nga Satu Elo (2014), ndërsa i të dhënave sasiore është bërë me paketën statistikore SPSS 21.*

*Rezultatet treguan se vetëvlerësimi në 22 kompetencat e Kornizës DigCompEdu, me shkallë vlerësimi sipas CEFR A1/fillestar deri në C2/pionier, ka pasqyruar nivel të kompetencave digjitale të mësimeve me  $M=2.64$  ( $D.St.=1.4$ ). Ky rezultat është nën mesataren e arritjeve për të gjitha aftësitë e përshkruara në deklaratën e EU-së për kompetencat digjitale, madje qëndron jo mirë në raport me aftësitë që ndërlidhen me krijimin, zgjidhjen e problemeve, mendimin kritik, krijues etj. Janë 36 (23+13) programe të trajnimit të akredituara për ZhPM, të cilat ndërlidhen me fushën e TIK-ut. Ka një mospërputhje në mes të nivelit të kompetencave të mësimeve sipas vetëvlerësimit me nivelin dhe fushat që programet e akredituara synojnë të zhvillojnë. Nevojiten hulumtime vijuese për të parë nga afër pse kjo mospërputhje.*

*Gjetjet e studimit pritet të mbështesin institucionet përgjegjëse për të avancuar kompetencën digjitale të mësimeve në të ardhmen.*

**Fjalët çelës:** Kompetencë digjitale, vetëvlerësim, matje, katalog, mësimeve

## Hyrje

Në dekadën e fundit, zhvillimet në sistemin e arsimit parauniversitar në Kosovë kanë qenë të orientuara drejt përcjelljes së trendëve të zhvillimit të vendeve të rajonit dhe më gjerë, përfshirë edhe fushën e përdorimit të teknologjisë së informacionit, në funksion të përmirësimit të cilësisë në arsim.

Përpjekjet e bëra në këtë drejtim, kryesisht, janë ndërlidhur me investimet në infrastrukturë (qasje në internet dhe pajisje të IT-së), në digjitalizimin e shërbimeve, si dhe në zhvillimin e kompetencës për përdorimin e kësaj infrastrukture nga aktorët përkatës, përfshirë edhe mësimdhënësit.

Megjithatë, analiza e zhvillimeve në fushën e arsimit, e prezantuar në dokumentin Strategjia e Arsimit 2022-2026 (MASHTI, 2022), ofron të dhëna mjaft të rëndësishme, por jo edhe aq të favorshme sa i përket përdorimit të teknologjisë digjitale në arsimin parauniversitar në Kosovë.

Janë dy elemente të veçuara për këtë aspekt: (i) *mungesa e theksuar e mekanizmave institucionalë dhe e personelit të nevojshëm për planifikim dhe realizim të digjitalizimit* në fushën e arsimit dhe për nxitjen e aftësimin e palëve për përdorimin e teknologjisë digjitale për nevoja arsimore; (ii) mungesa e vlerësimeve lidhur me zotërimin e *kompetencës digjitale* të kategorive të ndryshme, që prek sistemi i arsimit, përfshirë edhe mësimdhënësit (Strategjia, f. 45-47).

Zhvillimi profesional i mësimdhënësve në shërbim (ZhPM), si komponentë e sistemit të licencimit, në të gjitha planifikimet strategjike paraprake të MASHTI-t, ka qenë fushë prioritare e intervenimit. Megjithatë, ky komponent vazhdon të sfidohet në pjesën e përmbushjes së kërkesave dhe kritereve të vendosura. Vitet e fundit, përfshirja e mësimdhënësve në programe të zhvillimit profesional ka rënë në mënyrë të vazhdueshme. Raportet tregojnë se shkalla e përfshirjes së mësimdhënësve në zhvillim profesional në vitin 2019 ishte 24.70 % e numrit të përgjithshëm të mësimdhënësve dhe dukshëm më e ulët sesa në vitin 2015 (54%). Në vitet 2020 dhe 2021, vlerësohet që kjo përfshirje të jetë edhe më e ulët, për shkak të rrethanave të krijuara nga pandemia COVID 19 dhe pamundësive për të

organizuar trajnime dhe aktivitete të tjera të ZhP me prezencë fizike (Buleshkaj, 2021).

Modeli ekzistues i zhvillimit profesional të mësimit në Kosovë është i bazuar kryesisht në programet e trajnimit që ofrohen nga institucione dhe ofertues të ndryshëm, të cilët përzgjidhen në bazë të kriterëve të përcaktuara nga MASHTI. Programet e trajnimit për mësimit përbëjnë një përpjekje për të plotësuar nevojat praktike të mësimit për zhvillim profesional dhe për zbatim të reformës kurrikulare. Ato prezantohen në Katalogun që publikohet nga MASHTI dhe shpeshherë janë pjesë e debateve institucionale për mbulueshmërinë e kërkesave dhe nevojave të mësimit dhe nevojat e prioritizimit (Mehmeti et al., 2019).

Ndër vite, ka programe për ZhPM të aprovuara nga MASHTI. Referuar të dhënave, në vitin 2019 janë miratuar 3 programe, ndërsa në vitin 2020 numri i trajnimeve të aprovuara është 82.

Referuar katalogëve të publikuar nga MASHTI për vitet 2019-2022, programet e aprovuara për zhvillim profesional të mësimit dhe udhëheqësve të arsimit, që ndërlidhen drejtpërdrejt me fushën e TIK-ut, janë gjithsej 66, sipas strukturës në tabelën 1.

*Tabela 1. Programet e akredituara sipas viteve, të prezantuara në katalogë*

Katalogu 2019 Gjithsej 3 programe	Katalogu 2020 gjithsej 24 programe	Katalogu 2021 Gjithsej 25 programe	Katalogu 2022 Gjithsej 14 programe
TIK = 3 programe	Metodologji të mësimit me TIK = 6 programe TIK = 12 programe Fusha kurrikulare Jeta dhe puna (ku hyn edhe Teknologjia me TIK) = 6 programe	Metodologji të mësimit me TIK = 19 (3 programe metodologji specifike për personat e verbër) TIK = 1 program  Fusha kurrikulare Jeta dhe puna (ku hyn edhe teknologjia me TIK)=5 programe	TIK, programe kompjuterike dhe platforma digjitale = 6 programe  Fusha kurrikulare Jeta dhe puna = 4 programe  TIK dhe Jeta dhe puna=2 programe

Mungesa e një baze funksionale të të dhënave lidhur me ZhPM ka bërë që të kemi mungesë të informatave për përfshirjen e mësimdhënësve në programe të ZhP, përfshirë edhe programet në fushën e TIK-ut. Vlerësimi i performancës së mësimdhënësve, si komponentë e sistemit të licencimit të mësimdhënësve, deri më tani, gjithashtu, nuk ka arritur të zbatohet në dinamikën dhe funksionin e paraparë dhe, si rrjedhojë, edhe të dhënat për kompetencat e vlerësuara të mësimdhënësve mungojnë, përfshirë edhe kompetencën për përdorimin e teknologjisë së informacionit, si një ndër treguesit për zbatim efektiv të mësimdhënies dhe nxënies (UA 14/2018 për VPM).

Marrë parasysh zhvillimet e fundit globale dhe vendore në fushën e teknologjisë, planifikimet e shtetit të Kosovës janë që të punohet maksimalisht në zhvillimin e kompetencës digjitale të të gjithë qytetarët e vet, përmes sistemit arsimor.

Dy janë dokumentet kryesore që e promovojnë dhe projektojnë zhvillimin në këtë fushë:

(i) Plani i Qeverisë së Kosovës 2021-2025, në të cilin *arsimi cilësor gjithëpërfshirës dhe i digjitalizuar* rezulton të jetë orientim kryesor për intervenim dhe zhvillim në sektorin e arsimit (Qeveria e Kosovës, 2022).

(ii) Strategjia e Arsimit 2022-2026, për herë të parë, si objektiv strategjik ka planifikuar Digjitalizimin e arsimit (OS 5). *Kultivimi i kompetencës digjitale të të gjitha palët e përfshira në fushën e arsimit dhe të të gjitha institucionet arsimore të të gjitha llojeve dhe niveleve është një ndër fushat e planifikuara për intervenim* (MASHTI, 2022).

Për të arritur këtë, MASHTI, në dokumentin e Strategjisë 2022-2026, planifikon të përcaktojë dhe të zyrtarizojë tri dokumentet bazë për Kornizën Evropiane të Kompetencës Digjitale: Korniza Evropiane për Kompetencën Digjitale për Qytetarët – DigComp; Korniza Evropiane e Kompetencës

Digjitale për Mësimdhënësit – DigCompEdu, dhe Korniza Evropiane e Kompetencës Digjitale për Organizatat Arsimore – DigCompOrg (Strategjia, f. 56).

Këto dokumente do të shërbejnë si referencë për zhvillimin dhe kultivimin e kompetencës digjitale të të gjitha palët (mësimdhënës, staf akademik, nxënës, studentë, personel tjetër i institucioneve të fushës së arsimit etj.).

Zhvillimi i kompetencës digjitale të mësimdhënësit aktualë të arsimit parauniversitar parashihet të realizohet kryesisht përmes programeve të trajnimit, të cilat do të konceptohen dhe përgatiten për këtë qëllim, në mënyrë që mësimdhënësit të aftësohen për përdorimin e teknologjive digjitale për nevoja arsimore dhe në të njëjtën kohë të kultivojnë kompetencën digjitale të nxënësit. Bazë për planifikim dhe avancim të kompetencës digjitale planifikohet të jetë Korniza Evropiane e Kompetencës Digjitale për Mësimdhënësit (DigCompEdu).

*Hulumtimi Niveli i kompetencave digjitale të mësimdhënësit dhe përfshirja e saj në programet e zhvillimit profesional të mësimdhënësve (ZhPM) bazohet kryekëput në kërkesat e PSAK-ut 2022-2026, për mbështetje në realizimin e veprimeve për kompetencën digjitale, në mënyrë specifike të veprimit 5.4.6: Analiza e programeve të trajnimit në fushën e teknologjisë digjitale dhe e nevojave të mësimdhënësve në shërbim për zhvillim të kompetencës digjitale.*

Në fokus të studimit ishin dy aspekte kryesore: (i) vlerësimi i nivelit të kompetencës digjitale të mësimdhënësve, mbi bazën e kërkesave (instrumenteve) të përfshira në Kornizën DigCompEdu, (ii) evidentimi i elementeve të kompetencës digjitale në programet e trajnimit të aprovuara nga MASHTI dhe të publikuara në dy katalogët e fundit, të cilët janë në shërbim për ZhPM për këtë kompetencë. Qëllimi i studimit ishte të identifikojë dhe të pasqyrojë nivelin e kompetencave digjitale të mësimdhënësit karshi kërkesave të kornizës DigCompEdu, si dhe gjendjen, nevojat dhe mundësitë e zhvillimit të kësaj kompetence përmes programeve të trajnimit.

## **1.1. Konteksti teorik**

Në historinë e njerëzimit, asnjëherë nuk ka pasur në dispozicion më shumë teknologji të informacionit sa në të tashmen. Për më tepër, në nivel botëror, zhvillimet e hovshme të teknologjisë konsiderohen si "Revolucioni i katërt

industrial”. Brenda tij, shumica e profesioneve ekzistuese kërkojnë aftësi digjitale (Ben Williamson et al, 2019). Ky zhvillim i hovshëm i teknologjisë, përveç të mirave shoqërore e individuale, konsiderohet se sjell edhe të ashtuquajturën “papunësi teknologjike”. Mënyra e vetme për të tejkaluar më lehtë ndryshimin dhe përshtatjen me kërkesat ndodh nëpërmjet zhvillimit të kompetencës digjitale, e që ndërlidhet drejtpërdrejt me suksesin, punësimin, kreativitetin dhe prosperitetin e çdo individi (Mezuca, 2019).

Nga perspektiva evropiane, kompetenca digjitale përfshin kompetencat e nevojshme të individit për të funksionuar në një shoqëri të digjitalizuar (Hatlevik and Christophersen 2013). Pra, në mënyrë gjithëpërfshirëse, integrohen njohuritë, shkathtësitë, aftësitë etj. për përdorim të teknologjisë digjitale në një shoqëri me informacion të digjitalizuar, të vlefshme për të gjithë qytetarët, pa dallim profesioni apo angazhimi në fusha të ndryshme të shoqërisë. Edhe pse shumë studime janë bërë në këtë fushë, ende mbetet në qendër të vëmendjes kërkesa e kontekstualizimit të kompetencës digjitale drejt profesioneve përkatëse, në këtë rast drejt aspekteve pedagogjike. Studiues të ndryshëm provojnë të vënë në pah rëndësinë që ka zhvillimi i kompetencës digjitale të kontekstualizuar me fushën e edukimit, krahasuar me fushat e tjera të shoqërisë (Instefjord & Munthe, 2016).

Idetë se si të bëhet ky kontekstualizim fillojnë me integrimin e kësaj kompetence në programet e përgatitjes së mësimdhënësve në universitete (Kivunja, 2013), për të vazhduar më tutje me zgjerimin e vetë konceptit dhe përkufizimit për këtë kompetencë. Krumsvik (2011) sugjeroi një përfshirje të aspekteve pedagogjike në konceptin e kompetencës digjitale dhe, sipas tij, ky koncept përshkruhet si *“aftësi e mësimdhënësve për përdorimin e TIK-ut në një kontekst profesional me gjykim të mirë pedagogjik-didaktik dhe me ndërjegjësim të tij/saj për implikimet e mundshme në strategjitë e të mësuarit dhe profesionalizimit digjital të nxënësve dhe studentëve”* (f. 45).

Në përgjithësi, ka pajtime se ekziston një ndërlidhje e fortë në mes të nivelit të kompetencave digjitale të mësimdhënësve dhe rezultateve të përdorimit të tyre në praktikat e mësimdhënies dhe nxënies. Shulman (1987) tregon se mësimdhënësia ka një bazë njohurisë. Ai argumenton se mësimdhënësia kërkon njohuri të përmbajtjes, njohuri të pedagogjisë dhe njohuri për nxënësit. Ai


pretendon se këto përbëjnë atë që ai e quan njohuri të përmbajtjes pedagogjike dhe argumenton atë që mësimdhënësit duhet "të dinë, të bëjnë, të kuptojnë ose të vërtetojnë" (f. 4).

Më vonë, në vitin 2006, studiuesit Mishra dhe Koehler shkojnë më tutje, e zgjerojnë teorinë e Shulman, duke promovuar konceptin e integritit të teknologjisë së informacionit në proceset pedagogjike. Ata prezantuan kornizën TPACK dhe argumentuan integrimin e patjetërsueshëm edhe të njohurive teknologjike në procesin e mësimin. Korniza TPACK fokusohet në kombinimin dhe përshtatjen e njohurive teknologjike (TK - technologie knowledge), njohurive pedagogjike (PK -pedagogical knowledge), dhe njohurive për përmbajtjen (CK-content knowledge). Sipas tyre, korniza ofron qasje produktive në shumë dilema që mësimdhënësit ballafaqohen gjatë zbatimit të teknologjisë edukative (edtech) në klasat e tyre.

Duke bërë dallimin midis këtyre tri llojeve të njohurive, korniza TPACK përshkruan se si përmbajtja (ajo që mësohet) dhe pedagogjia (si mësuesi e transmeton atë përmbajtje) duhet të formojnë themelin për çdo integrim efektiv të teknologjisë edukative. Kjo qasje është e rëndësishme, sipas tyre, meqenëse teknologjia që zbatohet duhet të komunikojë përmbajtjen dhe të mbështesë pedagogjinë, në mënyrë që të përmirësojë përvojën e të mësuarit të nxënësve.

Tri llojet e njohurive: TK, PK dhe CK, kombinohen dhe rikombinohen në mënyra të ndryshme brenda kornizës TPACK. Njohuritë pedagogjike - teknologjike (TPK), sipas kornizës, përshkruajnë marrëdhëniet dhe ndërveprimet ndërmjet mjeteve teknologjike dhe praktikave specifike pedagogjike, ndërsa njohuritë e përmbajtjes pedagogjike (PCK) përshkruajnë të njëjtën gjë ndërmjet praktikave pedagogjike dhe objektivave specifike të të nxënësve, dhe, në fund, njohuritë për përmbajtjen teknologjike (TCK) përshkruajnë marrëdhëniet dhe kryqëzimet ndërmjet teknologjive dhe objektivave të të mësuarit.

Zona trekëndore më pas përbën TPACK, i cili merr në konsideratë marrëdhëniet ndërmjet tri fushave dhe pranon se edukatorët po veprojnë brenda kësaj hapësire komplekse.



Grafiku 1. TPACK: Technological Pedagogical Content Knowledge Framework.  
 Burimi: image ©2012 by tpack.org

Studime të shumta kanë trajtuar çështjen e nevojës për integrimin e teknologjisë digjitale dhe ndërlikohet (ndikimet) në procesin e mësimdhënies dhe të nxënies. Wastiau et al. (2013), në studimin e tyre “*The use of ICT in education: A survey of schools in Europe*”, tregojnë se niveli i besimit të mësimdhënësve për kompetencën e tyre digjitale ndikon në përdorimin e teknologjive nga ana e nxënësve gjatë mësimëve. Sipas tyre, nxënësit e mësimdhënësve me kompetencë të lartë digjitale, por me qasje të kufizuar në teknologjitë digjitale në klasë, përdorin teknologjitë digjitale në një masë më të madhe sesa ata që mësohen nga mësimdhënës me kompetencë të ulët digjitale, por me qasje më të mira në teknologji (f. 11–27).

Në fjalën hyrëse të CIDREYearbook 2021, me temën “*Digital Literacy: Curriculum Development and Implementation in European Countries*”, potencohet se *përdorimi i teknologjive dhe komunikimi nëpërmjet mediave digjitale janë fusha të rëndësishme brenda kompetencës digjitale që duhet*

*të ofrojnë shkollat. Në të ardhmen, gjeneratat e reja duhet të jenë të afta jo vetëm të konsumojnë, por edhe të krijojnë vlera në fushën e kompetencës digjitale. Është thelbësore që stafi i shkollës të punojnë së bashku, në mirëkuptim të përbashkët të vendosin se cilat kompetenca digjitale dhe si t'i zhvillojnë ato te mësimitdhënësit dhe te nxënësit” (f. 4).*

Autorët kontribuues në këtë libër (Estonia, Franca, Hungaria, Luksemburgu, Mali i Zi, Holanda dhe Serbia) e konfirmojnë referimin në Kornizat Evropiane për të avancuar kompetencën digjitale në sistemet e tyre arsimore, përfshirë avancimin e kurrikulave, hartimin e standardeve dhe instrumenteve për zhvillimin dhe vlerësimin e kompetencave digjitale të mësimitdhënësve, nxënësve etj.

Ka edhe studime që flasin për rëndësinë e kësaj kompetence në profesionin e mësimitdhënies, por, në anën tjetër, shtrojnë dilemën se si të përgatiten mësimitdhënësit për të arritur këtë. Erstad dhe Quale (2009) argumentojnë se *mësimitdhënësit vazhdimisht përballen me dilemën zhgënjyese: atyre u kërkohet me ligj që të përdorin gjerësisht TIK-un në praktikën e tyre, por askush nuk u thotë se si ata duhet ta bëjnë këtë (f. 565).*

Wei et al. (2016) arritën në përfundimin se zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësimitdhënësve për të rritur kompetencën digjitale lehtëson pranimin dhe përdorimin efektiv të teknologjive digjitale në praktikën e mësimitdhënies dhe të të nxënësve. Format më të propozuara nga studiuesit për ZhPM për këtë kompetencë përfshijnë hartimin dhe realizimin e aktiviteteve të mësimitdhënies dhe nxënësve, duke përdorur teknologjitë digjitale (Wanjala, 2016), mjediset e të mësuarit joformal, komunitetet profesionale të të mësuarit në internet dhe lloje të tjera të iniciativave të ZhPM-së që janë *'të integruara ngushtë në praktikën e përditshme të mësimitdhënësve'*, mund të jenë të rëndësishme për zhvillimin e vazhdueshëm të kompetencës digjitale të mësimitdhënësve (Wastiau, 2013), rrjetëzimi i shkollave në baza lokale ose rajonale, ku ekspertiza dhe praktikat për kompetencën digjitale mund të ndahen brenda dhe nëpër mjedise shkollore (Dexter, 2008) etj.

Për të arritur këtë, shumë sisteme arsimore bazë referimi për planifikim dhe zbatim të strategjive të ndryshme të intervenimit e kanë Kornizën Evropiane për zhvillimin e kompetencës digjitale (Korniza DigComp 2.1, mbi bazën e së cilës u zhvilluan edhe DigCompEdu dhe DigCompOrg).

Bazuar në Kornizën DigCompEdu, hartohen edhe instrumente specifike për të vlerësuar kompetencat digjitale të mësimitdhënësve, përshtatur me kontekstet e sistemeve arsimore përkatëse.

Hungaria p.sh. konfirmon që për përcaktimin, përmirësimin dhe vlerësimin e niveleve të kompetencës digjitale të mësimitdhënësve bazohen në rekomandimet e DigCompEdu të BE-së. Synimi kryesor, sipas tyre, është përmirësimi i kompetencës digjitale të mësimitdhënësve, në mënyrë që ata të jenë në gjendje të avancojnë kompetencat digjitale të nxënësve me të cilët ata punojnë (CIDREYearbook 2021, f. 70).

Shembull, në vitin 2018, punonjës të Universitetit të Berlinit zhvilluan instrumentin e vlerësimit të mësimitdhënësve: të nivelit fillor, të mesëm të ulët dhe atij profesional. Ky instrument synon të ndihmojë mësimitdhënësit në Gjermani që të reflektojnë për kompetencat e tyre digjitale, si dhe të identifikojnë nevojat e tyre për zhvillim të mëtutjeshëm profesional, meqenëse u jep mundësinë:

- të mësojnë më shumë rreth kërkesave të Kornizës DigCompEdu, d.m.th. çfarë do të thotë të jesh një mësimitdhënës kompetent në aspektin digjital;
- për informata kthyesë për pikat e forta individuale për kompetencën digjitale;
- për të marrë ide se si të përmirësohen ato kompetenca.

Po kështu, zhvilluesve të programeve të trajnimeve për mësimitdhënës dhe ofruesve (trajnerëve) ky instrument u mundëson që të identifikojnë nevojat e mësimitdhënësve për ZhP, në mënyrë që të dizajnojnë trajnime të përshtatshme për zhvillimin e kësaj kompetence.

### ***Koncepti dhe përkufizimet për kompetencën digjitale***

Gjatë viteve të fundit, ka përkufizime të ndryshme për shkathtësitë e individit, të ndërlidhura me përdorimin e teknologjisë. Ka edhe emërtime të ndryshme të përdorura, si shkathtësi për TIK, shkathtësi për teknologji, shkathtësitë e shekullit 21, shkathtësi digjitale, shkathtësitë për media, kompetencë digjitale etj.

Në botimet e fundit, koncepti *kompetencë* haset më shpesh sesa koncepti *shkathtësi*. Dallimet ndërmjet kompetencës dhe shkathtësive përkufizohen më në detaje në një projekt të OECD-së, në të cilin thuhet:

*“Një kompetencë është më shumë se vetëm njohuri dhe shkathtësi. Ajo përfshin aftësinë për të përmbushur kërkesat komplekse, duke u mbështetur dhe mobilizuar në burime psiko-sociale (përfshirë aftësitë dhe sjelljen) në një kontekst të caktuar”* (OECD, 2005, f. 4).

Në literaturën e shumtë të huaj mund të hasim raste kur konceptet *Digital literacy* dhe *Digital competence* përdoren si sinonime. Nuk është se ka shpjegime të bazuara në kërkime shkencore për kuptimin apo karakteristikat veçuese për to, marrë parasysh edhe faktin se këto evoluojnë, ndryshojnë, plotësohen vazhdimisht. Megjithatë, përkufizimet ekzistuese lidhur me *Digital literacy* dhe *Digital competence* japin orientime për disa tipare dalluese, mbi bazën e elementeve të përfshira në përkufizime.

*Digital Literacy* shpeshherë konsiderohet të ketë një traditë më të gjatë të përdorimit dhe ndërlidhet me shkathtësitë për media (Erstad, 2010) dhe nënkupton *‘shkathtësinë e individit për të performuar detyra në mënyrë efektive në një ambient digjital; ku me konceptin digjital nënkuptohet informacioni i prezantuar në formë numerike (simbole e shkronja) përmes përdorimit të kompjuterit dhe koncepti shkathtësi nënkupton leximin dhe interpretimin e mediave, riprodhimin e të dhënave dhe pamjeve përmes manipulimeve digjitale, si dhe vlerësimin dhe zbatimin e njohurive të reja të dala nga mjediset digjitale’* (Kavalier et al., 2008).

Koncepti *Digital competence* konsiderohet të jetë më i vonshëm dhe përshkruan shkathtësitë e nevojshme të ndërlidhura drejtpërdrejt me zhvillimet e vazhdueshme.

Sipas studimit të Universitetit të Helsinkut (2021), *What is digital competence?*, koncepti *Kompetencë digjitale* përshkruhet si një koncept më i gjerë dhe gjithnjë në zhvillim, i ndërlidhur me zhvillimet në fushën e teknologjisë, po ashtu edhe me synimet për qytetari në një shoqëri të dijes. Sipas studimit, ky koncept zbërthehet në katër aspekte: 1. Shkathtësi teknike për përdorimin e teknologjisë digjitale, 2. Aftësia e përdorimit të teknologjisë për punë, studim dhe në jetën e përditshme, 3. Aftësia e vlerësimit kritik e teknologjive digjitale, 4. Motivimi për të marrë pjesë në kulturën digjitale (Ilomäki et al.,2011).

Në vitin 2018, Këshilli i Unionit Evropian (The Council of the European Union) adaptoi rekomandimet për kompetencat kryesore për arsimin gjatë gjithë jetës. Kompetenca digjitale është një nga tetë kompetencat e përfshira dhe paraqitet si:

*‘Aftësi e individit për shfrytëzimin dhe ndërveprimin konfident, kritik dhe të përgjegjshëm me teknologji digjitale, me qëllim të të nxëniet, të kryerjes së detyrave të punës dhe të pjesëmarrjes në shoqëri. Ajo përfshin të kuptuarit e informacionit dhe të dhënave, komunikimin dhe bashkëpunimin, të kuptuarit e medias, krijimin e përmbajtjes digjitale (përfshirë kodimin), sigurinë (përfshirë mirëqenien digjitale dhe sigurinë në internet), çështjet që kanë të bëjnë me pronën intelektuale, si dhe zgjidhjen e problemeve dhe të menduarit kritik e krijues. Së këndejmi, kultivimi i kompetencës digjitale të të gjithë qytetarët është e një rëndësie të madhe dhe barrën kryesore për këtë e bartin sistemi i arsimit dhe institucionet arsimore të të gjitha niveleve (EU, 2018).*

Në kontekstin e Kosovës, në dokumentet relevante për fushën e arsimit, nuk është se ofrohet ndonjë përkufizim apo përshkrim sa i përket konceptit *Kompetencë digjitale*, por ka referime në ato aktuale të EU-së. Edhe vetë dokumenti i PSAK-ut, 2022-2026, e fuqizon këtë referim, në të cilin potencohet se *Kompetenca digjitale* është një nga tetë kompetencat e përfshira në Kuadrin Evropian të kompetencave kyçe për mësimin gjatë gjithë jetës dhe përkufizimi i prezantuar në këtë dokument është ai EU-së (Strategjia, f. 55).

Në dokumentin Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës (MAShT, 2016) shpjegohet që kompetencat kryesore të këtij niveli arsimor janë të bazuara dhe të ndërlidhura me tetë kompetencat kryesore evropiane për nxënie tërëjetësore (Kornizën Referuese Evropiane). Kompetenca digjitale nuk është planifikuar të jetë një kompetencë më vete, por është e shkrirë, e integruar në rezultatet e të nxënies të secilës nga gjashtë kompetencat e përcaktuara. Dy konceptet e ndërlidhura në këtë dokument flasin për shkathtësinë, si *'aftësi për ta zbatuar dijen për të kryer një detyrë të veçantë sipas një standardi të qëndrueshëm (dimensioni operacional/procedural i dijes' dhe për kompetencën si 'aftësi të gjera për t'i zbatuar njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet, rutinat, vlerat dhe emocionet në mënyrë të pavarur, praktike dhe domethënëse* (Korniza Kurrikulare, f. 62-66).

Me planifikimet e fundit strategjike, gjegjësisht me përfshirjen e tri dokumenteve evropiane si referencë për zhvillimin dhe kultivimin e kompetencës digjitale të të gjitha palët (mësimdhënës, staf akademik, nxënës, studentë, personel tjetër i institucioneve të fushës së arsimit etj.), ofrohet një mundësi e mirë edhe për përcaktimin në raport me përdorimin e koncepteve dhe përkufizimeve lidhur me këtë aspekt.

### ***ZhPM në politikat aktuale në fushën e arsimit***

Ushtrimi i profesionit të mësimdhënies në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar në Kosovë hyn në listën e profesioneve të rregulluara me Ligjin për profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2016). Sipas ligjit, për ushtrimin e profesionit të rregulluar, çdo person (në këtë rast çdo mësimdhënës) duhet të përfundojë studimet përkatëse apo kualifikimet profesionale, të përfundojë praktikën profesionale, të kryejë provimin shtetëror, si dhe të regjistrohet në organin përkatës profesional (Neni 7, Kriteret për ushtrimin e profesionit të rregulluar). Deri më tani, Ligji akoma nuk ka filluar të zbatohet dhe ende mungon një sistem, i cili do të shërbente për informata kthyesë për cilësinë e mësimdhënësve të diplomuar dhe punësimin e tyre. Aktualisht, mësimdhëniesit fillojnë të ushtrjnë profesionin e tyre pas pranimit në punë

nga autoritetet komunale, në bazë të procedurave të konkurseve dhe vlerësimeve të administruara nga DKA (Buleshkaj, 2021).

Zhvillimi profesional i mësimdhënësve në shërbim konsiderohet si aktivitet i vazhdueshëm dhe i obliguar për të gjithë mësimdhënësit, në funksion të sigurimit dhe plotësimit të standardeve të mësimdhënies nga të gjithë mësimdhënësit.

Ka udhëzime administrative dhe dokumente përcjellëse, të cilat, ndër të tjera, e rregullojnë edhe funksionimin dhe zbatimin e ZhPM. Në vitin 2017, MASHT hartoi *UA 05/2017 Sistemi i licencimit dhe zhvillimit të mësimdhënësve në karrierë*. Sipas dokumentit, zhvillimi i mësimdhënësve në shërbim ka për qëllim zhvillimin e kompetencave të mësimdhënësve për përmirësimin dhe avancimin e praktikave të mësimdhënies dhe nxënies në klasë, në mënyrë që t'u sigurojnë të gjithë nxënësve shërbime arsimore cilësore në përputhje me kërkesat e shoqërisë (UA, Neni 6).

Në vitin 2020, MASHT-i hartoi edhe *UA 119/2020 për Zhvillimin profesional të mësimdhënësve me bazë në shkollë*, i cili përcakton dhe rregullon ZhPMBSH.

Në raport me zhvillimin dhe vlerësimin e kompetencave të mësimdhënësve në faza të ndryshme të karrierës, bazë për planifikim të ZhPM-së është Korniza Strategjike për Zhvillimin Profesional të Mësimdhënësve (MASHT, 2017).

*Korniza strategjike për zhvillimin profesional të mësimdhënësve* është dokumenti kryesor, ku sqarohen procedurat e identifikimit të nevojave për ZhP, njohjen dhe certifikimin e njohurive dhe shkathtësive të fituara përmes ZhPM, monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të programeve të ZhPM, etj.

Ky dokument përcakton standardet e profesionit të mësimdhënësit përgjatë karrierës, zbërthen kompetencat në faza të ndryshme të karrierës dhe fazat e zbatimit të sistemit të zhvillimit të mësimdhënësve në karrierë.

Profili i kompetencave të mësimdhënësve në Kosovë, sipas dokumentit, përmbledhet në katër fusha të mësimdhënies: Vlerat profesionale (qëndrimet dhe sjelljet), njohuritë profesionale dhe të kuptuarit, praktika profesionale, si dhe mësimi dhe angazhimi profesional. Këto fusha zbërthehen pastaj në

shtatë (7) standarde, të cilat përcaktojnë atë se çfarë duhet të dinë dhe të bëjnë mësimmshënësit.

*Tabela 2. Korniza e përgjithshme e fushave dhe standardeve të profesionit/ kompetencave të përgjithshme për ZhPM*

Fusha		Standardi	
1	Vlerat profesionale, qëndrimet dhe sjelljet	1	Njeh dhe mbështet vlerat dhe kriteret kryesore që janë vendosur nga MASHTI. Përgjegjësi karshi detyrimeve dhe obligimeve të punës.
2	Njohuritë profesionale dhe të kuptuarit	2	Demonstron qëndrime dhe sjellje pozitive dhe objektive për mirëqenien e nxënësve dhe mësimit.
		3	Demonstron njohje të kurrikulës/përmbajtjes lëndore dhe metodikës së didaktikës profesionale të lëndës.
3	Shkathhtësitë dhe praktika profesionale	4	Planifikon zbatim efektiv të mësimmshënësis dhe mësimmnxënësis.
		5	Planifikon vlerësimin e vazhdueshëm (vlerësimin për të mësuar), ofron komente kthyesë dhe raporton sa i përket mësimit të nxënësve.
4	Mësimi dhe angazhimi profesional	6	Angazhohet për zhvillim të vazhdueshëm profesional.
		7	Angazhohet profesionalisht me kolegë, prindër dhe bashkësi.

Çdo standard më tutje zërthehet në 3 apo 4 tregues përkatës (gjithsej 27 tregues për 7 standarde), përshkruar të detajuar të detyrave dhe obligimeve të mësimmshënësit në raport me arritjen e standardit.

Lidhur me zhvillimin e kompetencës digjitale të mësimmshënësve në shërbim, analiza e detajuar e këtij dokumenti ka nxjerrë në pah që në asnjërën nga Fushat dhe Standardet për ZhPM fokusi nuk qëndron direkt në zhvillimin e kësaj kompetence. Vazhduar më tutje me analizën e treguesve të standardeve përkatëse, rezultojnë që vetëm në njërin nga standardet (Standardi 4: Planifikon zbatim efektiv të mësimmshënësis dhe mësimmnxënësis), në mënyrë të drejtpërdrejtë potencohet përdorimi i teknologjisë: *Treguesi 4.4. Përdor teknologjinë adekuate në mënyrë adekuate – sigurt, me përgjegjësi dhe me*

*etikë*. Kompetencat e mësimdhënësve për qëndrim dhe avancim në karrierë, sipas fazave të ndryshme të karrierës, të specifikuara të ky standard, janë të ofruara në dokumentin e Kornizës Strategjike për ZhPM, f. 14.

Në dokumentin e Kornizës, në përmbajtjen e tij, theksohet se ky është një dokument i gjallë, i cili do të plotësohet dhe do të zhvillohet vazhdimisht, krahas zhvillimeve të reja në fushën e zhvillimit të mësimdhënësve dhe procesit të licencimit (po aty, f. 5). Megjithatë, mbi bazën e tij mbështetet edhe procesi i vlerësimit të performancës së mësimdhënësve, i rregulluar dhe i detajuar me UA 14/2018 për Vlerësimin e performancës së mësimdhënësve - VPM (MASHT, 2018). Si proces, VPM-ja është ngushtë i lidhur me licencimin dhe avancimin në karrierë të mësimdhënësve. Referuar të dhënave, VPM-ja nuk ka arritur të zbatohet në dinamikën e paraparë dhe ta kryejë funksionin e tij. Sipas raporteve, deri në vitin 2019 janë vlerësuar një numër i vogël i mësimdhënësve. Në një raport të ofruar nga Inspektorati i Arsimit, thuhet se brenda dy viteve (aludohet në vitin 2019 dhe 2020) në procesin e VPM-së janë përfshirë 755 mësimdhënës, në 167 shkolla të 29 komunave të Kosovës. Niveli i performancës së mësimdhënësve të vlerësuar me përqindje më të lartë rezulton të jetë të shkalla e vlerësimit Performancë e mirë, me 66.49%. Nga fillimi i pandemisë COVID 19 nuk ka vazhduar realizimin i VPM-së (Preteni, 2021).

### ***Korniza Evropiane e Kompetencës Digjitale për Mësimdhënësit (DigCompEdu)***

Korniza Evropiane e Kompetencës Digjitale për Mësimdhënësit DigCompEdu (European Framework for the Digital Competence of Educators DigCompEdu) është hartuar në vitin 2017, nën ombrellën e Komisionit Evropian dhe bazuar në Kornizën DigComp 2.1.

Përmes këtij dokumenti synohet që të ndihmohen shtetet anëtare në përpjekjet e tyre për të promovuar kompetencën digjitale të qytetarët e tyre dhe të nxisin inovacionin në arsim. Synimi është gjithashtu që të mbështeten përpjekjet nacionale, rajonale dhe lokale, për nxitjen e kompetencës digjitale

të edukatorëve (mësimdhënësve), duke ofruar një kornizë të përbashkët referimi, me një gjuhë dhe logjikë të përbashkët të organizimit.

Kompetenca digjitale sipas dokumentit mund të përkufizohet gjerësisht si përdorimi i sigurt, kritik dhe krijues i TIK-ut për të arritur qëllimet lidhur me punën, punësimin, mësimin, kohën e lirë, përfshirjen dhe/ose pjesëmarrja në shoqëri (Korniza, f. 90).

Qëllimi i kornizës së DigCompEdu është të reflektojë mbi ekzistimin e instrumenteve për kompetencën digjitale të mësimdhënësve dhe për t'i sintetizuar ato në një model koherent që do t'u mundësonte edukatorëve (mësimdhënësve) të arsimit të obligueshëm të vlerësojnë dhe zhvillojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse kompetencat e tyre pedagogjike digjitale (Korniza, f. 13).

Vlerë e shtuar e Kornizës DigCompEdu është se ofron:

- Sfond të shëndoshë që mund të udhëheqë politikat në të gjitha nivelet;
- Model që lejon palët e interesuara lokale të lëvizin shpejt drejt zhvillimit të një instrumenti konkret, të përshtatshëm për nevojat e tyre, pa pasur nevojë të zhvillojnë një bazë konceptuale për këtë aspekt;
- Gjuhë dhe logjikë e përbashkët që mund të ndihmojë diskutimin dhe shkëmbimin e praktikave më të mira përtej kufijve;
- Pikë referimi për shtetet anëtare dhe palët e tjera të interesuara për të vërtetuar plotësinë dhe qasjen e mjeteve dhe kornizave të tyre ekzistuese dhe të ardhshme.

Korniza DigCompEdu përshkruan kompetencat specifike digjitale përmes 22 kompetencave kryesore, të organizuara dhe të ndërlidhura ndërmjet vete në kuadër të gjashtë (6) fushave. Tabela 3.

Tabela 3. Fushat dhe kompetencat përkatëse të Kornizës DigCompEdu

<p><b>Fusha 1: Angazhimi profesional</b></p> <p>Përdorimi i teknologjisë digjitale për komunikim, bashkëpunim dhe zhvillim profesional.</p> <p>Kompetencat:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Komunikimi organizativ;</li> <li>- Bashkëpunimi profesional;</li> <li>- Praktikat e reflektimit;</li> <li>- Zhvillimi i vazhdueshëm profesional digjital.</li> </ul>	<p><b>Fusha 2: Burimet digjitale</b></p> <p>Burimet, krijimi dhe shpërndarja e burimeve digjitale.</p> <p>Kompetencat:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përzgjedhja e burimeve digjitale;</li> <li>- Krijimi dhe përshtatja e burimeve digjitale;</li> <li>- Menaxhimi, mbrojtja dhe ndarja e burimeve digjitale.</li> </ul>	<p><b>Fusha 3: Mësimdhënia dhe të nxënit</b></p> <p>Menaxhimi dhe orkestrimi i përdorimit të teknologjisë digjitale në procesin e mësimdhënies dhe të nxënit.</p> <p>Kompetencat:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mësimdhënia;</li> <li>- Udhëzimet;</li> <li>- Të mësuarit në bashkëpunim;</li> <li>- Të mësuarit e vetëdrejtuar.</li> </ul>
<p><b>Fusha 4: Vlerësimi</b></p> <p>Përdorimi i teknologjive digjitale dhe strategjitë për rritjen e vlerësimit.</p> <p>Kompetencat:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Strategji për vlerësim;</li> <li>- Dëshmi për analizë;</li> <li>- Informatë kthyesë dhe planifikim.</li> </ul>	<p><b>Fusha 5: Fuqizimi i nxënësve</b></p> <p>Përdorimi i teknologjisë digjitale për rritjen e gjithëpërfshirjes, personalizimit dhe angazhimit aktiv të nxënësve.</p> <p>Kompetencat:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Qasje dhe gjithëpërfshirje;</li> <li>- Diferencim dhe personalizim;</li> <li>- Angazhim aktiv i nxënësve.</li> </ul>	<p><b>Fusha 6: Fasilitimi (mbështetja) e kompetencës digjitale të nxënësve</b></p> <p>Mundësimin e përdorimit të teknologjisë digjitale në mënyrë kreative dhe me përgjegjësi nga ana e nxënësve, për qëllime të komunikimit, krijimit e përmbajtjeve, mirëqenie dhe zgjidhje të problemeve.</p> <p>Kompetencat:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Shkathësitë (literacy) për media dhe informim;</li> <li>- Komunikimi dhe bashkëpunimi digjital;</li> <li>- Krijimi i përmbajtjeve digjitale;</li> <li>- Përdorimi i përgjegjshëm;</li> <li>- Zgjidhja e problemeve në mënyrë digjitale.</li> </ul>

Thelbi i kornizës DigCompEdu, sipas dokumentit, përcaktohet në fushat 2-5. Së bashku këto fusha shpjegojnë kompetencat digjitale pedagogjike të mësimdhënësve, d.m.th. kompetencat digjitale që mësimdhënësit duhet të kenë për të nxitur mësimdhënie efikase, gjithëpërfshirëse dhe inovatore të të mësuarit. Fushat 1, 2 dhe 3 janë të fokusuara në fazat karakteristike të çdo procesi mësimor, mbështetur nga teknologjitë apo jo. Kompetencat e renditura në këto fusha detajojnë se si të bëhet përdorimi efikas e inovator i teknologjive digjitale gjatë planifikimit (Fusha 2), zbatimit (Fusha 3) dhe vlerësimin e mësimdhënies dhe nxënies (Fusha 4). Fusha 5 pranon potencialin e teknologjive digjitale për strategjitë e mësimdhënies dhe të të nxënit me në qendër nxënësin. Kjo fushë është transversale me fushat 2, 3 dhe 4, në kuptimin që përmban një sërë parimesh udhëzuese të rëndësishme për dhe plotësuese me kompetencat e përcaktuara në to (po aty, f. 13).

### ***Modeli për vetëvlerësimin e kompetencës digjitale***

Modeli i propozuar në Kornizë synon të ndihmojë mësimdhënësit të kuptojnë anët e tyre të forta, por edhe mangësitë në raport me kompetencën digjitale. Modeli përshkruan faza apo nivele të ndryshme lidhur me zhvillimin e kësaj kompetence. Për secilin nivel, referencat e dhëna (përshkrimet) janë të bazuara në gjashtë nivelet e shkathtësive të prezantuara në Kornizën e përbashkët evropiane për gjuhët (Common European Framework of Reference for Languages - CEFR), filluar nga niveli A1 deri tek ai C2, dhe atë për dy arsye:

- Nivelet CEFR njihen dhe përdoren gjerësisht, është e lehtë që mësimdhënësit të kuptojnë dhe vlerësojnë nivelin personal për kompetencë digjitale;
- Këto nivele dhe logjika e përparimit janë të inspiruara nga Taksonomia e rishikuar e Bloom-it (Taksonomia e hartuar në vitin 1950, në vitin 1990 është rishqyrtuar nga ish-nxënësi i tij, Lorin Anderson), e cila tanimë është e njohur dhe e zbatuar nga komuniteti arsimor në përgjithësi. Pra, është e pranuar gjerësisht se kjo taksonomi shpjegon

fazat e përparimit në procesin e të nxënit, nga “Kujto” dhe "Kupto", te "Zbato" dhe "Analizo", dhe në fund te “Vlerëso” dhe “Krijo”.

### ***Nivelet e vlerësimit dhe zhvillimit të kompetencës digjitale përmes DigCompEdu***

Sikurse te Taksonomia, në mënyrë të ngjashme, në dy nivelet e para të DigCompEdu, Fillestar (A1) dhe Zbulues (A2), mësimdhënësit marrin informacione të reja dhe zhvillojnë bazën praktikat digjitale; në dy nivelet vijuese, Integruesi (B1) dhe Eksperti (B2), ata aplikojnë, zgjerohen më tej dhe reflektojnë mbi praktikat e tyre digjitale; në nivelet më të larta, Udhëheqësi (C1) dhe Pionieri (C2), mësimdhënësit përcjellin njohuritë e tyre, kritikojnë praktikën ekzistuese dhe zhvillojnë praktika të reja (Korniza, f. 29).

Rangimin e niveleve të arritjeve për pikët/përqindjet e fituara në vetëvlerësim Korniza e rregullon sipas strukturës:

- *Fillestar* (A1) deri në 32/192 pikë, apo 17%
- *Eksplorues* (A2) 33-64/192 pikë, apo 18-33%
- *Integrues* (B1) 65-96/192 pikë, apo 34-50%
- *Ekspert* (B2) 97-128/192 pikë, apo 51-67%
- *Udhëheqës* (C1) 129-160/192 pikë, apo 68-83%
- *Pionier* (C2) 161-192/192, apo 84-100%.

Në korniza të trasha, referuar gjashtë fushave dhe kompetencave të kësaj kornize, përshkrimin e përgjithshëm për nivelet e arritjes (A1 deri te C2) për kompetencën digjitale po e paraqesim në tabelën nr. 4.

Tabela nr.4 Nivelet e arritjes sipas fushave të DigCompEdu. Burimi: European Framework for the Digital Competence of Educators, fq. 31

Fusha/Niveli	Angazhimi profesional	Burimet digjitale	Mësimdhënia dhe të nxënët	Vlerësimi	Fuqizimi i nxënësve	Fasilitimi i kompetencës digjitale të nxënësve
C2 (Pionier) 	Inovacione/risi në praktikës profesionale	Promovimi i përdorimit të burimeve digjitale	Inovacione/risi në mësimdhënie	Inovacione/risi në vlerësim	Inovacione/risi në përfshirjen e nxënësve	Përdorimi i formateve inovative/ risi për të nxitur kompetencat digjitale te nxënësit
C1 (Udhëheqës) 	Diskutim dhe rishikim i praktikës profesionale	Përdorimi gjithëpërfshirës i strategjive të avansuara dhe burimeve	Rishikimi strategjik dhe domethënës i praktikave të mësimdhënies	Reflektim kritik në strategjitë për vlerësim digjital	Fuqizimi holistik i nxënësve	Nxitja kritike dhe gjithëpërfshirëse e kompetencave digjitale te nxënësit
B2 ( Expert) 	Avancim i praktikës profesionale	Shfrytëzimi strategjik i burimeve interaktive	Avancimi i aktiviteteve të mësimdhënies dhe nxënies	Shfrytëzimi strategjik dhe efektiv i vlerësimit digjital	Shfrytëzimi në mënyrë strategjike i një sër mjeteve për fuqizim/mbështetje	Nxitja në mënyrë strategjike e e kompetencave digjitale te nxënësit
B1 (Integruës) 	Zgjerim i praktikës profesionale	Përshtatja e burimeve digjitale në kontekstin e të mësuarit	Integrimi kuptimplotë i teknologjive digjitale	Acancimi i qasjeve tradicionale të vlerësimit	Adresimi i zhvillimit të nxënësve	Zbatimi i aktiviteteve për mbështetjen e kompetencave digjitale te nxënësit
A2 (Zbulues/hulumës) 	Hulumtim i opsioneve digjitale	Hulumtim i opsioneve digjitale	Hulumtim i strategjive digjitale për mësimdhënie dhe nxënie	Hulumtim i strategjive digjitale për vlerësim	Hulumtim i strategjive me nxënësin në qendër	Inkurajim i nxënësve për përdorim të teknologjisë digjitale
A1 (Fillestar) 	Vetëdijesim, Pasiguri, Përdorim bazik	Vetëdijesim, Pasiguri, Përdorim bazik	Vetëdijesim, Pasiguri, Përdorim bazik	Vetëdijesim, Pasiguri, Përdorim bazik	Vetëdijesim, Pasiguri, Përdorim bazik	Vetëdijesim, Pasiguri, Përdorim bazik

## ***Instrumentet për vlerësimin e kompetencave digjitale te mësimeve të mesimit përmes Kornizës DigCompEdu***

Instrumente për (vetë)vlerësimin e kompetencave digjitale nga ana e mësimeve të mesimit hartohen dhe rishikohen vazhdimisht nga Zyra Qendrore e Komisionit Evropian. Bazë për hartimin e tyre është dokumenti i Kornizës DigCompEdu. Në vitin 2023 kemi versionin e fundit të [SELFIEforTEACHERS](#), i adaptuar në 29 gjuhë të botës (vendeve anëtare) dhe është i hapur për qasje online dhe vetëvlerësim nga mësimeve të mesimit e ISCED 1-3. Në zbatim kemi edhe versionin e rivaliduar për arsimin e lartë: CheckIn for Higher Education. Instrumenti SELFIEforTEACHERS për edukimin në fëmijërinë e hershme - ISCED 0 (Early Childhood Education and Care professionals -ECEC) është në proces të realizimit.

Instrumenti për vetëvlerësim është ndërtuar sipas specifikave të secilës fushë dhe kompetencë, me kërkesa për nivelet e vlerësimit A1 deri në C2.

Sa për të qenë të informuar për strukturën dhe mënyrën e organizimit të tyre, po japim një shembull të instrumentit për ISCED 1-3 për kompetencën Komunikimi organizativ (kompetenca e parë në fushën e parë):

*Tabela. 5. Progresi dhe deklaratat e niveleve të arritjes për kompetencën Komunikimi organizativ. Burimi: European Framework for the Digital Competence of Educators, f. 35*

<b>Progresi</b>		<b>Deklarata për nivelin</b>
<b>A1 (Fillestar)</b>	Përdorim i pakët i teknologjisë digjitale për komunikim	Unë rrallë e përdor teknologjinë digjitale për komunikim.
<b>A2 (Eksplorues)</b>	Të qenët i vetëdijësuar dhe përdorimi bazik i teknologjive digjitale për komunikim	Unë bëj përdorimin e teknologjive digjitale për komunikim me të tjerët: me nxënësit, prindërit, kolegët, ose me stafin mbështetës.
<b>B1 (Integruar)</b>	Përdorimi i teknologjisë digjitale për komunikim në mënyrë efektive dhe të përgjegjshme	Unë përdor kanale dhe mjete të ndryshme komunikimi digjitale, në varësi të qëllimit të komunikimit dhe kontekst;  Unë komunikoj në mënyrë të përgjegjshme dhe etike me teknologjitë digjitale, p.sh. duke respektuar etiketën dhe politikat e pranueshme të përdorimit (AUP).

<b>B2 (Ekspert)</b>	Përdorimi i teknologjisë digjitale për komunikim në mënyrë të strukturuar dhe të përgjegjshme	Unë zgjedh kanalin, formatin dhe stilin më të përshtatshëm për një qëllim dhe kontekst të caktuar komunikimi;  Unë i përshtat strategjitë e mia të komunikimit me specifikat e audiencës.
<b>C1 (Udhëheqës)</b>	Vlerësim dhe diskutim të strategjive të komunikimit	Unë vlerësoj, reflektoj dhe diskutoj në bashkëpunim se si teknologjitë digjitale përdoren në mënyrë efektive për komunikimi organizativ dhe individual;  Unë përdor teknologjitë digjitale për të bërë procedurat administrative më transparente për nxënësit dhe/ose prindërit dhe t'i lejoj ata të bëjnë zgjedhje të informuara mbi prioritetet e ardhshme të të nxënit.
<b>C2 (Pionier)</b>	Reflektim dhe ridizajnim të strategjive të komunikimit	Unë kontribuoj në zhvillimin e vizionit koherent ose strategjive për përdorimin efektiv dhe me përgjegjësi të teknologjive digjitale për komunikim.

### ***Dhënia e rekomandimeve për zhvillim/avancim***

Për zhvillimin e secilës kompetencë, dokumenti ofron edhe idetë, një listë të aktiviteteve të mundshme, zbatimi i së cilave mund të çojë në avancimin e gjendjes në raport me kompetencën përkatëse. Zakonisht janë aktivitete që ndërlidhen me kërkesat e parashtruara në secilin nivel të vlerësimit (A1-C2) për atë kompetencë. Shembull, për zhvillimin/avancimin e kompetencës Komunikimi organizativ, ndër aktivitetet e sugjeruara ndërlidhen me përdorimin e teknologjisë digjitale për të:

- krijuar burime mësimore shtesë dhe informata në dispozicion për nxënësit, prindërit etj.
- komunikuar procedurat e institucionit me nxënësit dhe prindërit, p.sh. rregullat, takimet, ngjarjet etj.
- informuar nxënësit dhe prindërit në baza individuale, p.sh. për avancimin e fëmijës, për aspektet shqetësuese;

- komunikuar me kolegë brenda institucionit dhe jashtë tij;
- komunikuar me palët e treta relevante për projektet arsimore;
- komunikuar përmjet faqes zyrtare të internetit të institucionit, ose përmes teknologjive digjitale, platformave etj.

Pjesa e fundit e Kornizës ofron shpjegime, përshkrime për konceptet e përdorura/përfshira në dokument (Korniza f. 88-92).

Për qëllime të studimit, në këtë fazë veçojmë dy konceptet bazë:

Për konceptin *Teknologji digjitale* korniza ofron shpjegim më të përgjithshëm dhe përfshin ‘çdo produkt ose shërbim që mund të përdoret për të krijuar, parë, shpërndarë, modifikuar, ruajtur, pranuar, transmetuar dhe merr informacion elektronik në formë digjitale.

Për qëllimet e kornizës DigCompEdu, kategoria e teknologjive digjitale ndahet në *mjete digjitale*, që nënkuptojnë teknologjitë digjitale të përdorura për një qëllim ose funksion të caktuar, p.sh. për përpunimin e informacionit, për komunikim, për krijim të përmbajtjeve, për siguri, ose për zgjidhje të problemeve (PC, laptop, telefon mobil, tablet, tabela interaktive, TV, projektor, kamera etj.) dhe në *përmbajtje digjitale*, që nënkupton çdo lloj përmbajtjeje që ekziston në formë digjitale, të dhënat që janë të koduara në një format të lexueshëm nga makina, dhe mund të krijohen, të shikohen, të shpërndahen, të modifikohen dhe të ruhen duke përdorur teknologjitë digjitale (informata online, website, platforma online, imazhe, audio, video, lojëra online, programe dhe apps edukativë, materiale mësimore, ambiente mësimore virtuale, rrjete sociale etj).

## **Pyetjet e hulumtimit**

Përmes studimit *Niveli i kompetencës digjitale te mësime dhënësit dhe përfshirja e saj në programet e zhvillimit profesional të mësime dhënëseve*, kemi synuar të evidentojmë elemente të kompetencës digjitale në praktikat e punës dhe të zhvillimit profesional të mësime dhënëseve.

### ***Qëllimi i studimit***

Qëllimi i studimit ishte të identifikojë dhe të pasqyrojë nivelin e kompetencës digjitale të mësimit karshi kërkesave të kornizës DigCompEdu, si dhe gjendjen, nevojat dhe mundësitë e zhvillimit të kësaj kompetence përmes programeve të trajnimit. Ofrimi i rekomandimeve për përfshirjen e këtyre qasjeve dhe dokumenteve në politikat dhe praktikën e arsimit parauniversitar në Kosovë, në funksion të avancimit të këtij aspekti në të ardhmen, ishte, gjithashtu, pjesë e këtij studimi.

### ***Objekti i studimit***

Objekti i studimit ishte niveli i mësimit për kompetencën digjitale, si dhe programet e akredituara nga MASHTI në tri vitet e fundit, të prezantuara në katalogët e publikuar në faqen zyrtare të MASHTI-t, me fokus programet nga fusha e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK). Të dy aspektet janë shqyrtuar duke marrë për bazë kërkesat e dokumentit referues DigCompEdu.

### ***Pyetjet kërkimore***

Pyetja kërkimore që ka orientuar studimin është: *Cili është niveli aktual i kompetencave digjitale të mësimit parauniversitar në Kosovë karshi kërkesave të Kornizës DigCompEdu dhe në programet e ZhPM?*

Nënpyetjet që dalin nga pyetja kryesore e studimit janë:

- 1. Cili është niveli i kompetencave digjitale të mësimit fillor dhe të mesëm të ulët (klasat 1-9) karshi kërkesave të Kornizës referuese DigCompEdu?*
- 2. Cilat janë dallimet për kompetencën digjitale të mësimit sipas specifikave demografike, përfshirë edhe ata të Qendrave Burimore?*

3. *Cilat janë qëndrimet e mësimeve për zbatimin e teknologjive digjitale në praktikën e tyre të mësimit?*
4. *Cila është përfshirja e kompetencës digjitale në programet e ZhPM-së të akredituara në MASHTI dhe të prezantuara në katalogët e viteve 2021 dhe 2022?*

## **II. METODOLOGJIA**

### **2.1. Modeli i hulumtimit**

Studimi është realizuar përmes qasjes hulumtuese të kombinuar, që përfshin zbatimin e metodave kualitative dhe kuantitative (mikse), i bazuar në modelin përshkrues dhe vlerësues. Përmes qasjes kualitative janë shqyrtuar literatura, legjislacioni dhe dokumentet përcjellëse lidhur me ZhPM në vend dhe në nivelin ndërkombëtar. Shqyrtimi i programeve për ZhPM, të aprovuara nga MASHTI dhe të publikuara në dy katalogët e fundit (2021 dhe 2022), për të evidentuar përfaqësimin e kompetencës digjitale në to, është gjithashtu pjesë e kësaj qasjeje. Përmes qasjes kuantitative, është evidentuar niveli i përfaqësimit të kësaj kompetence në përvojat e mësimit dhe nxënies të mësimeve të përfshirë në studim, mbi bazën e instrumenteve të dala nga Korniza DigCompEdu.

### **2.2. Popullacioni dhe mostra**

Popullacionin e studimit e përbëjnë mësimeve në nivelin fillor dhe të mesëm (klasat 1-9), që sipas dokumentit Shënime Statistike për Arsimin Parauniversitar (MASHTI, 2022) rezulton të jetë 17099 mësimeve. Nga ky popullacion, mostra e paraparë për përfshirje në studim, sipas formulës Sample size të Research Adviser (2006), Coefidence=95% ; Margin of error =5.0%, ishte 378 mësimeve. Megjithatë, me qëllim të zgjerimit të përfshirjes, në hulumtim janë përfshirë 445 mësimeve në shërbim, përfshirë edhe mësimeve nga Qendrat Burimore për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore në Kosovës (70 mësimeve). Shkolla të rregullta të përfshira janë gjithsej 15, ose 84.3% e mostrës (Prishtinë 18%, Prizren 8.1%, Pejë 9.4%, Gjiilan 10.8%, Gjakovë 6.3%, Mitrovicë 22.2%, Ferizaj 12.2%).

Qendra Burimore të përfshira janë gjithsej 5, ose 15.7% e mostrës (Prishtinë 2.7%, Prizren 6.7%, Mitrovicë 2.7%, Pejë 3.6%).

*Tabela 6. Struktura e mostres sipas specifiikave përkatës*

<b>Fusha kurrikulare (për ivelin 6-9)</b>	<b>Përvoja e punës</b>	<b>Gjinia</b>	<b>Niveli i arsimit</b>
Gjuhët dhe komunikim = 35.8%	1 - 2 vjet = 6.1%	F=78.3%	Fillor =38.8%
Artet =18.9%	3 - 5 vjet = 12.6%	M=21.7%	Mesëm i ulët %61.2=
Matematikë= 8%	6 - 10 vjet = 12.9%		
Shkencat e natyrës= 11.9%	11 - 15 vjet= 16.3%		
Shoqëria dhe mjedisi =10%	16 - 25 vjet= 28.7%		
Edukata fizike, sportet dhe shëndeti= 3%	Mbi 25 vjet= 23.5%		
Jeta dhe puna= 5.5%			
Qendrat burimore =3%			

### 2.3. Metodatat dhe instrumentet

Për realizimin e hulumtimit, janë përdorur metoda e analizës së dokumentacionit, metoda përshkruese (deskriptive) dhe metoda statistikore.

- *Analiza e dokumentacionit* përfshin analizën e kornizës ligjore, dokumentacionit përcjellës, programet aktuale të ZhPM-së, të akredituara nga MASHTI dhe të përfshira në katalogët për vitet 2021, 2022 dhe 2023; Korniza Evropiane e Kompetencës Digjitale për Mësimdhënësit - DigCompEdu, si dhe raporte të studimeve dhe literaturë përkatëse. Për grumbullimin, analizën dhe përgatitjen e gjetjeve për raportim, është përdorur Protokollin e analizës. Mbledhja, përpunimi dhe dokumentimi i të dhënave janë bazuar në modelin e prezantuar nga Pritha Bhandari (2023).

- Për vlerësimin e *nivelit të kompetencave digjitale të mësimdhënësit* e përfshirë në studim, është zbatuar instrumenti i vetëvlerësimit [SELFIEforTEACHERS](#), i cili është i rishikuar së fundmi (2023) nga Komisioni Evropian dhe është i hapur për qasje online dhe vetëvlerësim nga mësimdhënësit e ISCED, 1-3. Me 60 mësimdhënës, hulumtimi është kryer përmes platformës Google Forms, përderisa me 385 mësimdhënës hulumtimi është realizuar drejtpërdrejt, me pyetësorë të printuar në letër.

- Të dhënat demografike të mësimdhënësve janë marrë përmes 7 pyetjeve të bashkëngjitura në instrumentin vetëvlerësues.

- Për marrjen e *qëndrimeve të mësimdhënësve* lidhur me format dhe nivelin e zbatimit të kompetencës digjitale në praktikat e tyre të mësimdhënies dhe nxënies, si dhe për kushtet e shkollave dhe mundësitë e zbatimit të TIK-ut në procesin mësimor, në instrument janë shtuar edhe 10 pyetje të tjera (4+6), me mundësi të përgjigjeve të ndërtuara sipas Shkallës Likert (Renis Likert 1932), me pesë shkallë të vlerësimit (1 = Aspak nuk pajtohem deri te 5 = Plotësisht pajtohem).

- *Opinionet e mësimdhënësve të Qendrave Burimore* për mbulimin e specifikave të nxënësve me aftësi të kufizuara në instrument dhe programe trajnimi janë marrë përmes pyetësorit të intervistës, me 4 pyetje gjysmë të strukturuar, të hartuar vetëm për grupin e mësimdhënësve të Qendrave Burimore.

Për gjashtë fushat e Kornizës DigCompEdu, të përfaqësuara me 22 kompetenca përkatëse të përfshira në instrumentin e vetëvlerësimit, të realizuar me 445 mësimdhënës, analiza faktoriale eksploruese na dha vlerën e testit KMO and Bartlett's Test [Kaiser-Meyer-Olkin Measure of Sampling Adequacy me Bartlett's Test of Sphericity Sig=.000) për secilën fushë dhe tregoi që kjo analizë është valide dhe eksploruese, me vlerat:

Fusha 1 – *Angazhimi profesional*, Cronbach's Alpha =.844; KMO and Bartlett's Test =.904

Fusha 2 – *Burimet digjitale*, Cronbach's Alpha=.767; KMO and Bartlett's Test =.805

Fusha 3 – *Mësimdhënia dhe të nxënit*, Cronbach's Alpha =.779; KMO and Bartlett's Test =.760

Fusha 4 – *Vlerësimi*, Cronbach's Alpha =.704; KMO and Bartlett's Test =.648

Fusha 5 – *Fuqizimi i nxënësve*, Cronbach's Alpha =.778; KMO and Bartlett's Test =.788

Fusha 6 – *Lehtësimi i kompetencës digjitale të nxënësve*, Cronbach's Alpha =.846; KMO and Bartlett's Test = .862.

## **2.4. Procedura e mbledhjes dhe analizës së të dhënave**

Hulumtimi në terren/shkolla është realizuar brenda periudhës shkurt-qershor 2023.

Të dhënat nga hulumtimi, sa i përket pjesës së analizës së programeve të ZhPM-së, janë mbledhur në muajin mars 2023 dhe janë sistemuar në Protokollin e analizës, pastaj janë përpunuar, analizuar dhe janë nxjerrë draft-rezultatet e para të hulumtimit për këtë pjesë. Periudha prill-maj 2023 ka qenë koha e realizimit të hulumtimit online dhe në shkolla. Për plotësimin e instrumentit të printuar në formë fizike (në letër), mësimitdhënësit kanë pasur në dispozicion së paku dy javë për ta plotësuar, ndërsa plotësimi i instrumentit në formën online, përmes Google Forms, është bërë sipas dëshirës dhe kohës në dispozicion të mësimitdhënësve. Të dhënat e mbledhura përmes pyetësorit Google Forms dhe të anketës janë sistemuar dhe përpunuar përmes paketës statistikore SPSS 21. Për analizën e të dhënave nga intervista me 70 mësimitdhënës të Qendrave Burimore dhe nga fokus-grupi me 30 mësimitdhënës është zbatuar metoda e analizës së përmbajtjes dhe gjetjet janë interpretuar dhe përshkruar të detajuara për aspektet me interes për studimin. Kjo qasje mundësoi që të dhënat e mbledhura të grupohen në kategori tematike dhe të lidhen me pyetjet kërkimore. Kjo është realizuar në muajt qershor dhe korrik, ndërsa muaji gusht përfshin analizën, sintezën dhe dokumentimin e gjetjeve në draft-raportin e studimit.

Në muajin shtator është hartuar raporti final i studimit dhe u është nënshtuar procedurave për botim.

## **III. REZULTATET E STUDIMIT**

Te rezultatet e studimit, lexuesit duhet t'i ofrohet informacioni se *çfarë është gjetur* në studim dhe shërbejnë për t'u dhënë përgjigje pyetjeve kërkimore, pa u përpjekur për t'i analizuar ose interpretuar ato (Ammon, 2020). Te kjo pjesë e raportit, gjetjet prezantohen të 'paketuara' në një format (ose një shumëllojshmëri formatesh), në atë mënyrë që ato të mund të kuptohen dhe

të përdoren nga audienca të shumta dhe t'u mundësojnë lexuesve të gjejnë shpejt informacionin që dëshirojnë (Volkwein, 2010).

Mbi këtë bazë, jemi angazhuar që rezultatet e studimit tonë të paraqiten të ndërlidhura me kontekstin dhe pyetjet e hulumtimit të parashtruara te pika 1.2.

Prezantimi i gjetjeve është i kombinuar dhe i integruar, me grafikë ose tabela të përmbledhura. Rëndësi të veçantë i kemi dhënë ofrimit të informacionit të qartë dhe lehtësisht të kuptueshëm për lexuesin, të organizuar në tri pjesë kryesore:

- Rezultatet e dala nga vetëvlerësimet e mësimitdhënësve përmes instrumentit [SELFIEforTEACHERS](#), përfshirë edhe dallimet sipas specifikave të mësimitdhënësve;
- Qëndrimet e mësimitdhënësve për zbatimin e teknologjive digjitale në praktikat e tyre të mësimitdhënies;
- Rezultatet për përfshirjen e kompetencës digjitale në programet e ZhPM-së, të akredituara në MASHTI.

Diskutimi i rezultateve, përfundimet dhe rekomandimet, për avancimin e kësaj kompetence të mësimitdhënësit dhe më gjerë në të ardhmen, do të jenë gjithashtu pjesë finale e raportit.

### **3.1. Niveli i kompetencave digjitale të mësimitdhënësit të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët (klasat 1- 9) karshi kërkesave të Kornizës referuese DigCompEdu**

Sic është shpjeguar edhe më lart, vetëvlerësimi përmes [SELFIEforTEACHERS](#) synon të ndihmojë mësimitdhënësit të kuptojnë anët e tyre të forta, por edhe mangësitë në raport me posedimin dhe zbatimin e kompetencave digjitale në angazhimet e profesionit.

Me të dhënat e dala nga studimi, fillimisht janë realizuar disa teste, të cilat na mundësuan të vazhdohet më tutje me analiza dhe dokumentim të gjetjeve.

### ***Perceptimet e mësimeve për nivelin kompetencave të tyre digjitale para vetëvlerësimit***

Pyetja e parë e ofruar në instrumentin e vetëvlerësimit, e që njehet si Paratest, është: *Si do ta përshkruanit kompetencën tuaj digjitale para vetëvlerësimit?* Pra, fillimisht nga mësuesit kërkohet që të japin perceptimet se si ata e vlerësojnë nivelin personal për kompetencat digjitale, para se të hyjnë në vetëvlerësimin për 22 kompetencat përkatëse. Pyetja është e ndërtuar me mundësi të përgjigjes në vetëm njërin nga gjashtë alternativat e ofruara.

Gjetjet për këtë pyetje (M=2.78 dhe D.St=1.60) kanë treguar se kemi vetëvlerësime me përqindje dukshëm më të larta te niveli i A2 – Eksplorues, me 27.21% dhe A1- Fillestar, me 26.08%. Krahasuar me Taksonominë, me përqindje më të lartë përgjigjet u referohen gjithashtu nivelit të dytë (Kupto) dhe nivelit të parë (Kujto).

*Tabela 7. Perceptimet e mësimeve për kompetencën digjitale – Paratesti*

Përshkrimi	Niveli	%
A1- Fillestar	Di se si teknologjitë digjitale mund të përmirësojnë praktikën time profesionale;	26.0
A2-Eksplorues	Jam përpjekur të përdor teknologji digjitale në praktikën time profesionale;	27.2
B1-Integruar	Unë përdor rregullisht teknologjitë digjitale në praktikën time profesionale;	14.9
B2-Ekspert	Unë përdor teknologjitë digjitale me besim dhe në mënyrë kritike për të përmirësuar praktikën time profesionale;	13.6
C1-Udhëheqës	Unë përdor teknologjitë digjitale në mënyra strategjike, duke ndarë ekspertizën time me nxënësit dhe kolegët e mi;	9.07
C2-Pionier	Unë inicioj mënyra strategjike dhe inovative për të përdorur teknologjitë digjitale në komunitetin e shkollës sime dhe më gjerë.	9.07

### ***Niveli i kompetencave digjitale te mësuesit, sipas gjashtë fushave të Kornizës DigCompEdu***

Pas paratestit, instrumenti ofron mundësinë e vetëvlerësimit në 22 kompetencat specifike, të organizuara në gjashtë fushat e Kornizës

DigCompEdu, të përfaqësuar me gjithsej 32 kërkesa specifike në instrumentin e vetëvlerësimit, sipas shpërndarjes:

Fusha 1 – Angazhimi profesional - 9 kërkesa;

Fusha 2 – Burimet digjitale - 5 kërkesa;

Fusha 3 – Mësimdhënia dhe të nxënit – 5 kërkesa;

Fusha 4 – Vlerësimi - 3 kërkesa;

Fusha 5 – Fuqizimi i nxënësve - 4 kërkesa;

Fusha 6 – Lehtësimi i kompetencës digjitale të nxënësve - 6 kërkesa.


Për secilën kërkesë, janë ofruar 7 deklaratat/alternativa për përgjigje, me mundësi të përgjigjes në vetëm njërën nga to. Gjashtë deklaratat/alternativat e para janë të ndërtuara mbi bazën e niveleve të vlerësimit A1 deri në C2. Në alternativën e shtatë mësimdhënësi ka mundur të deklarohet edhe jashtë gjashtë niveleve, se nuk ka dijeni për kompetencën përkatëse.

Gjetjet nga analiza përshkruese për 22 kompetencat, me 32 kërkesat përkatëse (veprimi Compute Variable) për shkallët e vlerësimit 1 deri 7, mesataren e përgjithshme e kemi  $M=2.64$ , me  $D.St.=1.41$ . Specifikuar në fushën përkatëse, të dhënat i kemi si në tabelën nr. 8

*Tabela 8. Mesataret e rezultateve sipas fushave të DigCompEdu*

	Mean	D.St.
Fusha 1 – Angazhimi profesional	2.76	1.43
Fusha 2 – Burimet digjitale	2.45	1.39
Fusha 3 – Mësimdhënia dhe të nxënit	1.90	1.10
Fusha 4 – Vlerësimi	1.95	1.20
Fusha 5 – Fuqizimi i nxënësve	2.37	1.54
Fusha 6 – Lehtësimi i kompetencës digjitale të nxënësve	2.34	1.50

Referuar niveleve të CEFR, rezultatet treguan se për 22 kompetencat me 32 kërkesat përkatëse (veprimi Compute Variable në një variable të vetme) kemi dominim të përqindjeve më të larta (Cumulative percent=77.4%) të deklarimeve të tri niveleve të para: Eksplorues (A2)/Kupto, me 28.3%; Integrues (B1)/Zbato, me 25.8%; dhe Fillestar (A1)/Kujto, me 23.3%.



Grafiku 2. Niveli i kompetencave të mësimeve për pesë fushat e DigCompEdu

### ***Krahasimet e gjetjeve sipas specifikave demografike të mësimeve***

Referuar specifikave të mostrës (dy grupe) së përfshirë në studim, janë vërejtur disa dallime në mesataren e rezultateve. Referuar Group Statistics te analiza Independent Samples Test, shohim disa dallime në mesataret e rezultateve:

- Rezultatet e dala nga vetëvlerësimi i mësimeve, përmes instrumentit në formë fizike/të printuar janë më të larta ( $M=2.71$ ), krahasuar me mësimeve që kanë plotësuar pyetësorin online përmes Google Forms ( $M=2.37$ );
- Mësimeve e gjinisë femërore kanë rezultate më të ulëta ( $M=2.47$ ) krahasuar me ata të gjinisë mashkullore ( $M=3.16$ );
- Mësimeve e nivelit të mesëm të ulët (6-9) kanë rezultate më të larta ( $M=2.76$ ), krahasuar me ata të arsimit fillor (2.45).

Pavarësisht dallimeve në mesatare, analiza *Independent Samples Test* për këto grupe ka treguar se **nuk ka** dallime statistikisht të rëndësishme (signifikante) në rezultatet e vetëvlerësimit përmes instrumentit [SELFIEforTEACHERS](#), sa u përket specifikave të përmendura më lart.

*Tabela 9. Analiza Independent Samples Test dhe signifikanca në dallime statistikore*

Specifika		Mean	D.St.	t	Sig. (2-tailed), p < .05
Niveli i arsimit	Fillor (1-5)			t(277)= 1.758	p=.08
	I mesëm i ulët (6-9)	2.45	1.26		
Gjinia	Meshkuj	2.76	1.48	t(277)=3.590	p=.06
	Femra	3.16	1.63		
Forma e plotësimi	Online-Google Forms	2.47	1.29	t(281)= 1.691	p=.09
	Ne print/fizike	2.37	1.00		

Për të parë dallimet referuar specifike të tjera të mostrës (më shumë se dy grupe), është bërë analiza *One-Way ANOVA*.

Sa u përket rezultateve të vetëvlerësimit sipas fushave kurrikulare, në të cilat mësimdhënësit japin mësim, analiza tregoi dallime në mesataren e grupeve, përfshirë edhe Qendrat Burimore, në të cilat mësimdhënësit mund të jenë të angazhuar në më shumë se një fushë kurrikulare. Referuar analizës përshkuese (Descriptives), shohim se mesatare më të larta kemi te fusha *Jeta dhe puna* (M=3.50), vijuar me fushën *Shoqëria dhe mjedisi* (M=3.08) dhe *Edukata fizike, sportet dhe shëndeti* (M=2.89).

*Tabela 10. Mesataret e vetëvlerësimit sipas fushave kurrikulare*

	Mean	D.St.
Gjuhët dhe komunikimi	2.60	1.44
Artet	2.64	1.69
Matematika	2.56	1.25
Shkencat natyrore	2.78	1.64
Shoqëria dhe mjedisi	3.08	1.53
Edukata fizike, sportet dhe shëndeti	2.89	1.83
Jeta dhe puna	3.50	1.55
Qendrat Burimore	2.67	1.86

Megjithatë, analiza *One-Way ANOVA* (me Levene statistic - Homogeneity of Variances p=.222) ka treguar se dallimet sa i përket fushës kurrikulare,

në të cilën japin mësim mësimdhënësit, nuk janë statistikisht signifikante, meqenëse vlera e Sig. për grupet është  $p=.185$  (më e madhe se  $p=0.05$ ).

E njëjta analizë është bërë edhe për të parë rezultatet e vetëvlerësimit sipas viteve të përvojës së punës së mësimdhënësve. Rezultatet treguan dallime në mesataren e grupeve. Referuar analizës përshkruese (Descriptives), shohim se mesatare më të larta kemi nga mësimdhënësit me përvojë pune 6 -10 vjet ( $M=3.03$ ).

*Tabela 11. Mesataret e vetëvlerësimit sipas përvojës së punës*

	Mean	D.St
1-2 vjet	2.22	1.16
3-5 vjet	2.95	1.35
6-10 vjet	3.03	1.64
11-15 vjet	2.67	1.37
16 -25 vjet	2.59	1.30
Mbi 25 vjet	2.40	1.49

Edhe për këto aspekte, analiza One-Way ANOVA (me Levene statistic - Homogeneity of Variances  $p=.629$ ) ka treguar se dallimet, sa u përket viteve të përvojës së punës, nuk janë statistikisht signifikante, meqenëse vlera e Sig. është  $p=.157$  (më e madhe se  $p=0.05$ ).

### **Fusha 1 - Angazhimi profesional**

#### *Përdorimi i teknologjisë digjitale për komunikim, bashkëpunim dhe zhvillim profesional*

Te fusha e parë, fokusi qëndron në përdorimin e teknologjisë digjitale si ndihmë në praktikën profesionale të mësimdhënësve, për t'u qasur në informacion dhe për të përmirësuar praktikat e tyre të mësimdhënies dhe të të nxënit. Sipas përshkrimit, mësimdhënësit mund të përdorin gjithashtu teknologjinë për të komunikuar dhe mbështetur nxënësit dhe prindërit, si dhe për të ndarë e mësuar me kolegët dhe të tjerët përtej shkollës. Nëpërmjet teknologjive digjitale, mësimdhënësit mund të përmirësojnë zhvillimin e tyre profesional dhe të mbështesin përmirësimin e përgjithshëm të organizatës dhe profesionit të tyre.

Vetëvlerësimi në këtë fushë përfshin katër kompetencat e para të kornizës: Komunikimi organizativ, Bashkëpunimi profesional, Praktikrat e reflektimit,


dhe Zhvillimi i vazhdueshëm profesional digjital. Këto janë zbërthyer pastaj nëntë (9) kërkesa specifike për vetëvlerësim. Rezultatet treguan se për shkallët e vlerësimit 1 deri në 7 arritjet më të larta, të shprehura në mesataren e arritjeve, i kemi te tri kompetencat e para, sidomos te Menaxhimi i mjediseve të të mësuarit në internet, duke marrë parasysh menaxhimin e të dhënave dhe etikën (M=3.49), te tabela 12.

Të dhënat e plota për secilën kompetencë, kërkesë, dhe alternativat përkatëse, mund të gjenden në shtojcën numër 1, në fund të raportit.

*Tabela 12. Mesatarja dhe devijimi standard per nëntë kërkesat/deklaratat e fushës së parë*

Kompetenca	Mean	D.St
1.1. Komunikimi organizativ - Përdorimi i teknologjive digjitale për të përmirësuar komunikimin me kolegët dhe/ose nxënësit dhe/ose prindërit	2.95	1.57
1.2. Mjediset e të mësuarit në internet - Menaxhimi i mjediseve të të mësuarit në internet duke marrë parasysh menaxhimin e të dhënave dhe etikën.	3.49	1.52
1.3. Bashkëpunimi profesional - Përdorimi i teknologjive digjitale për t'u përfshirë në bashkëpunim dhe ndërveprim me kolegët dhe/ose aktorë të tjerë të arsimit.	2.79	1.61
1.4. Teknologjitë digjitale dhe infrastruktura e nivelit të shkollës - Përdorimi i teknologjive digjitale (pajisje, platforma dhe softuer) dhe infrastruktura (qasja në internet, rrjeti lokal) e disponueshme në shkollën time për të përmirësuar arsimin.	3.16	1.84
1.5. Praktika reflektuese - Reflektim në praktikën time profesionale dhe kolektive me përdorimin e teknologjive digjitale.	2.56	1.738
1.6. Jeta digjitale - Kontributi pozitiv dhe etik në botën digjitale, duke marrë parasysh praktikat digjitale të sigurta dhe të përgjegjshme.	2.95	1.749
1.7. Të nxënit profesional (përmes teknologjive digjitale) - Përdorimi i teknologjive digjitale për të nxënit profesional.	2.40	1.374
1.8. Të nxënit profesional (për teknologjitë digjitale) - Angazhimi në aktivitete të të nxënit profesional për zhvillimin e kompetencës digjitale të mësuesve.	2.57	1.503
1.9. Të menduarit kompjuterik - Angazhimi me konceptet dhe proceset e të menduarit kompjuterik si pjesë e kompetencës digjitale të mësimeve	2.62	1.672

Referuar niveleve, rezultatet treguan se për nëntë kërkesat e kësaj fushe (veprimi Compute Variable në një variable të vetme) kemi dominim të përqindjeve më të larta të deklarimeve të tri niveleve të para: A2 - Eksplorues, me 27.7%; B1 - Integruar, me 22.6% dhe A1- Fillestar, me 20.9%.



*Figura 3. Niveli i kompetencave të mësimdhënësve për fushën e parë - Angazhimi profesional*

## **Fusha 2 – Burimet digjitale**

### *Burimet, krijimi dhe shpërndarja e burimeve digjitale*

Informacioni për fushën e dytë orienton në faktin se mësimdhënësit kanë potencialisht një gamë të gjerë burimesh digjitale në dispozicion të tyre. Është e rëndësishme që ata të identifikojnë në mënyrë efektive burimet që u përshtaten më mirë nevojave të tyre, stilit të mësimdhënies dhe nxënësve të tyre. Ata, gjithashtu, mund të kenë nevojë të mësojnë se si të modifikojnë dhe të përshtatin burimet për të përmbushur kërkesat e tyre ekzakte ose të krijojnë burime të reja. Në të njëjtën kohë, ata duhet të mësojnë se si të ndajnë burimet digjitale me përgjegjësi, të mbrojnë të dhënat e ndjeshme dhe të menaxhojnë përmbajtjen në mënyrë etike dhe të respektojnë rregullat e të drejtave të autorit.


Vetëvlerësimi në këtë fushë përfshin tri kompetencat vijuese të kornizës: (1) Përzgjedhja e burimeve digjitale, (2) Krijimi dhe përshtatja e burimeve digjitale, (3) Menaxhimi, mbrojtja dhe ndarja e burimeve digjitale. Këtu janë zberthyer pastaj pesë kërkesa specifike për vetëvlerësim. Rezultatet treguan se për shkallët e vlerësimit 1 deri 7 arritjet më të larta, të shprehura në mesataren e arritjeve, i kemi të dy kompetencat e para, sidomos të Kërkimi

dhe përzgjedhja (Përdorimi i kritereve të kërkimit dhe përzgjedhjes për të identifikuar burimet digjitale për mësimdhënie dhe mësimnxënie) (M=3.16), tabela 13. Të dhënat e plota për secilën kompetencë, kërkesë dhe alternativat përkatëse, mund të gjenden në shtojcën 2 në fund të raportit.

*Tabela 13. Mesatarja dhe devijimi standard për nëntë kërkesat/deklaratat e fushës së dytë*

Kompetenca	Mean	D.St
2.1. Kërkimi dhe përzgjedhja (Përdorimi i kritereve të kërkimit dhe përzgjedhjes për të identifikuar burimet digjitale për mësimdhënie dhe nxënie)	3.16	1.70
2.2. Krijimi (Krijimi i burimeve digjitale që mbështesin dhe përmirësojnë qëllimet e mësimdhënies dhe të nxënimit)	2.62	1.48
2.3. Modifikimi (Modifikimi i burimeve ekzistuese digjitale për të mbështetur dhe përmirësuar qëllimet e mësimdhënies dhe nxënies, duke respektuar të drejtat e autorit dhe rregullat e licencimit)	3.09	1.89
2.4. Menaxhimi, mbrojtja (Organizimi i përmbajtjes digjitale, duke mundësuar qasje të lehtë dhe të sigurt për nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit, duke mbrojtur të dhënat e ndjeshme dhe personale)	2.53	1.66
2.5. Ndarja (Ndarja e përmbajtjes digjitale në lidhje me pronësinë intelektuale dhe rregullat e të drejtës së autorit)	2.49	1.83

Referuar niveleve të CEFR, rezultatet treguan se për pesë kërkesat e kësaj fushe (veprimi Compute Variable në një variabël të vetme) kemi dominim të përqindjeve më të larta të deklaramëve të tri niveleve të para: A1- Fillestar, me 33.6%; B1 – Integruar, me 24.4%, dhe A2 – Eksplorues, me 22.9%.



*Figura 4. Niveli i kompetencave të mësimdhënësve për fushën e dytë - Burimet digjitale*

### Fusha 3 – Mësimdhënia dhe të nxënit

*Menaxhimi dhe orkestrimi i përdorimit të teknologjisë digjitale në procesin e mësimdhënies dhe të nxënit*

Përshkrimi për fushën e tretë orienton informacionin se si teknologjitë digjitale mund të avancojnë dhe përmirësojnë praktikën e mësimdhënies dhe nxënies në një sërë mënyrash. Një aftësi kyçe e mësimdhënësve është të dizajnojnë mësimin me përdorimin e teknologjive digjitale për t'i ndihmuar nxënësit të angazhohen në mënyrë aktive në përvojat autentike të të nxënit. Praktika e avancuar përfshin një zhvendosje nga aktivitetet e udhëhequra nga mësimdhënësi në aktivitetet e përqendruara te nxënësi.


Vetëvlerësimi për fushën e tretë përfshin katër kompetencat vijuese të kornizës: Mësimdhënia, Udhëzimet, Të mësuarit në bashkëpunim dhe Të mësuarit e vetëdrejtuar.

Këto janë zbërthyer pastaj pesë (5) kërkesa specifike për vetëvlerësim. Rezultatet treguan se për shkallët e vlerësimit 1 deri 7 arrijtjet më të larta, të shprehura në mesataren e arritjeve, i kemi te tri kompetencat e fundit, sidomos te Të mësuarit e vetëdrejtuar (Mean=2.89), te tabela numër 14. Të dhënat e plota për secilën kompetencë, kërkesë dhe alternativë përkatëse, mund të gjenden në shtojcën 3, në fund të raportit.

*Tabela 14. Mesatarja dhe devijimi standard per nëntë kërkesat/deklaratat e fushës së tretë*

Kompetenca	Mean	D.St
3.1 Mësimdhënia (Projektimi, zhvillimi dhe mbështetja e të nxënit me përdorimin e teknologjive digjitale për të përmirësuar rezultatet e të nxënit)	2.41	1.42
3.2 Udhëzime (Përdorimi i teknologjive digjitale për të ofruar reagime dhe mundësi për reflektim, duke çuar në ripërshtatjen e praktikave të mësimdhënies dhe nxënies si për mësimdhënësit ashtu edhe për nxënësit)	2.47	1.58
3.3 Mësimnxënia në bashkëpunim (Përdorimi i teknologjive digjitale për të nxitur dhe përmirësuar bashkëpunimin e nxënësve për mësimnxënien individuale dhe kolektive	2.65	2.59
3.4 Të nxënit e vetërregulluar (Përdorimi i teknologjive digjitale për të përmirësuar proceset e të nxënit të vetë-rregulluar të nxënësve, duke nxitur të nxënit aktiv dhe autonom duke i bërë studentët më të përgjegjshëm për të nxënit e tyre, duke zhvendosur fokusin nga mësimdhënia në nxënie)	2.89	1.90
3.5 Teknologjitë në zhvillim (Përdorimi i teknologjive në zhvillim në mënyra etike për të eksploruar përvoja dhe përmbajtje të reja mësimore)	2.58	1.93

Referuar niveleve të CEFR, rezultatet treguan se për pesë kërkesat e kësaj fushe (veprimi Compute Variable në një variable të vetme) kemi dominim të përqindjeve më të larta të deklarimeve të tri nivelet e para: A1 - Fillestar, me 47.3%; A2 – Eksplorues, me 24.3% dhe B1 – Integruës, me 19.7%.



*Figura 5. Niveli i kompetencave të mësimit të tretë - Mësimdhënia dhe të nxënësve*

## **Fusha 4 – Vlerësimi**

### ***Përdorimi i teknologjive digjitale dhe strategjitë për rritjen e vlerësimit***

Te fusha e katërt - Vlerësimi fokusi qëndron në përdorimin e teknologjive digjitale për të përmirësuar praktikën ekzistuese të vlerësimit dhe lehtësimin e praktikave të reja dhe novatore. Sipas përshkrimeve, mësimit mund të përdorin teknologjitë digjitale për të mbledhur të dhëna për të mbështetur dhe vlerësuar më mirë nxënësit, duke u mundësuar atyre të reflektojnë dhe të përshtatin praktikën e tyre të mësimdhënies.

Vetëvlerësimi për fushën e katërt përfshin tri kompetencat vijuese të kornizës: Strategji për vlerësim, Dëshmi për analizë, Informatë kthyesë dhe planifikim.


Këto janë zbrërthyer në tri (3) kërkesa specifike për vetëvlerësim. Rezultatet treguan se për shkallët e vlerësimit 1 deri 7 arrijtjet më të larta, të shprehura në mesataren e arritjeve, i kemi të kompetenca e tretë: Informatë kthyesë dhe

planifikim ( $M=2.93$ ), te tabela 15. Të dhënat e plota për secilën kompetencë, kërkesë dhe alternativat përkatëse mund të gjenden në shtojcën 4 në fund të raportit.

*Tabela 15. Mesatarja dhe devijimi standard per nëntë kërkesat/deklaratat e fushës së katërt*

Kompetenca	Mean	D.St
4.1 Vlerësimi - Strategjitë e vlerësimit (Përdorimi i teknologjive digjitale për të mbështetur vlerësimin formativ dhe përmbledhës të nxënësit)	2.58	1.70
4.2 Analizimi i provave (Përdorimi i teknologjive digjitale për të mbledhur dhe analizuar prova mbi proceset dhe rezultatet e të nxënësit të nxënësve	2.59	1.78
4.3 Reagimi dhe planifikimi (Përdorimi i teknologjive digjitale për të ofruar komente për nxënësit, duke lehtësuar planifikimin e veprimeve të mëtejshme).	2.93	2.31

Referuar niveleve të CEFR dhe Taksonomisë Bloom, rezultatet treguan se për tri kërkesat e kësaj fushe (veprimi Compute Variable në një variable të vetme) kemi dominim të përqindjeve më të larta të deklarimeve te tri nivelet e para: A1 – Fillestar, me 50.2%; A2 – Eksplorues, me 21.1% dhe B1-Integruës, me 16.6%.



*Figura 6. Niveli i kompetencave të mësimdhënësve për fushën katërt - Vlerësimi*

## Fusha 5 – Fuqizimi i nxënësve

*Përdorimi i teknologjisë digjitale për rritjen e gjithëpërfshirjes, personalizimit dhe angazhimit aktiv të nxënësve*

Sipas përshkrimit për këtë fushë, përdorimi i teknologjive digjitale mund t'i ndihmojë mësimdhënësit të krijojnë përvoja inovative të të nxënësve, duke rezultuar me angazhim të nxënësve në mënyrë më aktive. Teknologjitë digjitale mund të përdoren nga mësimdhënësit për të personalizuar nxënien dhe për ta përshtatur atë sipas niveleve, interesave dhe nevojave individuale të nxënësve. Megjithatë, është e rëndësishme të shmangët përforcimi i pabarazisë, për shembull në aspektin e qasjes së nxënësve në teknologji ose mungesës së aftësive. Qasja për të gjithë nxënësit është thelbësore, përfshirë ata me nevoja të veçanta arsimore.


Vetëvlerësimi për fushën e pestë përfshin tri kompetencat vijuese të kornizës: Qasje dhe githëpërfshirje, Diferencim dhe personalizim, Angazhim aktiv i nxënësve.

Këto janë zbrërthyer në katër kërkesa specifike për vetëvlerësim. Rezultatet treguan se për shkallët e vlerësimit 1 deri 7 arrijtjet më të larta, të shprehura në mesataren e arritjeve, i kemi të kompetenca e dytë: Diferencim dhe personalizim (M=2.81), të tabela 16. Të dhënat e plota për secilën kompetencë, kërkesat dhe alternativat përkatëse, mund të gjenden në shtojcën 5 në fund të raportit.

*Tabela 16. Mesatarja dhe devijimi standard per nëntë kërkesat/deklaratat e fushës së pestë*

Kompetenca	Mean	D.St
5.1. Qasja dhe përfshirja (Sigurimi i qasjes në burimet digjitale dhe aktivitetet mësimore për të gjithë studentët, duke marrë parasysh çdo kufizim kontekstual, fizik ose kognitiv për përdorimin e tyre)	2.63	1.84
5.2. Diferencimi dhe personalizimi (Përdorimi i teknologjive digjitale për të adresuar nevojat dhe aftësitë e ndryshme të të nxënësve, duke i lejuar nxënësit të avancojnë në nivele dhe shpejtësi të ndryshme dhe të ndjekin rrugët dhe objektivat individuale të të nxënësve)	2.81	1.95
5.3. Angazhimi aktiv i nxënësve (Përdorimi i teknologjive digjitale për të nxitur angazhimin aktiv dhe krijues të nxënësve në mësimin e tyre)	2.63	1.72
5.4. Mësimnxënja e kombinuar (Përdorimi i burimeve dhe mjeteve digjitale, mjediseve dhe platformave të të nxënësve në internet për të siguruar të nxënësit e studentëve brenda dhe jashtë klasës)	2.50	1.62

Gjetjet për nivelet e CEFR treguan se për katër kërkesat e kësaj fushe (veprimi Compute Variable në një variable të vetme) kemi dominim të përqindjeve më të larta të deklarimeve të tri nivelet e para: A1 – Fillestar, me 40.7%; A2 – Eksplorues, me 21% dhe B1 – Integruës, me 15.9%.



*Figura 7. Niveli i kompetencave të mësimdhënësve për fushën e pestë - Fuqizimi i nxënësve*

## **Fusha 6 – Lehtësimi i kompetencës digjitale të nxënësve**

*Përdorimi i teknologjisë digjitale në mënyrë kreative dhe me përgjegjësi nga ana e nxënësve, për qëllime të komunikimit, krijimit e përmbajtjeve, mirëqenie dhe zgjidhje të problemeve*

Te kjo fushë theksohet rëndësia që kanë kompetencat digjitale të mësimdhënësve për të mbështetur dhe lehtësuar zhvillimin e kompetencës digjitale të nxënësve të tyre.


Vetëvlerësimi për këtë fushë përfshin pesë kompetencat vijuese të kornizës: (1) Shkathtësitë (literacy) për media dhe informim, (2) Komunikimi dhe bashkëpunimi digjital, (3) Krijimi i përmbajtjeve digjitale, (4) Përdorimi i përgjegjshëm, (5) Zgjidhja e problemeve në mënyrë digjitale.

Këto janë zbërthyer në gjashtë (6) kërkesa specifike për vetëvlerësim. Rezultatet treguan se për shkallët e vlerësimit 1 deri 7 arritjet më të larta, të shprehura në mesataren e arritjeve, i kemi të kompetenca e katërt: Përdorimi i përgjegjshëm ( $M=2.77$ ), të tabela 17. Të dhënat e plota për secilën kompetencë, kërkesat dhe alternativat përkatëse, mund të gjenden në shtojcën 6, në fund të raportit.

*Tabela 17. Mesatarja dhe devijimi standard per nëntë kërkesat/deklaratat e fushës së gjashtë*

Kompetenca	Mean	D.St
6.1. Leximi i informacionit dhe i të dhënave (Përfshirja e aktiviteteve mësimore, të cilat kërkojnë nga nxënësit të përdorin teknologjitë digjitale për të kërkuar, vlerësuar dhe menaxhuar informacionin dhe të dhënat në mjediset digjitale)	2.59	1.77
6.2. Komunikimi dhe bashkëpunimi (Zbatimi i aktiviteteve mësimore që kërkojnë nga nxënësit të komunikojnë dhe të bashkëpunojnë duke përdorur teknologjitë digjitale)	2.47	1.73
6.3. Krijimi i përmbajtjes (Përfshirja e aktiviteteve mësimore që kërkojnë nga nxënësit të shprehin veten duke krijuar artefakte digjitale)	2.67	1.77
6.4. Siguria dhe mirëqenia (Fuqizimi i nxënësve për të përdorur teknologjitë digjitale në mënyrë të sigurt, duke zbutur rreziqet për të siguruar mirëqenien fizike, psikologjike dhe sociale)	2.77	2.01
6.5. Përdorimi i përgjegjshëm (Fuqizimi i nxënësve për të përdorur teknologjitë digjitale në mënyrë të përgjegjshme dhe etike, duke menaxhuar gjurmët digjitale të identitetit të tyre digjital dhe reputacionin digjital)	2.74	1.96
6.6. Zgjidhja e problemeve (Përfshirja e aktiviteteve mësimore, ku nxënësit përdorin teknologjitë digjitale për të kuptuar dhe zgjidhur problemet)	2.72	1.78

Referuar niveleve të CEFR, rezultatet treguan se për katër kërkesat e kësaj fushe (veprimi Compute Variable në një variable të vetme) kemi dominim të përqindjeve më të larta të deklarimeve të tri nivelet e para: A1 – Fillestar, me 42.3%; A2 – Eksplorues, me 20% dhe B1- Integruës, me 16.7% . Figura 8.



*Figura 8. Niveli i kompetencave të mësimdhënësve për fushën e gjashtë - Lehtësimi i kompetencës digjitale të nxënësve*

### ***Perceptimet e mësimeve për nivelin kompetencave të tyre digjitale pas vetëvlerësimit***

Pyetja përmbyllëse, e ofruar në instrumentin e vetëvlerësimit për nivelet e kompetencave digjitale të mësimeve dhe që njëherësh njihet si pastest, është kjo: *Si do ta përshkruanit kompetencën tuaj digjitale pas vetëvlerësimit?* Pra, përderisa në fillim të vetëvlerësimit nga mësuesit u kërkua të vlerësojnë nivelin hyrës për kompetencat digjitale, tani, pas kalimit nëpër të gjitha fushat, kompetencat dhe kërkesat përkatëse, nga ta kërkohet që të japin perceptimet e tyre se si i vlerësojnë ata tani kompetencat e tyre digjitale.

Sikurse te paratesti, edhe tani, pyetja është e ndërtuar me mundësi të përgjigjes në vetëm njërin nga gjashtë alternativat e ofruara.

Gjetjet për këtë pyetje (M= 2.66 dhe D.St.1.48) kanë treguar se kemi vetëvlerësime me përqindje dukshëm më të larta te niveli A1- Fillestar, me 28.2% dhe A2 – Eksplorues, me 25.6%. Krahasuar me Taksonominë, përgjigjet me përqindje më të lartë i referohen nivelit të parë (Kujto) dhe nivelit të dytë (Kupto), tabela 18.

*Tabela 18. Perceptimet e mësimeve për kompetencën digjitale - paratesti*

Përshkrimi	Niveli	%
A1-Fillestar	Di se si teknologjitë digjitale mund të përmirësojnë praktikën time profesionale;	28.2
A2-Eksplorues	Jam përpjekur të përdor teknologji digjitale në praktikën time profesionale;	25.6
B1-Integruar	Unë përdor rregullisht teknologjitë digjitale në praktikën time profesionale;	15.5
B2-Ekspert	Unë përdor teknologjitë digjitale me besim dhe në mënyrë kritike për të përmirësuar praktikën time profesionale;	17.2
C1-Udhëheqës	Unë përdor teknologjitë digjitale në mënyra strategjike, duke ndarë ekspertizën time me nxënësit dhe kolegët e mi;	8.9
C2-Pionier	Unë inicioj mënyra strategjike dhe inovative për të përdorur teknologjitë digjitale në komunitetin e shkollës sime dhe më gjerë.	4.5

Sipas përqindjeve, vërehen dallime të vogla në perceptimet e mësimeve për kompetencat e tyre digjitale para dhe pas vetëvlerësimit. Sa për ilustrim, vërehet rritje te niveli i parë, A1 - Fillestar nga Paratesti

(26%) në Pasest (28.2%), përderisa kemi ulje të përqindjeve te niveli më i lartë, C2-Pionier nga Paratest (9.8%) në Pastest (4.5%).




Figura 9. Nivelet e percepsioneve për kompetencat digjitale para dhe pas testit

Dallime statistikisht të rëndësishme (signifikante) nuk ka, meqenëse kemi vlerat e  $p=.12$  ( $p>.05$ ),  $t=1.55$  dhe  $d=420$  sipas Paired samples t-test me paratest ( $M=2.78$  dhe  $D.St=1.60$ ) dhe pastest ( $M=2.66$ ,  $D.St=1.48$ ).

### 3.2. Qëndrimet e mësimitdhënësve për përdorimin e teknologjive digjitale në praktikatat e tyre të mësimitdhënies


Përveç pasqyrës për nivelin e kompetencave digjitale, instrumenti [SELFIEforTEACHERS](#) përmban edhe disa kërkesa shtesë për plotësim nga mësimitdhënësit që i nënshtrohen vetëvlerësimit. Këto kryesisht ndërliiden me përdorimin e mjeteve dhe përmbajtjeve digjitale në profesion, por edhe me kushtet dhe mundësitë për zbatim.

#### *Qëndrimet e mësimitdhënësve të nivelit 1-9 për përdorimin e mjeteve dhe përmbajtjeve digjitale në praktikatat e tyre të mësimitdhënies*

Për marrjen e qëndrimeve të mësimitdhënësve lidhur me këto aspekte, në instrument janë bashkëngjitur edhe 10 pyetje të tjera (4+6), me mundësi të përgjigjeve të ndërtuara sipas Shkallës Likert (Renis Likert 1932), me pesë

shkallë të vlerësimit (5= Plotësisht pajtohem deri te 1= Aspak nuk pajtohem).

Në pyetjen *Që sa vjet e përdorni teknologjinë digjitale në jetën e përditshme dhe në profesion?* rezulton të kemi përqindje më të larta te përdorimi mbi 10 vjet (53%).



*Figura 10. Përdorimi i teknologjive digjitale nga mësimdhënësit e vetëvlerësuar*

Mësimdhënësit kryesisht përdorin teknologji digjitale, si apps, kompjuter, tablet, telefon të mençur, programe, pajisje, burime digjitale etj. (Plotësisht pajtohem=63%). Përdorimin e ndërlihdhin kryesisht me lehtësimin e punës, duke përdorur këto teknologji (Plotësisht pajtohem = 69.5%). Arsye të tjera janë edhe puna online dhe angazhimi në rrjete të ndryshme online (Plotësisht pajtohem = 36.4%).

*Tabela 19. Opinonet e mësimdhënëse për përdorimin e teknologjive dhe burimeve digjitale*

Nga 5 - Plotësisht pajtohem, te 1 - Aspak nuk pajtohem	5	4	3	2	1
Më vjen më lehtë puna me përdorim të teknologjive dhe pajisjeve digjitale (kompjuter, tablet, telefon të mençur etj.);	69.5	17.8	8.4	0.8	3.5
Jam anëtar i rrjeteve të ndryshme online (rrjete shoqërore, komunitete profesionale të të mësuarit etj.);	36.4	23.2	17.0	7.5	6.2
Unë përdor teknologji të reja digjitale (e.g. apps, programe, pajisje, burime).	63.0	6.9	17.6	6.6	5.9

Qëndrimet e mësimdhënësve për kushtet, të cilat ofrohen për zbatimin e mjeteve dhe përmbajtjeve digjitale në procesin mësimor, janë jo aq pozitive. Me përqindje më të larta ata aspak nuk pajtohen se në klasa ka pajisje digjitale: projektor, kompjuter, tabela interaktive, internet, qasje në pajisje etj.

Sipas tyre, ata plotësisht pajtohen se këtë qasje nxënësit e kanë në shtëpitë e tyre. Se shkolla organizon aktivitete për zhvillimin profesional të mësimdhënësve, për kompetencën digjitale, gjithashtu, mësimdhënësit pajtohen plotësisht.

*Tabela 20. Opinionet e mësimdhënësve për kushtet ekzistuese për zbatimin e mjeteve dhe përmbajtjeve digjitale*

Nga 5 - Plotësisht pajtohem, te 1- Aspak nuk pajtohem	5	4	3	2	1
Ka pajisje digjitale të qasshme në klasën time (projektor, kompjuter, tabela interaktive etj.);	25.3	14.6	19.9	12.1	28.1
Ka lidhje të qëndrueshme me internet;	21.5	18.8	22.2	14.6	22.9
Nxënësit kanë qasje në pajisjet digjitale në klasë (laptop, tableta, telefona të mençur);	21.7	14.6	20.8	12.2	30.7
Nxënësit kanë qasje në pajisjet digjitale dhe me qasje në internet në shtëpi;	39.0	22.8	18.7	8.1	11.4
Udhëheqja e shkollës mbështet integrimin e teknologjisë digjitale në mësimdhënie dhe në të nxënësit;	51.5	17.8	17	7.3	6.5
Shkolla ime organizon aktivitete për zhvillimin profesional të mësimdhënësve për kompetencën digjitale (punëtori, trajnime, seanca mësimore etj.)	36.2	23.1	17.4	12.5	10.8

### ***Përdorimi i mjeteve dhe përmbajtjeve teknologjike ndihmëse nga mësimdhënësit e Qendrave Burimore***

Qendrat Burimore në Kosovë funksionojnë sipas Ligjit për Arsimin Parauniversitar dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2018. Janë transformuar nga shkollat speciale dhe janë institucione arsimore që përmbajnë dy njësi: Njësia e shkollës që organizon mësimdhënien për fëmijë

me nevoja të veçanta arsimore, dedikuar për llojet e ndryshme të dëmtimeve të rënda dhe të shumëfishta; dhe Njësia e shërbimeve të mbështetjes, e cila mbështet shkollat e rregullta që përfshijnë fëmijë me nevoja të veçanta arsimore. Në Kosovë janë 5 Qendra Burimore: 3 Qendra Burimore për mësim dhe këshillim për fëmijë me dëmtime intelektuale, 1 për mësim dhe këshillim për fëmijë me dëmtime në të dëgjuar dhe 1 për mësim dhe këshillim për fëmijë me dëmtime në të parë.

Për dallim nga mësimdhënësit e shkollave të tjera, instrumentit [SELFIEforTEACHERS](#) për mësimdhënës të Qendrave Burimore i është bashkëngjitur edhe një pyetësor me pyetje të hapura, për të marrë informata rreth përdorimit të mjeteve dhe përmbajtjeve të teknologjisë ndihmëse në mbështetje të nxënësve me të cilët punojnë.

Instrumenti përmbante 4 pyetje, të cilave u janë përgjigjur mësimdhënësit:

Në pyetjen *A keni ndjekur ndonjë program specifik të trajnimit për përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie?*, nga gjithsej 70 mësimdhënës, të cilët e kanë plotësuar pyetësorin, 35.7% nuk kanë marrë pjesë në asnjë lloj trajnimi për zhvillim profesional të kompetencës digjitale. Të tjerët, 30%, kanë marrë pjesë në programe trajnimi, por nuk janë përgjigjur se në çfarë programesh, ndërsa 34.3% kanë marrë pjesë kryesisht ECDL (24.2%), apo edhe Aplikimi i TIK-ut në mësimdhënie, mësimi online, mësimi në distancë etj. Programe specifike të trajnimit për mbështetje të nxënësve, sipas nevojave të veçanta të nxënësve, kanë ndjekur vetëm mësimdhënësit e Qendrës Burimore, të cilët punojnë me nxënës me dëmtime në të parë, si: Teknologjia informative për të verbër, IT Braille, Software as Braille, JAWS, Bazik ICT and e Learning etj (37.4%).

Se *a i mbështetin nxënësit e tyre me mjete teknologjike ndihmëse (asistive) gjatë procesit mësimor*, 68.5 % e mësimdhënësve kanë deklaruar se përdorin mjete teknologjike, si: laptop, kompjuter, telefon të mençur, IPAD, projektor, tabelë të mençur. Vetëm 0.95% e të anketuarve kanë deklaruar se mbështetin nxënësit në përdorimin e *Lexues teksti (screen reader) monitora zmadhues, braildisplay, elektro-organizator*.

Në pyetjen *A përdorni përmbajtje specifike për mbështetje sipas nevojave të nxënësve tuaj?*, 65.7% kanë deklaruar se përdorin burime të ndryshme. Mësimdhënësit e Qendrave Burimore, të cilët punojnë me fëmijë me dëmtime intelektuale, janë përgjigjur se përdorin Youtube, pinterest, platforma të lojërave, muzikës, përrallave, filmave vizatimor, platformën e MASHTI-t për Arsim gjithëpërfshirës. Mësimdhënësit e Qendrës Burimore për fëmijë me dëmtime në të dëgjuar kanë deklaruar se përdorin platformën E-mësimi, kurse mësimdhënësit e Qendrës Burimore për fëmijë me dëmtime në të parë përdorin IMPRO, shkollat.org, youtube, audiolinqe etj.

Shumica nga mësimdhënësit (rreth 67.1%) kanë deklaruar se *kanë nevojë për programe trajnimi* që do t'ua lehtësonin mësimdhënien, sipas nevojave specifike të nxënësve.

### **3.3. Përfshirja e kompetencës digjitale në programet e ZHPM-së, të akredituara në MASHTI në vitet e fundit**

Te pika 1.2.2. kemi potencuar se objekt i studimit, ndër të tjera, ishin edhe programet e akredituara në MASHTI, të prezantuara në katalogët e fundit dhe të publikuara nga MASHTI, me fokus programet nga fusha e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK). Planifikimi ishte që të analizohen katalogët e viteve 2021, 2022 dhe 2023. Në periudhën sa është realizuar hulumtimi dhe është raportuar për gjetjet, MASHTI nuk ka realizuar katalog për vitin 2023 dhe si i tillë edhe nuk ka mundur të përfshihet në studim. Me dy katalogët paraprakë është bërë shqyrtimi i aspekteve përkatëse, duke marrë për bazë kërkesat e dokumentit referues DigCompEdu.

Rezultatet e dala nga analiza e programeve të trajnimit, të prezantuara në dy katalogët, kanë treguar se ka programe të akredituara që mbulojnë fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), realizimi i të cilave, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, kanë ndikuar në zhvillimin e kompetencave digjitale të mësimdhënësve të arsimit parauniversitar në Kosovë.

## ***Programet e publikuara në Katalogun e vitit 2021 dhe Katalogun e vitit 2022***

Sipas analizës së programeve, në katalogët e viteve 2021 dhe 2022, MASHTI ka akredituar dhe aprovuar programe trajnimi bazuar në nevojat për zhvillim profesional për fushën *Teknologji Informative dhe Komunikim (TIK)* të mësimdhënësve të të gjitha niveleve të arsimit parauniversitar. MASHTI në vitin 2021 ka akredituar 23 programe trajnimi (tabela 20) dhe në vitin 2022 ka akredituar 13 programe (tabela 21), të ofruara nga organizatat e ndryshme, të cilat synojnë zhvillimin e kompetencave të mësimdhënësve për përdorimin e TIK-ut.

Programet e përfshira në Katalogun e vitit 2021:

*Tabela nr. 21 Lista e programeve të akredituara për zhvillimin e TIK-ut - 2021*

<b><i>Programe themelore</i></b>	<b><i>Programe plotësuese</i></b>
<i>1. Aplikimi i programeve online në sigurimin e cilësisë në mësimdhënie</i>	<i>14. Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie</i>
<i>2. Integrimi i TIK-ut në mësimdhënie</i>	<i>15. Të mësuarit e kombinuar (BLENDED LEARNING )</i>
<i>3. Bazat e bashkëpunimit online</i>	<i>16. Të mësuarit përmes teknologjisë-përdorimi i programeve aplikative</i>
<i>4. Bazat e kompjuterit</i>	<i>17. Instrumentet bashkëkohore të teknologjisë në edukim</i>
<i>5. Bazat e të dhënave</i>	<i>18. Të nxënit bashkëveprues përmes kompjuterit</i>
<i>6. Kalkulimi i tabelave</i>	<i>19. Mësimi online</i>
<i>7. Komunikimi elektronik</i>	<i>20. Bazat e sigurisë në teknologjinë informative</i>
<i>8. Përpunimi i teksteve</i>	<i>21. Bazat e sigurisë së të dhënave</i>
<i>9. Prezantimet</i>	<i>22. Mësimi i shkrimit braj</i>
<i>10. Siguria në TI</i>	<i>23. Përdorimi dhe përshatja e teknologjisë informative për të verbër</i>
<i>11. Mësimdhënia në distancë</i>	
<i>12. Mësimdhënia me teknologji informative</i>	
<i>13. Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie</i>	

Bartës të këtyre programeve, sipas katalogut, janë institucione vendore e ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë, si: Eko-Protecion (1 program), Universiteti i Prishtinës/Fakulteti i Edukimit (1 program), ECDLKosova (8 programe), Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH(GIZ) (1 program), Si të bëhem i suksesshëm (1 program), Qendra për hulumtime dhe trajnime „KONICA” (1 program), QAPA - Qendra për Avancimin e Performancës së Arsimit (2 programe), Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) (1 program), Qendra Burimore për mësim dhe këshillim „Xheladin Deda” (2 programe) dhe Kolegji Ndërkombëtar për Biznes dhe Teknologji - UBT (5 programe), të cilat synojnë mbështetjen e mësimdhënësve për zhvillimin e kompetencave në fushën e TIK.

Në katalog, 13 nga programet janë të përcaktuara si programe trajnuese **themelore**<sup>1</sup> dhe 8 programe **plotësuese**<sup>2</sup>. Janë edhe 2 programe (me numër rendor 22 dhe 23 në tabelë), të cilat nuk janë të përcaktuara si themelore apo plotësuese, por që ofrojnë mbështetje për mësimdhënësit, të cilët punojnë me persona të verbër.

Ka edhe programe të tjera, të cilat në mënyrë indirekte, gjatë trajnimit, përmes praktikimit të teknologjisë apo moduleve të veçanta, ofrojnë edhe informata për ndonjë platformë apo program të TIK, varësisht nga qëllimi dhe qasja metodologjike e programit, si p.sh. *Programi për projekte* (Katalogu 2021, f. 83), *Plani individual i arsimit* (f. 227). Përfitues nga këto

---

<sup>1</sup> Programet themelore të ZhPM-së sipas Kornizës Strategjike për zhvillimin e mësimdhënësve në Kosovë janë programe me fokus në çështjet lidhur me kurrikulat e bazuara në kompetenca, zotërimin e lëndës, aspektet e përqendrimit në metodologji mësimore dhe planifikim mësimor, shkathtësi themelore të menaxhimit të klasës, vlerësimin e bazuar në kompetenca, teknologjive të reja në proceset mësimore, përdorimin e materialeve mësimore, motivimin e nxënësve etj. Këto programe përfshijnë 70% e domosdoshëm të kërkesave për orë trajnime në sistemin e licencimit (MASHTI, Korniza strategjike, 2017. f. 34).

<sup>2</sup> Programet plotësuese sipas Kornizës Strategjike për zhvillimin e mësimdhënësve në Kosovë janë programe të miratuara që nuk ndërlidhen drejtpërdrejt me metodologjitë e mësimdhënies, por janë në interes të sigurimit të cilësisë në shkollë, zhvillimit dhe avancimin e punës në shkollë, e që mbulojnë maksimumin deri në 30% të kërkesave për orë trajnime në sistemin e licencimit (po aty, f. 34).

programe sipas hartuesve mund të jenë mësimdhënës të tri niveleve të arsimit parauniversitar, por edhe drejtorët dhe punonjësit e tjerë të shkollës. Nuk ka të dhëna nëse ndonjë program u referohet mësimdhënësve të ndonjë fushe apo lënde të caktuar. Shumica e programeve kanë për qëllim mbështetjen e mësimdhënësve për zhvillimin dhe avancimin e tyre profesional në përdorimin e teknologjisë digjitale në mësimdhënie - pavarësisht fushës apo nivelit arsimor në të cilin punojnë.

### ***Programet themelore:***

- *Bazat e kompjuterit* ofron njohuri elementare për teknologji, duke filluar nga definimi i termit TIK dhe identifikimi i llojeve të ndryshme të shërbimeve, pjesët e kompjuterit, dhe licencimi i sistemit operativ, përdorimi i Windows-it, desktopi dhe ikonat, që është mundësi për të vazhduar tutje me përdorimin dhe mundësitë e funksionimit të saj.
- *Mësimdhënia me teknologji informative* synon që pjesëmarrësit të njohin pjesët, pajisjet kompjuterike, dhe të dinë t'i përdorin ato.
- *Kalkulimi i tabelave* ofron njohuri për shfrytëzimin e mundësive që ofron platforma për manipulim me tabela dhe formula, duke përdorur funksione të integruara për ta rritur produktivitetin.
- *Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie* pretendon që mësimdhënësit në fund të programit të jenë në gjendje të njohin bazat themelore të teknologjisë së informacionit, sistemet operative, dhe të fitojnë shkathtësi për zbatimin dhe përdorimin e MS Outlook 2013, MS Word 2013, Excel 2013, PowerPoint 2013, MS Access 2013 dhe përdorim të internetit.
- *Bazat e të dhënave*, e po ashtu edhe programi *Përpunimi i teksteve*, mundësojnë të krijojnë dhe modifikojnë tekste dhe dokumente të vogla, që do të jenë të gatshme të distribuohen dhe të ndahen.

- *Prezantimet*, i aftëson kandidatët për përgatitjen dhe prezantimin e materialeve - mundësi të cilat ua ofron shfrytëzimi i teknologjisë digjitale.
- *Siguria në TI* mundëson të kuptojnë konceptet kyçe që lidhen me rëndësinë e informacionit të sigurisë së të dhënave: sigurinë fizike, intimitetit dhe vjedhjet e identitetit, duke mundësuar mbrojtjen e kompjuterit, pajisjet ose rrjetet nga malwer-et dhe qasjet e paautorizuara.
- *Aplikimi i programeve online në sigurimin e cilësisë në mësimdhënie* ofron informata themelore për programet online dhe qasje në platformat e Google.
- *Bazat e bashkëpunimit online* për zhvillimin e strategjive të bashkëpunimit dhe bashkëveprimit, duke përdorur rrjetet sociale blogs dhe wikis dhe mjetet për bashkëpunim online.
- *Komunikimi elektronik* synon që t'i mbështesë mësimdhënësit të kuptojnë, të përdorin dhe të kërkojnë shfletimin e Web Browser - të menaxhojnë me e-mail etj.
- *Mësimdhënia në distancë* synon të pajisë pjesëmarrësit me shkathësitë e duhura didaktike dhe teknike për mësimdhënie kualitative etj.
- *Integrimi i TIK-ut në mësimdhënie* që synon zhvillimin e kompetencave të mësimdhënësve në shërbim për përdorimin e teknologjive dhe metodologjive për integrimin e TIK-ut në mësimdhënie, me fokus rritjen e interaktivitetit mësimdhënës-nxënës dhe përdorimit të burimeve online.

***Programet plotësuese:***

- *Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie* synon që mësimdhënësit t'i përgatisë për përdorimin e pajisjeve teknologjike (mjeteve digjitale) si: kompjuterët, projektorët, tabelat digjitale, programet kompjuterike, internet, tabletët etj., si dhe paketën e Microsoft Office (Word - Excel - Power Point-Windows Media Player).

- *Instrumentet bashkëkohore të teknologjisë në edukim* ofron përmbajtje për qasje dhe shfletim në mjedise digjitale, punë me platformat Cloud (platforma, softueri dhe interneti - si shërbime).
- *Të mësuarit e kombinuar (BLENDED LEARNING)* - është planifikuar që përfitues të këtij programi të jenë mësime të mësimdhënësive të avancuar. Programi ka për qëllim aplikimin e metodologjive të kombinuara të mësimeve (online dhe ato fizike), duke shfrytëzuar edhe platformat online për të siguruar cilësinë e procesit të mësimit.
- *Mësimi online* mbështet mësime të njohin krijimin e përmbajtjes dhe mënyrën për prezantime, njohjen dhe kuptimin e platformave softuerike që ekzistojnë, publikimin e materialeve, identifikimin e metodave më të mira për vlerësim, kontrollimin e qasjes së nxënësve me nevoja të veçanta për nxënës që mëson online etj.
- *Të mësuarit përmes teknologjisë - përdorimi i programeve aplikative* synon që të përgatitë mësime të praktikojnë mësime përmes përdorimit të teknologjisë, të krijojnë projekte përmes programeve aplikative etj.
- *Të nxënit bashkëveprues përmes kompjuterit* ofron mundësi për sistemin e menaxhimit të mësimit bashkëveprues përmes rrjetit të kompjuterëve – bashkëpunimit dhe komunikimit në mësim dhe vetërregullimit - përdorimit të TIK-ut për të mësuar etj.
- *Bazat e sigurisë në teknologjinë informative* është program që mbështet mësime në implementimin e sigurisë së të dhënave për mbrojtjen dhe sigurinë e informacionit, të përcaktojnë nivelet e mbrojtjes dhe të reagojnë ndaj incidenteve të sigurisë, hartojnë sistem të qëndrueshëm dhe identifikojnë ndërhyrjet.
- *Bazat e sigurisë së të dhënave* u mundëson pjesëmarrësve të kuptojnë kërcënimet e mundshme të sistemeve të informacionit, krijojnë përvoja në lidhje me analizimin, implementimin dhe konfigurimin e sigurisë në sistemet kompjuterike.

2 programe të akredituara për mësimdhënës, të cilët punojnë me nxënës me dëmtime në të parë, e që janë programe të rëndësishme për mësimdhënësit që punojnë me këtë kategori të nxënësve, si: *Mësimi i shkrimit brajl*, i cili mbështet mësimdhënësit të njohin, të shkruajnë, të lexojnë, t'ua mësojnë fëmijëve shkrimin brajl dhe të njohin e të shfrytëzojnë teknologjinë që përdoret për shkrim-lexim dhe komunikim me të verbër. Ngjashëm edhe programi *Përdorimi dhe përshtatja e teknologjisë informative për të verbër* synon përgatitjen e mësimdhënësve për njohjen dhe shfrytëzimin e teknologjinë që përdoret në shkrim-lexim dhe komunikim për të verbër dhe shkrimin brajl.

Në katalog nuk janë gjetur programe specifike për llojet e tjera të dëmtimeve, por disa programe promovojnë parimin e gjithëpërfshirjes në kuadër të objektivave të tyre, si p.sh. *Integrimi i TIK-ut në mësimdhënie* (përdorin Kahoot për gjithëpërfshirje dhe angazhim të nxënësve për të nxënë, Katalogu 2021, f. 59), apo programi *Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie*, i cili në përmbajtje, ndër të tjera, potencon se mësimdhënësi zhvillon aktivitete të mësimdhënies që përfshijnë strategji të diferencuara për t'i angazhuar të gjithë nxënësit, si dhe për t'i përmbushur nevojat e veçanta të nxënësve me aftësi të ndryshme (po aty, f. 41). Nuk është gjetur ndonjë modul me përmbajtje më specifike brenda programit për lloje të caktuara të dëmtimeve.

### ***Programet e përfshira në Katalogun e vitit 2022***

Në katalogun e vitit 2022 janë 13 programe të akredituara dhe të aprovuara nga MASHTI, të cilat synojnë zhvillimin e kompetencës digjitale te mësimdhënësit, për përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie. 7 programe ndërlidhen drejtpërdrejt me TIK-un dhe objektivat e tyre kanë zhvillimin e kompetencës digjitale, ndërsa 6 të tjera ndihmojnë zhvillimin e kompetencës digjitale të mësimdhënësve përmes përdorimit të platformave apo formave të tjera, por nuk e mbulojnë tërësisht fushën e TIK-ut. Disa programe janë me akreditim njëvjeçar në katalogun 2021 dhe të riakredituara në 2022. si: Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie; Të mësuarit e kombinuar

(Blended Learning) dhe Të mësuarit përmes teknologjisë – përdorimi i programeve aplikative.

*Tabela nr. 22. Lista e programeve të akredituara për zhvillimin e TIK-ut - 2022*

<b>Programe themelore</b>	<b>Programe plotësuese</b>
1. Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie	5. Klubi i teknikëve
2. Aktivitetet e parapara në shkollë në përmbushjen e objektivave të ndërlidhura me orientimin në karrierë	6. Mësimdhënia online në nivelin e duhur
3. Këshillimi dhe orientimi në karrierë	7. Të mësuarit e kombinuar (BLENDED LEARNING)
4. Zhvillimi i shkathësive të shekullit 21 në lëndën e Matematikës	8. Të mësuarit përmes teknologjisë – përdorimi i programeve aplikative
<b>Programe themelore dhe plotësuese</b>	
9. Busulla. Com – 5 hapat e orientimit në karrierë	
10. Roli i Busulla.COM në përmbushjen e objektivave për orientimin në karrierë të parapara në Kornizën Kurrikulare dhe Kurrikulat Bërthamë	
11. Identifikimi i nevojave për trajnime dhe azhurnimi i standardeve të profesionit përmes TNA/SKNA.	
12. Krijimi dhe menaxhimi i bankës së pyetjeve	
13. Krijimi dhe publikimi i testeve	

Bartës të programeve janë organizata të ndryshme, vendore dhe ndërkombëtare, si: Smart Bits, LuxDev Project KSV/020 (6 programe); Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) (3 programe); QAPA-Qendra për Avancimin e Performancës së Arsimit (2 programe); Qendra për Edukim, Hulumtime dhe Trajnime - ‘KONICA‘ (1 program), Qendra Kosovare për Arsim në Distançë (KCDE) - Mëso online (1 program). Të gjitha këto programe, themelore apo plotësuese, synojnë të mbështesin mësimdhënësit për të zhvilluar kompetencën digjitale.

Nga programet e përfshira në këtë katalog, 4 janë të përcaktuara si programe trajnuese themelore, 5 janë programe themelore dhe plotësuese dhe 4 janë programe plotësuese.

### ***Programet themelore:***

- *Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie, i riakredituar, dhe programi Aktivitetet e parapara në shkollë në përmbushjen e objektivave të ndërlidhura me orientimin në karrierë nuk ndërlidhen drejtpërdrejt me TIK-un, por ndihmojnë mësimdhënësit të njohin rolin dhe rëndësinë e platformës online për këshillim dhe edukim në karrierë - Busulla.Com, si ta përdorin atë gjatë inicimit të projekteve dhe hartimit të planeve.*
- *Këshillimi dhe orientimi në karrierë ndihmon mësimdhënësit të njohin, të kuptojnë dhe të përdorin platformën elektronike Busulla.Com për të demonstruar kërkimin për shkolla dhe IAL, për të diskutuar për profesione dhe për të bërë teste të ndryshme, si Testi i karrierës, Basic Check etj.*
- *Zhvillimi i shkathësive të shekullit 21 në lëndën e Matematikës, edhe pse objektivat dhe rezultatet e të nxëniet nuk ndërlidhen drejtpërdrejt me përdorim të TIK-ut, u mundëson mësimdhënësve të mësojnë disa lojëra që mund të ndërlidhen me njësitë përkatëse nga matematika: Njihen me punën e programeve kompjuterike (Geogebra, Excel, Logo) dhe me disa burime të rëndësishme në internet.*

### ***Programet themelore dhe plotësuese:***

- *Busulla.Com – 5 hapat e orientimit në karrierë u mundëson përfituesve të kuptojnë dhe të përdorin platformën për Orientim në Karrierë, Busulla.com, dhe të ndërlidhin me procesin mësimor për realizimin e objektivave që dalin nga Korniza Kurrikulare dhe Kurrikula Bërthamë.*
- *Roli i Busulla.Com në përmbushjen e objektivave për orientimin në karrierë, të parapara në Kornizën Kurrikulare dhe Kurrikulat Bërthamë, i ndihmon mësimdhënësit në njohjen, përdorimin dhe rolin e Busulla.Com në përmbushjen e objektivave të fushës Jeta dhe puna.*
- *Identifikimi i nevojave për trajnime dhe azhurnimi i standardeve të profesionit përmes TNA/SKNA tërthorazi ndihmon mësimdhënësit të*

njohin dhe të përdorin modulet elektronike dhe të hartojnë pyetësor dhe materiale të tjera elektronike.

- *Krijimi dhe menaxhimi i bankës së pyetjeve* ka për qëllim të ndihmojë mësimdhënësit që gjatë menaxhimit të bankës së pyetjeve të njohin dhe të kuptojnë platformat online dhe të regjistrojnë me sukses llogarinë në platformë.
- *Krijimi dhe publikimi i testeve* u ndihmon mësimdhënësve të njohin dhe të kuptojnë sistemin automatik për publikim dhe krijim të testeve, regjistrimin dhe inkuadrimin në platformë, shtjellimin e funksionaliteteve të platformës, publikimin, ndryshimin dhe fshirjen e testeve të formateve të ndryshme.

### ***Programet plotësuese:***

- *Klubi i teknikëve* ka për qëllim t'u ndihmojë mësimdhënësve të shfrytëzojnë teknologjinë, të njohin dhe të përdorin laboratorin e teknologjisë informative, si dhe të bëjnë menaxhimin dhe të krijojnë njësi- aktivitete të ndryshme nëpërmjet teknologjisë.
- *Mësimdhënia online në nivelin e duhur* u mundëson mësimdhënësve të përmirësojnë aftësitë e tyre digjitale për mësimdhënie online në një mjedis bashkëpunues. Mësimdhënësit njihen me platforma të ndryshme për mësim online, si t'i përdorin sisteme të menaxhimit të mësimin, platformat për komunikim, krijimin e materialeve mësimore dhe angazhimin e pjesëmarrësve. Njëkohësisht i përgatit të krijojnë materiale audio-vizuale, si dhe forma të vlerësimit online (duke përdorur H5P, PreziVideo, Kahoot, Socrative, Mentimeter etj).
- *Të mësuarit e kombinuar (BLENDED LEARNING)*, (program i riakredituar), është program i planifikuar për mësimdhënësit e karrierës dhe mësimdhënësit e avancuar, i cili ka për qëllim aplikimin e metodologjive të kombinuara - online dhe fizike. Programi ua bën më të lehtë mësimdhënësve përdorimin e platformave të ndryshme online dhe të kombinojnë mësimdhënien online me atë fizike (face to face), të aplikojnë metodologji të

ndryshme të mësimdhënies përmes platformave online, të shkojnë drejt digjitalizimit të shkollave (procesit mësimor) dhe të arrijnë objektivat mësimore përmes platformave online.

- *Të mësuarit përmes teknologjisë - përdorimi i programeve aplikative*, (program i riakredituar), i përgatit mësimdhënësit të praktikojnë mësimdhënien përmes përdorimit të teknologjisë, të familjarizohen me metodologjinë dhe zbatimin e TIK-ut në mësimdhënie, të krijojnë teste dhe mësim në formë elektronike, dhe t'i zotërojnë shkathtësitë e komunikimit online.

Disa programe ndërlihen me fushën e TIK-ut në mënyrë indirekte, si: *Zhvillimi i shkathtësive të shekullit 21 në Lëndën e Matematikës; Hartimi dhe Menaxhimi i projekteve në fushën e Arsimit; Sistemi i monitorimit dhe evaluimit - Sigurimi i cilësisë në shkolla; Krijimi dhe publikimi i testeve*, të cilat i prekin platformat online dhe ndihmojnë në zhvillimin e njohurive për TIK. Nëpërmjet praktikimit të teknologjisë apo moduleve të veçanta, ofrojnë informata për ndonjë platformë apo program të TIK-ut, varësisht nga qëllimi dhe qasja metodologjike e programit.

### ***Ndërlidhja e rezultateve/objektivave të programeve me nivelet e CEFR (A1-C2)***

Për identifikimin e ndërlidhjes së programeve të akredituara dhe të prezantuara në Katalogun e vitit 2021 dhe Katalogun e vitit 2022 me kompetencat digjitale të kornizës DigCompEdu, gjegjësisht me nivelet e CEFR (A1-C2) të prezantuara më lart, janë analizuar rezultatet e pritura/objektivat e secilit program veç e veç, gjuha dhe foljet e përdorura në përshkrimin e secilit rezultat apo objektivë të programit. Shembull, rezultatet e pritura të njërës nga programet potencojnë që, pas përfundimit të programit të trajnimit, mësimdhënësit pritet: **të njohin** ndikimin që ka TIK-u, **të përdorin** TIK-un si mjet për motivimin e nxënësve për të arritur kompetencat e synuara, **të bëjnë dallimin** në mes të mësimdhënies interaktive dhe asaj jointeraktive, **të krijojnë dhe të shfrytëzojnë** i-materialet, **të kuptojnë shfletimin e web-it**, **të krijojnë materiale multimediale** për mësimdhënie interaktive, **të filtrojnë** një tabelë apo

formular, **të zgjedhin dhe formatizojnë** grafika, **të analizojnë rrugën kritike**, **të përdorin** Poll Everywhere për krijimin e prezantimeve interaktive në Power Point, **të përdorin** Kahoot për gjithëpërfshirje dhe angazhim të nxënësve për të nxënë, **të shfrytëzojnë** simulimet për konkretizim dhe demonstrim të përmbajtjeve mësimore, **të krijojnë dhe të shfrytëzojnë** klasa virtuale dhe **të krijojnë** instrumente për vlerësim online etj.

Gjuha e përdorur në rezultatet e pritura/objektivat e programeve nuk është e njëjtë me gjuhën e përdorur në instrumentin vlerësues SELFIEforTEACHERS, prandaj analiza e programeve është bërë në bazë të shprehjes, kuptimit dhe nivelimit të saj me gjuhën e instrumentit.

Shembull nga barasvlerësimi apo përfrimi i shprehjeve:

Shprehjet në katalog - CEFR/Taks Blomm;

Njohin - Kujto/fillestar-A1

Dallojnë, kuptojnë = Kupto/eksplorues-A2

Përdorin, shfrytëzojnë = Zbato/integrues-B1

Kërkojnë, analizojnë = Analizo ekspert-B2

Filtrojnë, zgjedhin, vlerësojnë = Vlerëso/Udhëheqës-C1

Krijojnë = Krijo/pionier-C2.

Përshkrimi i rezultateve të pritura/objektivave të programeve në Katalogun e vitit 2021 dhe Katalogun e vitit 2022, krahasuar me kërkesat e niveleve CEFR, rezulton se të gjitha programet synojnë arritjen e së paku një apo dy niveleve të para (A1 dhe A2). Mirëpo, 11+4 nga programet mbeten vetëm brenda këtyre dy niveleve (A1 dhe A2), nuk përcaktojnë objektiva më të larta. 12 + 9 programe vazhdojnë me ngritjen e nivelit të objektivave. Në nivelin B1 vazhdojnë kërkesat e 10+7 programeve, edhe në B2 kalojnë 6+5 programe, ndërsa ngritjen e rezultateve /objektivave në nivelet C1 synojnë 10+7 programe, përderisa nivelin më të lartë të arritjeve (C2) e synojnë 11+3 nga programet.

Rezultatet treguan se për programet e prezantuara në Katalogun e vitit 2021 dhe në Katalogun e 2022 kemi këtë ndërlidhje:

## Katalogu 2021

Vetëm nivelin e parë të CEFR = 0 prog.

Dy nivelet e para (A1, A2) të CEFR =11 prog.

Kanë përfshirë edhe nivelin B1 të CEFR = 10 prog.

Kanë përfshirë edhe nivelin B2 = 6 prog.

Kanë përfshirë edhe nivelin C1 = 10 prog..

Kanë përfshirë edhe nivelin C2 = 11 prog.

## Katalogu 2022

Vetëm nivelin e parë të CEFR = 0 prog.

Dy nivelet e para (A1, A2) të CEFR = 4 prog.

Kanë përfshirë edhe nivelin B1 të CEFR = 7 prog.

Kanë përfshirë edhe nivelin B2 = 5 prog.

Kanë përfshirë edhe nivelin C1 = 7 prog.

Kanë përfshirë edhe nivelin C2 = 3 prog.

Objektivat në disa programe nuk shkojnë sipas hierarkisë së CEFR, por kalojnë nga niveli i parë në të tretin, apo edhe fillojnë nga niveli i dytë, duke vazhduar me nivelin pasues, apo duke kapërcyer nivelet 2, 3, 6 etj. Ka edhe programe që fillojnë me kërkesa nga niveli i dytë apo i tretë dhe vazhdojnë me nivelet më të larta, apo duke filluar me objektiva nga nivelet më të larta (C2) dhe duke zbritur në nivelet A1 apo A2. Ndërsa nga niveli i katërt (B2) dhe pestë (C1) nuk fillon asnjë program.

### *Ndërlidhja e programeve me fushat e DigCompEdu*

Për identifikimin e ndërlidhjes së fushave të programeve të akredituara, të prezantuara në katalogët e viteve 2021-2022, me fushat e Kornizës DigCompEdu janë analizuar rezultatet e pritura/objektivat secilit program veç e veç, por edhe përmbajtjet dhe aspekte të tjera të programeve.

### *Fusha 1 – Angazhimi profesional*

Të gjitha programet e fushës së TIK-ut janë në funksion të zhvillimit dhe aftësimin të mësimitdhënësve për përdorimin e kompetencave digjitale në procesin e mësimitdhënies, duke filluar nga rezultatet e pritura/objektivat: njohin, kuptojnë, përdorin mjetet digjitale, qasjet në platforma të ndryshme dhe përmbajtje digjitale, mund të shfrytëzojnë operimet digjitale, t'i zbatojnë në metodologjitë e mësimitdhënies, të bashkëpunojnë me kolegë, nxënës dhe prindër, dhe mësim online. Andaj, mund të themi se i kontribuojnë zhvillimit të kompetencave për përdorim të teknologjisë digjitale, komunikimit

organizativ me kolegë, nxënës dhe prindër; bashkëpunimit profesional, reflektimit mbi praktikat personale dhe kolektive, dhe janë në harmoni me kompetencat e nevojshme për vetëvlerësim në *fushën e angazhimit profesional (fusha 1 në instrumentin DigCompEdu)*.

### *Fusha 2 – Burimet digjitale*

Gjetjet kanë treguar se programet e evidentuara të fushës së TIK-ut, me objektivat e tyre, synojnë t’i aftësojnë mësimdhënësit për pajisjet dhe përmbajtjet digjitale, si: mjetet e ndryshme teknologjike (kompjuter, laptop, tablet, telefon të mençur etj.), njohjen, informimin, hulumtimin e burimeve digjitale, duke shfrytëzuar Windows, qasjet në platformat ndryshme të Google dhe paketën e Microsoft Office, si avantazhe që inovacionet e fituara t’i jetësojnë në procesin e mësimdhënies. Shembull, disa nga programet ofrojnë mundësi që mësimdhënësit të njohin, të përzgjedhin, të shpërndajnë burimet digjitale (*Aplikimi i programeve online në sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie, Integrimi i TIK-ut në mësimdhënie etj.*), dhe t’i menaxhojnë, t’i mbrojnë dhe t’i përdorin me përgjegjësi dhe etikë (*Bazat e sigurisë në teknologjinë informative etj.*), katalogu i vitit 2021. Po ashtu, edhe disa nga programet që gjenden në katalogun e vitit 2022 u ofrojnë mundësi mësimdhënësve të njohin, të përzgjedhin, dhe të shpërndajnë burimet digjitale (*Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie, Klubi i teknikëve, Të mësuarit përmes teknologjisë – përdorimi i programeve aplikative etj.*), si dhe t’i menaxhojnë, t’i mbrojnë dhe t’i përdorin me përgjegjësi. Këto kompetenca, sipas Kornizës DigCompEdu, janë të rëndësishme për mësimdhënësit dhe ndërliken me fushën Burimet digjitale. Kompetenca këto që, sipas Kornizës DigCompEdu, janë të rëndësishme për mësimdhënësit dhe vlerësohen në *fushën 2: Burimet digjitale* në instrument.

### *Fusha 3 – Mësimdhënia dhe të nxënit*

Qëllimi kryesor i të gjitha programeve të trajnimit është përgatitja e mësimdhënësve për përdorimin e teknologjisë digjitale në procesin e mësimdhënies dhe të nxënit, por programet e renditura te fusha e tretë e potencojnë më fuqishëm këtë qëllim. Ato synojnë mbështetjen e

mësimdhënësve për avancimin e praktikave të mësimdhënies dhe nxënies, me fokus rritjen e interaktivitetit mësimdhënës-nxënës dhe përdorimit të burimeve online për motivimin e nxënësve për të arritur kompetencat e synuara (*Integrimi i TIK-ut në mësimdhënie, Bazat e bashkëpunimit online, Të mësuarit përmes teknologjisë - përdorimi i programeve aplikative, Mësimi online, Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie etj.*) dhe shfrytëzimin e mundësive teknologjike për prezantim apo modifikim të teksteve (*Prezantimet, Përpunimi i teksteve*) etj. Po ashtu, edhe përgatitja e mësimdhënësve për *shkrimin brajl* dhe *teknologjinë informative për të verbër* u mundëson të njohin, të shkruajnë dhe të shfrytëzojnë teknologjinë që përdoret në shkrim-lexim dhe komunikim me nxënësit që kanë këto nevoja specifike.

#### *Fusha 4 – Vlerësimi*

Fusha e Vlerësimit merret me përdorimin e teknologjive digjitale dhe strategjive për ngritjen e procesit të vlerësimit. Gjatë analizës së programeve, është vërejtur se disa programe, ndër të tjera, kishin këtë objektivë. *Mësimdhënia në distancë* synon, ndër të tjera, identifikimin e metodave më të mira për vlerësim, gjë e cila ceket edhe te programi *Të mësuarit përmes teknologjisë - përdorimi i programeve aplikative*: të krijojnë teste dhe përmbajtje në formë elektronike, dhe Integrimi i TIK-ut në mësimdhënie, që ndër objektivat tjera ka edhe synimin e aftësimin për krijimin e instrumenteve për vlerësim online. Po ashtu, edhe *Mësimdhënia me teknologji informative* në rezultatet e programit parasheh që mësimdhënësit në fund të programit të përpilojnë teste dhe detyra të tjera, si dhe teste e kuize online, në formë të lojërave mësimore. *Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie* synon që mësimdhënësi të mund të hartojë, të përzgjedhë dhe të shfrytëzojë strategji joformale, formale, diagnostike dhe përmbledhëse për vlerësimin e mësimin të nxënësve, për verifikimin e nivelit të arritjes së nxënësve sa u përket njohurive, sjelljeve dhe shkathtësive, si dhe planifikon plotësimin e zbrazëtirave të arriturat e nxënësve. Synime për vlerësim ka edhe programi *Mësimi online*. Njëjtë si në katalogun e vitit 2021, gjatë analizës së programeve në katalogun e vitit 2022, kemi vërejtur se disa programe e prekin edhe fushën e vlerësimit, si objektivë. Programi *Krijimi dhe publikimi i testeve*, ndër të tjera, synon

inkuadrimin në platformë dhe shtjellimin e funksionaliteteve të platformës, si: vlerësimin për krijimin, publikimin, ndryshimin dhe fshirjen e testeve.

*Mësimdhënia online në nivelin e duhur* është, po ashtu, një program që synon edhe identifikimin e metodave më të mira për vlerësim, ndërsa programi *Të mësuarit përmes teknologjisë - përdorimi i programeve aplikative* ka për qëllim edhe krijimin e testeve dhe përmbajtjeve në formë elektronike dhe aftësimin për krijimin e instrumenteve për vlerësim online. Programi *Këshillimi dhe orientimi në karrierë*, edhe pse nuk ndërlidhet drejtpërdrejt me TIK-un, ndër të tjera, ndihmon mësimdhënësit të njohin, të përdorin dhe të vlerësojnë platformën elektronike Busulla.com për të demonstruar kërkimin për shkolla, për të diskutuar për profesione dhe për të bërë teste, si p.sh. Basic Check.

Objektivat në këto programe janë në harmoni me kompetencat e nevojshme për vlerësim sipas fushës 4 në të cilën vlerësohen: strategjitë për vlerësim, dëshmitë për analizë dhe informatat kthyesë dhe planifikimi.

#### *Fusha 5 – Fuqizimi i nxënësve*

Kjo fushë ndërlidhet me përdorimin e teknologjisë digjitale për rritjen e gjithëpërfshirjes, personalizimit dhe angazhimit aktiv të nxënësve, duke iu përshtatur nivelit, interesave dhe nevojave individuale të tyre. E hasim në disa programe trajnimi, si: *Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie*, i cili në përmbajtje, ndër të tjera, potencon se mësimdhënësi zhvillon aktivitete të mësimdhënies që përfshijnë strategji të diferencuara, për t'i angazhuar të gjithë nxënësit dhe për t'i përmbushur nevojat e veçanta të nxënësve me aftësi të ndryshme. Po ashtu, edhe programi *Të mësuarit e kombinuar (BLENDED LEARNING)* synon që mësimdhënësit të aftësohen, ndër të tjera, për kombinim të mësimdhënies online me atë fizike (face to face), duke gjetur pikat e forta dhe pikat e dobëta të metodologjive të caktuara për ngritjen e digjitalizimit të shkollës dhe procesit mësimor. Programi *Instrumentet bashkëkohore të teknologjisë në edukim* potencon të mësuarit e personalizuar dhe të vetëdrejtuar, si dhe parimin e të mësuarit e arritshëm dhe gjithëpërfshirës.

Ndërlidhjen e hasim edhe te programi *Klubi i teknikëve*, ngase objektivat ndërlidhen me përkrahjen e mësimdhënësve dhe nxënësve në shfrytëzimin e pajisjeve të teknologjisë informative, të përdorin drejt pajisjet arsimore në

shkollë dhe të krijojnë aktivitete praktike. *Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie* është një tjetër program që ndërlidhet me fuqizimin e nxënësve, pasi u ndihmon mësimdhënësve të kuptojnë dhe të njohin rëndësinë e përdorimit të TIK-ut në mësimdhënie, të hulumtojnë dhe të gjejnë informatën e duhur në internet, të përvetësojnë njohuritë e nevojshme për programet kompjuterike si: Word, Excel, PowerPoint, Windows Media Player etj. Mësimdhënësit aftësohen që inovacionet e fituara t'i jetësojnë në procesin e mësimdhënies, me qëllim të të nxënësve të suksesshëm nga nxënësit.

Në asnjë program që ndërlidhet me këtë fushë nuk specifikohet përdorimi i ndonjë teknologjie digjitale asistive (ndihmësve), përveç në dy programe të dedikuara për mësimdhënës që punojnë me nxënës me dëmtime në të parë - *Mësimi i shkrimit brajl dhe Përdorimi dhe përshtatja e teknologjisë informative për të verbër*, që synojnë përgatitjen e mësimdhënësve për mbështetjen e nxënësve, të cilët kanë nevojë të shfrytëzojnë teknologjinë që përdoret në shkrim-lexim dhe komunikim për të verbër.

#### *Fusha 6 – Lehtësimi i kompetencës digjitale të nxënësve*

Përveç përgatitjes së mësimdhënësve për përdorimin e teknologjisë digjitale në procesin e mësimdhënies, mësimdhënësit duhet të mbështesin nxënësit për përdorimin e teknologjisë digjitale në mënyrë kreative dhe me përgjegjësi, për qëllime të komunikimit, krijimit të përmbajtjeve, mirëqenie dhe zgjidhje të problemeve, kompetenca këto që në instrumentin e vetëvlerësimit i përkasin *fushës 6 - Lehtësimi i kompetencës digjitale të nxënësve*. Nga programet e analizuara, programi *Mësimdhënia në distancë* parashihet që mësimdhënësit të integrojnë në orët e tyre mësimore didaktikën digjitale, si formë e mësimdhënies, e cila në mënyrë indirekte nënkupton edhe mbështetjen për nxënësit. Edhe programi *Instrumentet bashkëkohore të teknologjisë në edukim*, që pretendon të mësuarit e arritshëm dhe gjithëpërfshirës, si edhe programet *Të mësuarit e kombinuar (BLENDED LEARNING)* dhe *Përdorimi dhe përshtatja e teknologjisë informative për të verbër*, ndër objektivat e tjera, synojnë ngritjen drejt digjitalizimit të shkollave dhe procesit mësimor, gjegjësisht shkrimin e brajl në shkollat dhe komunitet e tyre.

#### **IV. DISKUTIMI I REZULTATEVE**

Diskutimi i rezultateve është ndër pjesët më të rëndësishme të raportimit të gjetjeve të studimit, meqenëse mundëson përgjigjet nëse këto gjetje (rezultatet) kanë kuptim dhe ndërlidhje me pritjet e shprehura në hipotezat apo pyetjet e hulumtimit (McKenzie, 2010). Përderisa te rezultatet e studimit lexuesve u tregohet se *çfarë kemi gjetur*, në pjesën e diskutimit të rezultateve duhet interpretuar se *çfarë domethënie kanë ato gjetje* (Ammon, 2022).

Edhe në studimin tonë, në këtë pjesë, do të ofrohen shpjegimi dhe interpretimi i gjetjeve, sqarimi dhe konkludimet e mbështetura në rezultatet e hulumtimit, ndërlidhur me qëllimin dhe pyetjet kërkimore të studimit, si dhe me shqyrtimin e literaturës për kompetencat digjitale.

Qëllimi i studimit ishte të identifikojë dhe të pasqyrojë nivelin e kompetencës digjitale te mësimmshënësist, karshi kërkesave të kornizës DigCompEdu. Gjithashtu, qëllimi i studimit ishte edhe të pasqyrojë gjendjen, nevojat dhe mundësitë e zhvillimit të kësaj kompetence përmes programeve të trajnimit.

Në fund do të prezantohet një përfundim për çështjen e trajtuar, si dhe do të ofrohen rekomandime specifike dhe drejtimet e mundshme nga duhet të orientohet studimi i problematikës në fjalë në studimet e tjera, në të ardhmen.

##### **4.1. Kompetencat digjitale te mësimmshënësist e arsimit parauniversitar në Kosovë, karshi kërkesave të Kornizës DigCompEdu**

Në përgjigje të pyetjes kërkimore: *Cili është niveli i kompetencave digjitale te mësimmshënësist e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët (klasat 1-9) karshi Kornizës referuese DigCompEdu?*, rezultatet janë prezantuar te pika 3.1, të dala nga vetëvlerësimi i mësimmshënësive përmes instrumentit [SELFIEforTEACHERS](#) (Komisioni Evropian, 2023).

Siç është përmendur te pikat 1.1.4 dhe 1.1.5, vetëvlerësimi përmes këtij instrumenti iu nënshtrua niveleve të bazuara në Kornizën e përbashkët Evropiane për Gjuhët (Common European Framework of Reference for

Languages - CEFR), filluar nga niveli A1 deri tek ai C2. Logjika e përparimit është e inspiruar edhe nga Taksonomia e rishikuar e Bloom-it, me fazat e përparimit nga “Të kujtuarit” dhe “Të kuptuarit”, te “Të zbatuarit” dhe “Të analizuarit”, si dhe në fund te “Të vlerësuarit” dhe “Të krijuarit”.

Të dhënat e dala nga vetëvlerësimi i 445 mësimeve, duke përdorur këtë instrument, ofrojnë informata për dy aspekte: (i) perceptimet e mësimeve për nivelin e kompetencave të tyre digjitale të dala nga paratesti i realizuar para se ata t'i nënshtrohen vetëvlerësimit përmes SelfieforTeachers dhe nga pastesi i realizuar pas vetëvlerësimit; (ii) rezultatet e dala nga vetëvlerësimi për 6 fushat dhe 22 kompetencat përkatëse, përmes SelfieforTeachers.

*Rezultatet e dala para dhe pas testit* kanë treguar se perceptimet e mësimeve për kompetencat e tyre digjitale, me shkallë vlerësimi 1 (A1/fillestar) deri 6 (C2/pionier), me përqindje dukshëm më të larta, i kemi te tri nivelet e para (A1, A2 dhe B1). Vërehen dallime të vogla vetëm sa i përket radhitjes së tri niveleve në raport me njëri-tjetrin, para dhe pas testit.

Megjithatë, krahasimet përmes Paired samples t-test na treguan se ndërmjet këtyre dy vetëvlerësimeve nuk ka dallime statistikisht të rëndësishme (signifikante). Kjo nënkupton se, edhe pse mësimeve kanë pasur në dispozicion një material vetëvlerësues (mesatarisht dy javë në dispozicion për lexim dhe plotësim, rrjedhimisht dy javë distancë kohore para dhe pas testit), i cili material mund të shërbejë njëkohësisht edhe si burim informacioni se cilat janë kompetencat digjitale që një mësimeve duhet t'i ketë për të qenë i suksesshëm në profesionin e tij, perceptimet për nivelin e kompetencave të tyre digjitale nuk kanë ndryshuar.

*Rezultatet e dala nga vetëvlerësimi përmes instrumentit [SELFIEforTEACHERS](#)* kanë treguar se niveli i kompetencave digjitale të mësimeve për gjashtë fushat e kornizës, me shkallë vlerësimi 1(A1/fillestar) deri 6 (C2/pionier), i kemi me mesatare të përgjithshme  $M=2.64$  ( $D.St.=1.4$ ).

Shprehur në përqindjet e arritshmërisë për secilin nivel, mund konstatojmë që:

- 23.3% e mësimeve janë në nivelin **Fillestar (A1)** sipas CEFR, apo në nivelin e parë (Kujton) të Taksonomisë, meqenëse kanë arritur të grumbullojnë vetëm 32 nga 192 pikët maksimale, apo 17% nga 100%;
- 28.3% e mësimeve janë në nivelin **Eksplorues (A2)** sipas CEFR, apo në nivelin e dytë (Kupton) të Taksonomisë, meqenëse kanë arritur të grumbullojnë 33-64 nga 192 pikë, apo 18-33% nga 100%;
- 25.8% e mësimeve janë në nivelin **Integrues (B1)** sipas CEFR, apo në nivelin e tretë (Zbaton) të Taksonomisë, meqenëse kanë arritur të grumbullojnë 65-96 nga 192 pikë, apo 34-50% nga 100%;
- 13.4% e mësimeve janë në nivelin **Ekspert (B2)** sipas CEFR, apo në nivelin e katërt (Analizon) të Taksonomisë, meqenëse kanë arritur të grumbullojnë 97-128 nga 192 pikë, apo 51-67% nga 100%;
- 4.6% e mësimeve janë në nivelin **Udhëheqës (C1)** sipas CEFR, apo në nivelin e pestë (Vlerëson) të Taksonomisë, meqenëse kanë arritur të grumbullojnë 129-160 nga 192 pikë, apo 68-83% nga 100%;
- 2.1% e mësimeve janë në nivelin **Pionier (C2)** sipas CEFR, apo në nivelin e gjashtë (Krijon) të Taksonomisë, meqenëse kanë arritur të grumbullojnë 161-192 nga 192 pikë, apo 84-100% nga 100%;
- 2.5% e mësimeve janë deklaruar se **nuk kanë informacion**, nuk janë të vetëdijshëm për ekzistimin e kompetencave përkatëse.




Figura 11. Përdorimi i teknologjisë digjitale nga mësimeve të vetëvlerësuar


Bazuar në të dhënat, mund të japim përgjigje në pyetjen e parë të studimit dhe themi se kompetencat digjitale të mësimitdhënësve karshi kërkesave të Kornizës referuese DigCompEdu, në përqindje më të larta, u përkasin tri niveleve të para të CEFR (A1, A2 dhe B1) dhe njëkohësisht tri niveleve të para të Taksonomisë së Bloomit. Referuar përshkrimit për secilin nivel të vlerësimit, i bie që mësimitdhënësit e vetëvlerësuar e kanë të qartë se si teknologjitë digjitale mund të mbështesin dhe të avancojnë praktikatat profesionale (A1), kanë filluar të eksplorojnë për potencialin e teknologjive digjitale dhe kanë interesim për profesionale (A2), si dhe eksperimentojnë me teknologji digjitale në kontekste të ndryshme dhe për qëllime të ndryshme, duke i integruar ato në praktikë (B1).

Në anën tjetër, mësimitdhënësit e vetëvlerësuar nuk qëndrojnë mirë sa i përket përdorimit të teknologjive digjitale me konfidencë, kreativitet dhe në mënyrë kritike për të avancuar aktivitetet profesionale (B2), me qasje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse për përdorimin e teknologjive digjitale për të përmirësuar pedagogjinë dhe praktikatat profesionale (C1), si dhe për të reflektuar në mënyrë kritike për përshtatshmërinë e praktikave bashkëkohore digjitale dhe pedagogjike, në të cilat ata janë një udhëheqës (C2).

Referuar mesatareve të arritjeve për gjashtë fushat e Kornizës DigCompEdu, mësimitdhënësit e vetëvlerësuar qëndrojnë më mirë në përdorimin e teknologjive digjitale, si ndihmë në praktikën profesionale të mësimitdhënësve, për t'u qasur në informacion dhe për të përmirësuar praktikatat e tyre të mësimitdhënies dhe të nxënies (Fusha 1- Angazhimi profesional,  $M=2.76$ ); për të identifikuar në mënyrë efektive burimet që u përshtaten më mirë nevojave të tyre, stilit të mësimitdhënies dhe nxënësve të tyre (Fusha 2- Burimet digjitale,  $M=2.45$ ); për të krijuar përvoja inovative të të nxënies, duke rezultuar që nxënësit të angazhohen në mënyrë më aktive (Fusha 5- Fuqizimi i nxënësve,  $M=2.37$ ) dhe deri diku për të mbështetur dhe lehtësuar zhvillimin e kompetencës digjitale të nxënësve të tyre (Fusha 6 - Lehtësimi i kompetencës digjitale të nxënësve,  $M=2.34$ ).

Sa i përket përdorimit të teknologjive digjitale për të avancuar dhe përmirësuar praktikatat e mësimitdhënies dhe të nxënies (Fusha 3 -

Mësimdhënia dhe të nxënit, M=1.90) dhe për të përmirësuar praktikatat ekzistuese të vlerësimit dhe lehtësimin e praktikave të reja dhe novatore (Fusha 4 - Vlerësimi, M=1.95), mësimdhënësit nuk qëndrojnë edhe aq mirë.



*Figura 12. Përdorimit të teknologjive digjitale për të avancuar praktikatat e mësimdhënies*

Reflektuar rreth deklaratës së Këshillit të Unionit Evropian (EU, 2018) për kompetencat digjitale, si një nga tetë kompetencat kryesore për arsimin gjatë gjithë jetës (pika 1.1.1. në raport), është thënë se ajo përfshin aftësinë e individit për shfrytëzimin dhe ndërveprimin konfident, kritik dhe të përgjegjshëm me teknologji digjitale, për detyrat e punës dhe të pjesëmarrjes në shoqëri.

Aftësitë që përshkruhen në deklaratë përmbajnë këto elemente:

- të kuptuarit e informacionit dhe të dhënave;
- komunikimin dhe bashkëpunimin;
- të kuptuarit e medias;
- krijimin e përmbajtjes digjitale (përfshirë kodimin);
- sigurinë (përfshirë mirëqenien digjitale dhe sigurinë në internet);
- çështjet që kanë të bëjnë me pronën intelektuale;
- zgjidhjen e problemeve dhe të menduarit kritik e krijues etj.

Referuar gjetjeve, mund të themi se niveli i kompetencave digjitale të mësimitdhënësve, të vetëvlerësuar përmes instrumentit [SELFIEforTEACHERS](#), është nën mesataren e arritjeve për të gjitha aftësitë e përshkruara në deklaratën e EU-së për kompetencat digjitale (të gjitha fushat e DigCompEdu), madje qëndron jo mirë në raport me aftësitë që ndërlidhen me krijimin, zgjidhjen e problemeve, mendimin kritik e krijues etj. (tri fushat e fundit të DigCompEdu).

Ky nivel nuk i plotëson mjaftueshëm as aspektet pedagogjike që Krumsvik (2011) i sugjeron për konceptin e kompetencës digjitale, të cilat ndërlidhen me *grykimin e mirë pedagogjik-didaktik, me ndërgjegjësimin për implikimet e mundshme në strategjitë e të mësuarit dhe profesionalizimit digjital të nxënësve dhe studentëve* etj. Siç u shtjellua te pjesa e kontekstit teorik (pika 1.1.), supozohet se niveli i kompetencave digjitale të mësimitdhënësve ka ndikim të drejtpërdrejtë në qëndrueshmërinë profesionale dhe në arritjet e nxënësve. *Niveli i besimit të mësimitdhënësve për kompetencën e tyre digjitale ndikon në përdorimin e teknologjive nga ana e nxënësve gjatë mësimeve* (Wastiau et al., 2013). Fatkeqësisht, këto elemente mbesin jashtë kompetencave digjitale aktuale të mësimitdhënësve.

### ***Dallimet për kompetencën digjitale të mësimitdhënësve, sipas specifikave demografike, përfshirë edhe Qendrat Burimore***

Në përgjigje të pyetjes kërkimore Cilat janë dallimet për kompetencën digjitale të mësimitdhënësve sipas specifikave demografike, përfshirë edhe ata të qendrave burimore?, kemi realizuar analizat statistikore që mundësoi programi SPSS - Independent Samples Test për mostrën dygrupore dhe One-Way ANOVA për mostrën më shumë se dygrupore (pika 3.1.3. në raport).

Referuar gjetjeve, nuk mund të themi se ka dallime statistikisht të rëndësishme (signifikante) sa u përket specifikave demografike të mësimitdhënësve të vetëvlerësuar, si gjinia, niveli i shkollimit dhe fusha kurrikulare në të cilën mësimitdhënësit japin mësim, përfshirë edhe mësimitdhënësit nga Qendrat Burimore, vitet e përvojës së përdorimit të teknologjisë digjitale etj.

Nëse ndalemi në krahasime të mesatare të arritjeve karshi specifikave, vërehet se ka nuanca të dallimeve që e promovojnë vetëvlerësimin me instrumentin/pyetësorin në formën fizike/të printuar. Rezultate më të larta kemi te mësimdhënësit e gjinisë mashkullore, ndërsa referuar nivelit të arsimit në të cilin ata japin mësim, rezultate më të larta kanë treguar mësimdhënësit e nivelit të mesëm të ulët (6-9). Mesatare më të larta të arritjeve kemi te fusha Jeta dhe puna, vijuar nga fushat Shoqëria dhe mjedisi dhe Edukata fizike, sportet dhe shëndeti. Sa u përket viteve të përvojës së punës në mësimdhënie, mesatare më të larta kemi nga mësimdhënësit me përvojë pune 6 -10 vjet. Megjithatë, siç u përmend edhe më lart, përderisa nuk janë vërtetuar dallime statistikisht të rëndësishme për aspektet e analizuara, rezultatet e dala nga vetëvlerësimi i konsiderojmë të vlefshme për të gjitha kategoritë që i janë nënshtruar këtij vetëvlerësimi.

### ***Opinionet e mësimdhënësve për zbatimin e teknologjive digjitale në praktikën e tyre të mësimdhënies***

Në përgjigje të pyetjes kërkimore *Cilat janë opinionet e mësimdhënësve për zbatimin e teknologjive digjitale në praktikën e tyre të mësimdhënies?*, të dhënat i kemi marrë nga 10 kërkesa shtesë (4+6) të bashkëngjitura në instrumentin e vetëvlerësimit. Kërkesat kanë qenë me mundësi të përgjigjeve të ndërtuara sipas Shkallës Likert (Renis Likert 1932), me pesë shkallë të vlerësimit: (5= Plotësisht pajtohem deri te 1= Aspak nuk pajtohem). Janë ndërlidhur drejtpërdrejt me përdorimin e mjeteve dhe përmbajtjeve digjitale në profesion, por edhe me kushtet dhe mundësitë për zbatim. Referuar përqindjeve më të larta të të përgjigurve (të prezantuara te pika 3.2. në raport), themi se mësimdhënësit (53%) e përdorin teknologjinë digjitale në jetën e përditshme më gjatë se 10 vjet. Me këtë kuptojmë se përvojat e më shumë se gjysmës së mësimdhënësve të vetëvlerësuar për përdorim të teknologjive digjitale nuk mungojnë.

Madje, ata (63%) kanë deklaruar se përdorin teknologji digjitale nga më të ndryshmet dhe më bashkëkohoret, si: apps, kompjuter, tablet, telefon të mençur, programe, pajisje, burime digjitale, etj. Përdorimin e kësaj

teknologjie e kanë ndërlidhur me lehtësimin e punës, duke përdorur këto teknologji gjatë punës online dhe angazhimit në rrjete të ndryshme online.

Shkëputja, sipas mësimdhënësve, ndodh si pasojë e kushteve jo të favorshme që ofrohen për zbatimin e teknologjive digjitale në profesion, konkretisht në procesin mësimor. Ata kanë deklaruar se në klasat/dhomat mësimore nuk ka pajisje: projektor, kompjuter, tabela interaktive, internet, dhe as qasje në pajisje (28.1%). Sipas tyre (39%), e njëjta situatë nuk qëndron në shtëpitë apo familjet prej nga vijnë nxënësit, duke deklaruar se qasjen në teknologji, mjete dhe burime, nxënësit e kanë në shtëpitë e tyre.

Një përparësi shpresëdhënëse për përmirësimin e gjendjes lidhur me përdorimin e teknologjive digjitale në procesin mësimor mësimdhënësit (51.5%) e potencojnë mbështetjen e udhëheqjes së shkollave në avancimin e gjendjes, por edhe praktikatat e mira në shkollat e tyre (36.2%) në organizimin e aktiviteteve për zhvillimin profesional të mësimdhënësve për kompetencën digjitale (punëtori, trajnime, seanca mësimore etj.).

Mësimdhënësit nga Qendrat Burimore janë pyetur edhe për kompetencat digjitale specifike që ndërlidhen me punën e tyre me nxënës me nevoja të veçanta arsimore.

Sipas tyre, ata kanë ndjekur programe trajnimi për TIK - të njëjtat sikurse edhe mësimdhënësit e shkollave të rregullta, të cilat ishin në katalogët e programeve të edicioneve të fundit. Ata, po ashtu, përdorin mjete teknologjike të ngjashme sikurse edhe mësimdhënësit e tjerë, me përjashtim të një pjese të mësimdhënësve që punojnë me nxënës me dëmtime në të parë, të cilët përdorin mjete teknologjike ndihmëse. Ndërsa, sa i përket përdorimit të përmbajtjeve teknologjike, dallimi ekziston varësisht nga specifikat e Qendrave Burimore në të cilat punojnë. Sipas llojit të dëmtimeve të nxënësve, mësimdhënësit përzgjedhin platforma, uebfaqe, aplikacione më të përshtatshme. Mirëpo, edhe pse shumica nga mësimdhënësit (65.7%) deklarojnë se shfrytëzojnë burime digjitale për mësimdhënie, vetëm disa nga ta (0.95%) ishin në gjendje të deklarojnë mjetet ndihmëse, të cilat i përdorin për mbështetje të nxënësve të tyre. Po ashtu, këto gjetje përkojnë edhe me programet specifike për teknologji digjitale, ngase në katalogët e analizuar janë vetëm 2 programe trajnimi specifike për TIK nga Qendra Burimore për

fëmijë me dëmtime në të parë, qendrat dhe organizatat tjera nuk kanë të akredituar ndonjë program trajnimi i cili do t'i mbështeste mësimdhënësit për zhvillim profesional në fushën e teknologjisë digjitale për llojet tjera të dëmtimeve.

### ***Përfshirja e kompetencës digjitale në programet e ZhPM-së të akredituara në MASHTI***

Në përgjigje të pyetjes kërkimore *Cila është përfshirja e kompetencës digjitale në programet e ZhPM-së, të akredituara në MASHTI dhe të prezantuara në dy katalogët e fundit?*, janë analizuar dy katalogë e fundit të publikuar në faqen zyrtare të MASHTI-t.

Sipas gjetjeve, MASHTI i ka publikuar 23 programe në vitin 2021 dhe 13 në vitin 2022, programe për ZhPM për TIK, nga ofertues të përzgjedhur të programeve: universitete, kolegje, shkolla dhe organizata joqeveritare - vendore dhe ndërkombëtare, të cilat ofrojnë nga 1, 2 por edhe 5,6 apo 8 programe për TIK.

Në Katalogun e vitit 2021, nga këto programe, 13 janë cilësuar programe themelore, 8 programe plotësuese dhe 2 programe për shkrimin e Brajlit dhe teknologjinë digjitale për personat e verbër, të cilat nuk janë përcaktuar se janë programe themelore apo plotësuese, por janë të rëndësishme për mësimdhënësit, të cilët punojnë me nxënës me dëmtime të rënda në të parë. Në katalog nuk janë gjetur programe trajnimi për teknologji ndihmësve (asistive) për mësimdhënës që punojnë me nxënës me lloje të tjera të dëmtimeve.

Ndërsa, në Katalogun e vitit 2022 vetëm 4 programe janë cilësuar programe themelore, 4 programe plotësuese, ndërsa 5 programe janë përcaktuar si programe themelore dhe plotësuese. Mirëpo, në këtë katalog janë vetëm 8 programe që kanë qëllim të drejtpërdrejtë ZhPM për TIK, ndërsa programet e tjera, 5 nga to, përdorimin e mjeteve dhe burimeve digjitale e ofrojnë në mënyrë indirekte.

Krahasuar me vitin paraprak, në vitin 2022 janë akredituar më pak programe për TIK, gjë që nënkupton se mësimdhënësit kanë pasur mundësi më të pakta

të përzgjedhin programe trajnimi për të përmbushur nevojat e tyre për zhvillimin e kompetencave në fushën e teknologjisë digjitale.

Në përgjithësi, programet janë të dedikuara për të gjithë mësimdhënësit e shkollave - pavarësisht fushës apo nivelit në të cilin punojnë (me përjashtim të disa programeve, të cilat specifikohen për mësimdhënësit të avancuar në karrierë, mësimdhënësit të nivelit të fillor, apo mësimdhënësit të cilët punojnë me persona të verbër.

Të gjitha programet e akredituara, në të dy katalogët, synojnë rezultate të pritura/objektiva të caktuara dhe përmbajtje, të cilat planifikojnë t'i ofrojnë gjatë trajnimit, mirëpo gjuha e përdorur në rezultate të pritura/objektiva, në shumicën e rasteve, dallon nga kërkesat e kornizës DigCompEdu dhe instrumentit DigCompEdu, andaj analiza e rezultateve është bërë duke analizuar terminologjinë e përdorur për rezultatet e pritura/objektivat në programe, për t'i harmonizuar me terminologjinë dhe për t'i klasifikuar pastaj sipas niveleve të CEFR.

Sipas këtij klasifikimi:

- 15 programe (11+4) fokusohen në nivelin e parë A1 - Fillestar dhe A2 - Eksplorues, që nënkupton se qëllimi i programeve është t'i përgatisin mësimdhënësit të njohin dhe të përdorin teknologjinë digjitale, apo përpiqen t'i zgjerojnë njohuritë e tyre më tutje;
- 17 programe (10+7) synojnë zhvillim e mësimdhënësve në nivelin B1- Integruar, që nënkupton arritjen e kompetencave të mësimdhënësve për përdorimin e rregullt të teknologjisë digjitale në praktikën e tyre profesionale;
- 11 programe (6+5) synojnë rezultate/objektiva më të larta, të cilat prekin nivelin B2 - Ekspert, dhe ofrojnë përmbajtje që u mundësojnë mësimdhënësve të aftësohen për të identifikuar, përzgjedhur mjetet dhe përmbajtjet digjitale gjatë procesit të mësimdhënies;
- Në nivelin C1 - Udhëheqës dhe C2 - Pionier janë klasifikuar 17 programe (10+7), pritet e së cilave arrijnë nivelet më të larta. Synohet që pas ndjekjes së trajnimeve mësimdhënësit të përdorin teknologjinë digjitale në mënyrë strategjike, duke ndarë ekspertizën

me nxënës dhe kolegë, përkatësisht të iniciojnë mënyra strategjike dhe inovative për të përdorur teknologjitë digjitale në shkollë.

## V. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Përkushtimi ndaj zhvillimit të kompetencave digjitale, që ndërlidhet drejtpërdrejt me suksesin, punësimin, kreativitetin dhe prosperitetin e çdo individi (Mezuca, 2019), nuk ka qenë asnjëherë më i domosdoshëm deri më tani, meqenëse shumica dërmuese e profesioneve ekzistuese kërkojnë aftësi digjitale (Ben Williamson et al, 2019). Ka studime që flasin për rëndësinë e kësaj kompetence në profesionin e mësimdhënies, por, në anën tjetër, shtrojnë dilemën se si të përgatiten mësimdhënësit për të arritur këtë. Erstad dhe Quale (2009) argumentojnë se *mësimdhënësit vazhdimisht përballen me dilemën zhgënjyese: atyre u kërkohet me ligj që të përdorin gjerësisht TIK-un në praktikën e tyre, por askush nuk u thotë se si ata duhet ta bëjnë këtë* (f. 565). Wei et al. (2016) arritën në përfundimin se zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësimdhënësve, për të rritur kompetencën digjitale, lehtëson pranimin dhe përdorimin efektiv të teknologjive digjitale në praktikat e mësimdhënies dhe të të nxënës.

Për të arritur këtë, shumë sisteme arsimore bazë referimi për planifikim dhe zbatim të strategjive të ndryshme të intervenimit e kanë Kornizën Evropiane për Zhvillimin e Kompetencës Digjitale (Korniza DigComp 2.1, mbi bazën e së cilës u zhvilluan edhe DigCompEdu dhe DigCompOrg).

Në Kosovë, kultivimi i kompetencës digjitale të të gjitha palët e përfshira në fushën e arsimit dhe të të gjitha institucionet arsimore është planifikuar për intervenim në PSAK-un e vitit 2022-2026, përmes objektivit strategjik për digjitalizimin e arsimit (MASHTI, 2022, OS 5). Zhvillimi i kompetencës digjitale të mësimdhënësit aktualë të arsimit parauniversitar në PSAK parashihet të realizohet kryesisht përmes programeve të trajnimit, në mënyrë që mësimdhënësit të aftësohen për përdorimin e teknologjive digjitale për nevoja arsimore dhe në të njëjtën kohë të kultivojnë kompetencën digjitale të nxënës.

Gjetjet nga ky studim mund të ndihmojnë në këtë aspekt, meqenëse kanë treguar se sa i rëndësishëm është vetëvlerësimi i mësimitdhënësve për kompetencat digjitale, në funksion të pasqyrimin të një realiteti, mbi të cilin mund të planifikohen intervenimi dhe avancimi efektiv.

Përmes vetëvlerësimit të 445 mësimitdhënësve të nivelit fillor (1-5) dhe atij të mesëm të ulët (6-9), duke përdorur instrumentin e Kornizës DigCompEdu [SELFIEforTEACHERS](#), kemi dhënë përgjigje në pyetjen e hulumtimit: *Cili është niveli aktual i kompetencave digjitale të mësimitdhënësve të arsimit parauniversitar në Kosovë karshi kërkesave të Kornizës DigCompEdu dhe në programet e ZhPM?* Rezultatet e zgjeruara dhe diskutimin/interpretimin e tyre i kemi paraqitur në kapitujt paraprakë në këtë raport, ndërsa në formë të përfundimeve po i japim në vijim.

## 5.1. Përfundime

Përmbledhja e përfundimeve u referohet qëllimit të hulumtimit dhe pyetjeve kërkimore, të cilat e udhëhoqën këtë studim.

Në raport me pyetjen e parë kërkimore: *Cili është niveli i kompetencave digjitale të mësimitdhënësve të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët (klasat 1-9) karshi Kornizës referuese DigCompEdu?*, rezultatet e studimit kanë pasqyruar një gjendje jo të kënaqshme. Të dhënat e dala nga vetëvlerësimi i 445 mësimitdhënësve, përmes instrumentit [SELFIEforTEACHERS](#), kanë treguar se:

- Vetëvlerësimi i mësimitdhënësve në gjashtë fushat dhe 22 kompetencat përkatëse të Kornizës DigCompEdu, me shkallë vlerësimi sipas CEFR 1 (A1/fillestar) deri 6 (C2/pionier), ka pasqyruar nivel të kompetencave digjitale të mësimitdhënësve me mesatare të përgjithshme  $M=2.64$  ( $D.St.=1.4$ );
- Referuar gjetjeve, përqindjet më të larta të arritjeve i kemi te tri nivelet e para të CEFR dhe Taksonomisë së Bloomit.
- 23.3% e mësimitdhënësve janë në nivelin Fillestar (A1) sipas CEFR, apo në nivelin e parë (Të kujtuarit) të Taksonomisë, meqenëse kanë

arritur të grumbullojnë vetëm 32 nga 192 pikët maksimale, apo 17% nga 100%;

- 28.3% e mësimdhënësve janë në nivelin Eksplorues (A2) sipas CEFR, apo në nivelin e dytë (Të kuptuarit) të Taksonomisë, meqenëse kanë arritur të grumbullojnë 33-64 nga 192 pikë, apo 18-33% nga 100%;
- 25.8% e mësimdhënësve janë në nivelin Integrues (B1) sipas CEFR, apo në nivelin e tretë (Të zbatuarit) të Taksonomisë, meqenëse kanë arritur të grumbullojnë 65-96 nga 192 pikë, apo 34-50% nga 100%;
- Referuar përshkrimin për secilin nivel të vlerësimit, mësimdhënësit e vetëvlerësuar e kanë të qartë se si teknologjitë digjitale mund të mbështesin dhe avancojnë praktikat profesionale (A1), kanë filluar të eksplorojnë për potencialin e teknologjive digjitale dhe kanë interesim për ngritje profesionale (A2), si dhe eksperimentojnë me teknologji digjitale në kontekste të ndryshme dhe për qëllime të ndryshme, duke i integruar ato në praktikë (B1);
- Mësimdhënësit nuk qëndrojnë mirë sa i përket përdorimit të teknologjive digjitale me konfidencë, kreativitet dhe në mënyrë kritike për të avancuar aktivitetet profesionale (B2), me qasje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse për përdorimin e teknologjive digjitale për të përmirësuar pedagogjinë dhe praktikat profesionale (C1), si dhe për të reflektuar në mënyrë kritike për përshtatshmërinë e praktikave bashkëkohore digjitale dhe pedagogjike, në të cilat ata janë një Udhëheqës (C2). Kjo sepse në nivelet Ekspert (B2), Udhëheqës (C1) dhe Pionier (C2) arritshmëria është dukshëm më e ulët;
- 2.5% e mësimdhënësve janë deklaruar se nuk kanë informacion, nuk janë të vetëdijshëm për ekzistimin e kompetencave digjitale përkatëse;
- Referuar fushave të Kornizës DigCompEdu, mësimdhënësit e vetëvlerësuar qëndrojnë më mirë në përdorimin e teknologjive digjitale te Fusha 1- Angazhimi profesional, Fusha 2 - Burimet

digjitale, Fusha 5 - Fuqizimi i nxënësve, dhe deri diku te Fusha 6 - Lehtësimi i kompetencës digjitale të nxënësve, përderisa jo mirë te Fusha 3 - Mësimdhënia dhe të nxënësve dhe Fusha 4 - Vlerësimi;

- Niveli i kompetencave digjitale të mësimdhënësve të vetëvlerësuar është nën mesataren e arritjeve për të gjitha aftësitë e përshkruara në deklaratën e EU-së për kompetencat digjitale (të gjitha fushat e DigCompEdu), madje qëndron jo mirë në raport me aftësitë që ndërliken me krijimin, zgjidhjen e problemeve, mendimin kritik dhe krijues etj. (tri fushat e fundit të DigCompEdu);
- Dallime statistikisht të rëndësishme në nivelet e arritjeve të mësimdhënësve për gjashtë fushat dhe 22 kompetencat e Kornizës DigCompEdu nuk janë evidentuar as sa u përket karakteristikave demografike të të vetëvlerësuarve. Kjo i bie që të gjithë mësimdhënësit e vetëvlerësuar, pa dallim gjinie, niveli të shkollimit dhe fushës kurrikulare ku japin mësim, përvojës në përdorim të TIK-ut në profesion, nivelit të kompetencave digjitale të tyre, në përqindje më të larta i përkasin tri niveleve të para të CEFR dhe Taksonomisë së Bloomit;
- Dallime statistikisht të rëndësishme nuk ka as në rezultatet e dala nga paratesti dhe pastesti.

Në pyetjen *Cilat janë opinionet e mësimdhënësve për zbatimin e teknologjive digjitale në praktikën e tyre të mësimdhënies?*, të dhënat janë marrë nga 10 kërkesa shtesë (4+6) të bashkëngjitura në instrumentin e vetëvlerësimit. Kërkesat kanë qenë me mundësi të përgjigjeve të ndërtuara sipas Shkallës Likert (Renis Likert 1932), me pesë shkallë të vlerësimit: (5= Plotësisht pajtohem deri te 1= Aspak nuk pajtohem). Referuar përqindjeve më të larta të të deklaruarve, rezultatet e dala kanë treguar se:

- Mësimdhënësit (53%) e përdorin teknologjinë digjitale në jetën e përditshme më gjatë se 10 vjet. Kjo na bën të kuptojmë se përvojat e më shumë se gjysmës së mësimdhënësve të vetëvlerësuar për përdorim të teknologjive digjitale nuk mungojnë;

- Mësimdhënësit (63%) përdorin teknologji digjitale nga më të ndryshmet dhe më bashkëkohoret, si: apps, kompjuter, tablet, telefon të mençur, programe, pajisje, burime digjitale;
- Përdorimin e kësaj teknologjie e kanë ndërlidhur me lehtësimin e punës, duke përdorur këto teknologji, me punën online dhe angazhimin në rrjete të ndryshme online;
- Shkëputja sipas mësimdhënësve ndodh si pasojë e kushteve jo të favorshme që ofrohen për zbatimin e teknologjive digjitale në profesion, konkretisht në procesin mësimor;
- Në klasat/dhomat mësimore në të cilat mësimdhënësit (28.1%) japin mësim, nuk ka pajisje: projektor, kompjuter, tabela interaktive, nuk ka internet e as qasje në pajisje;
- E njëjta situatë, sipas mësimdhënësve (39%), nuk qëndron në shtëpitë apo familjet prej nga vijnë nxënësit, duke deklaruar se qasjen në teknologji, mjete dhe burime, nxënësit e kanë në shtëpitë e tyre;
- Një përparësi shpresëdhënëse për përmirësimin e gjendjes lidhur me përdorimin e teknologjive digjitale në procesin mësimor mësimdhënësit (51.5%) e potencojnë mbështetjen e udhëheqjes së shkollave në avancimin e gjendjes, por edhe praktikën e mira në shkollat e tyre (36.2%), në organizimin e aktiviteteve për zhvillimin profesional të mësimdhënësve për kompetencën digjitale (punëtori, trajnime, seanca mësimore etj.);
- Niveli i kompetencës digjitale të mësimdhënësve të Qendrave Burimore nuk dallon nga ai i mësimdhënësve në shkollat e rregullta;
- Rreth 67.8% e mësimdhënësve të Qendrave Burimore përdorin mjete dhe përmbajtje teknologjike të ngjashme me mësimdhënësit e shkollave të rregullta, ndërsa 37.4% kanë deklaruar se shfrytëzojnë burime të përshtatshme sipas në bazë të llojit të dëmtimit;
- Vetëm 0.95% e mësimdhënësve të Qendrave Burimore përdorin teknologji ndihmëse.

Në pyetjen *Cili është niveli i kompetencës digjitale në programet e akredituara në MASHTI?* mund të themi se, nga 36 programe gjithsej të akredituara dhe publikuara në dy katalogët e MASHTI-t, (2021 dhe 2022), janë 31 programe gjithsej që ndërlidhen me fushën e TIK-ut. Nga këto programe, dominim kemi te dy nivelet e para (A1 dhe A2). Paraqesin objektiva pothuajse të gjitha programet, mirëpo disa nga programet synojnë rezultate më të larta, duke vazhduar me nivelin B1 (10 programe 2021 dhe 7 programe 2022), niveli C1 (10 programe 2021 dhe 7 programe 2022), si dhe C2 (11 programe 2021 dhe 3 programe 2022). Më së paku programe përfshin niveli B2- Ekspert/ *Të analizuarit* (6+5). Në shumicën e programeve nuk ka hierarki të niveleve sipas CEFR.

Sa i përket ndërlidhjes së programeve me fushat e kornizës DigitCompEdu, gjetjet kanë treguar se në të dy katalogët të gjitha programet janë të ndërlidhura me fushat 1 dhe 2, mirëpo për fushat e tjera (3,4,5 dhe 6) numri i programeve shkon duke rënë. P.sh., përderisa me fushën 3 ndërlidhen më fuqishëm 22 programe (14+8), me fushën 4 ndërlidhen 10 programe (6+4), ndërsa me fushën 5 ndërlidhen 8 programe (5+3). Fusha e 6-të ndërlidhet me 7 programe (4+3). Kjo tregon se fokusi i programeve është në zhvillimin profesional të mësimeve për njohjen dhe përdorimin e burimeve digjitale. Por, sipas gjuhës së përdorur në rezultatet e pritura/objektivave, fokusi bie te fusha e mësimit dhe të nxënies - menaxhimit dhe orkestrimit të përdorimit të teknologjisë digjitale në procesin e mësimit dhe nxënies, vlerësimit, fuqizimit të nxënësve. Po ashtu, në procesin e gjithëpërfshirjes, personalizimit dhe angazhimit aktiv të nxënësve, duke iu përshtatur nivelit, interesave dhe nevojave individuale të nxënësve, si dhe mbështetjes dhe lehtësimit të kompetencës digjitale të nxënësve.

Janë interesante dallimet ose mospërputhjet e nivelit të kompetencave digjitale të mësimeve të vetëvlerësuar përmes instrumentit SELFIEforTEACHER dhe përfaqësimit të niveleve të CEFR të programet e akredituara në dy katalogët. Te vetëvlerësimi patëm rezultate dominuese të kompetencave të mësimeve te tri nivelet e para të CEFR (A1, A2 dhe B1), përderisa te nivelet e përfaqësuara në programet e akredituara, përveç niveleve A1 dhe A2, disa programe dominuan te nivelet B1,C1 dhe C2. Kjo

çështje është për t'u diskutuar në të ardhmen. Duhet shikuar pse ndodh që niveli i kompetencave digjitale të mësimitdhënësve të jetë i ulët, krahasuar me ofertën e programeve të ZHPM-së në dispozicion, për këto aspekte:

- Sa janë përfshirë mësimitdhënësit në këto programe;
- Nëse këto programe janë të mjaftueshme për numrin e mësimitdhënësve në shërbim;
- Nëse këto programe janë zbatuar në praktikën e ZhPM-së (nëse po, duhet hulumtuar cilësia e ofrimit dhe përcjellja apo 'Follow up' i proceseve);
- Duhet parë cilësia dhe thellësia e programeve në dispozicion etj.

## 5.2. Rekomandime

MASHTI për herë të parë integroi në PSAK 2022-2026 një objektiv të veçantë, objektivin strategjik 5 - Digjitalizimi i arsimit. Përmes këtij objekti, ndër të tjera, u parapa angazhim intensiv në pesë vitet vijuese, në funksion të avancimit të përdorimit të teknologjisë digjitale për përmirësimin e shërbimeve dhe të cilësisë në arsim, në përputhje me trendët e transformimit digjital. Objektivin specifik 5.4: *Zhvillimi i kompetencës digjitale të të gjitha palët në funksion të transformimit të suksesshëm digjital të arsimit dhe zhvillimit të përgjithshëm shoqëror*, ka paraparë një sërë veprimesh për realizim brenda viteve 2022 dhe 2023, të cilat deri në periudhën e realizimit të hulumtimit nuk kanë filluar së zbatuari.

Gjetjet e studimit *Niveli i kompetencave digjitale të mësimitdhënësve dhe përfshirja e saj në programet e zhvillimit profesional të mësimitdhënësve*, të dalta nga vetëvlerësimi përmes instrumentit [SELFIEforTEACHERS](#), nga opinionet e mësimitdhënësve të vetëvlerësuar për aspekte të ndërlidhura, si dhe nga analiza e detajuar e programeve aktuale të trajnimit të mësimitdhënësve për fushën e TIK-ut, pasqyruan gjendje jo të mirë sa i përket nivelit të kompetencave digjitale të mësimitdhënësve të nivelit 1-9, por edhe sa i përket përfshirjes së kësaj kompetence në programet aktuale të trajnimit.

Rekomandimet vijuese bazohen në këto gjetje dhe rekomandimi bazë është që:

- MASHTI të zbatohet sa më parë planifikimet e parapara të Planit i Veprimit, pika 5.4, specifikisht ato që është dashur të realizohen në vitin 2022 dhe të fillojnë së zbatuari në vitin 2023 (pikat 5.4.1, 5.4.2 dhe 5.4.3), duke filluar me zyrtarizimin, përkthimin dhe përshtatjen e tri dokumenteve kryesore të BE-së për kompetencën digjitale: (i) Kornizën Evropiane të Kompetencës Digjitale për Qytetarët (DigComp), (ii) Kornizën Evropiane të Kompetencës Digjitale për Mësimdhënësit (DigCompEdu), (iii) Kornizën Evropiane të Kompetencës Digjitale për Organizatat Arsimore (DigCompOrg);
- Me rastin e zbatimit, me rëndësi të veçantë është të rishikohen logjika dhe kronologjia e veprimeve të planifikuara në Planin e Veprimit;
- Rekomandojmë adoptimin e dokumenteve, jo adaptimin, siç shënohet në Planin e Veprimit, meqenëse këto janë dokumente të KE-së, të pandryshueshme. Referencë për çdo sistem arsimor.
- Përcaktojmë kompetencat themelore digjitale për mësimdhënësit në shërbim dhe para shërbimit në Kosovë, në përputhje me DigCompEdu. Mbi këtë bazë, të hartohen udhëzues praktikë për zbatimin e kornizës;
- Adaptimin, përshtatjen, kontekstualizimin e instrumentit të Komisionit Evropian [SELFIEforTEACHERS](#) për vlerësimin e kompetencave digjitale të mësimdhënësve të ISCED 1-3. Mund të shfrytëzohen modele se si vende dhe sisteme arsimore në Evropë e kanë bërë këtë, varësisht prej kontekstit (shembulli i Berlinit, i Hungarisë etj).
- Rezultatet e dalta nga studimi i IPK-së të shërbejnë për MASHTI-n dhe institucionet përkatëse si bazë e mirë për informim dhe familjarizim lidhur me:
  - ✓ rëndësinë e adoptimit të Kornizës DigCompEdu dhe dokumenteve/instrumenteve përcjellëse për zhvillimin e

kompetencës digjitale të mësimeve (dhe palëve tjera), në funksion të transformimit të suksesshëm digjital të arsimit dhe zhvillimit të përgjithshëm shoqëror, si dhe urgjencën e zbatimit të planifikimeve të parapara të Plani i Veprimit, pikat 5.4.6;

- ✓ gjenden aktuale të nivelit të kompetencave digjitale të mësimeve të arsimit fillor (1-5) dhe atij të mesëm të ulët (6-9);
- ✓ nevojën e përfshirjes së kompetencave digjitale në programet aktuale të zhvillimit profesional të mësimeve;
- ✓ nevojën e mbështetjes së shkollave me teknologji digjitale për qasje dhe përdorim nga mësuesit dhe nxënësit, në funksion të avancimit të kompetencave digjitale të dyja palëve;
- ✓ nevojën e mbështetjes së mësimeve me materiale ndihmëse dhe udhëzues praktikë, në përkrahjen e nxënësve për zotërimin e kompetencave digjitale.

Këto gjetje të shërbejnë edhe si referencë për planifikim të veprimeve konkrete për avancim të gjendjes.

- Rekomandohet që MASHTI të hulumtojë mundësitë dhe të shfrytëzojë ato për t'u bërë pjesë e zhvillimeve dhe bashkëpunimeve ndërkombëtare, në funksion të mbështetjes dhe lehtësimit të avancimit të kompetencave digjitale të mësimeve, në të gjitha nivelet. Komisioni Evropian është në proces të lansimit edhe të instrumentit SELFIEforTEACHERS për edukimin në fëmijërinë e hershme - ISCED 0 (Early Childhood Education and Care professionals - ECEC). Ndërsa, në bashkëpunim me European Training Foundation - ETF, pritet të adaptohet dhe të zbatohet SELFIEforTEACHERS me mësuesin, në shkollat dhe institucionet e trajnimit në vendet e Ballkanit, përfshirë edhe Kosovën. Shfrytëzimi i këtyre përvojave dhe i mbështetjes për të qenë pjesë e këtyre proceseve të jetë prioritet për politikëbërësit;

- MASHTI të caktojë fushë me prioritet zhvillimin e kompetencave digjitale të mësimeve;
- Korniza DigCompEdu të shërbejë si referencë për hartimin e udhëzuesve nga MASHTI, të cilët do të shërbenin si udhërrëfyes për hartuesit dhe ofruesit e programeve të ZhPM-së për këtë fushë;
- Ofertuesit e programeve të hartojnë dhe të paraqesin për akreditim programe trajnimi në harmoni me prioritetet dhe udhëzuesit e MASHTI-t;
- Mësimeve të përdorin instrumentin SELFIRforTEACHERS për vetëvlerësim, të identifikojnë nevojat për ZhPM-së dhe të përziejdhin programet varësisht nga nevojat e tyre dhe specifikat e nxënësve me të cilët punojnë;
- Rekomandohen hulumtime të mëtejshme, të vazhdueshme, në cilësinë e informatave kthyesë nga terreni (institucionet arsimore), në funksion të avancimit të vazhdueshëm të kompetencave digjitale të të gjitha palët.

## Referencat:

- Adeyemon, E. (2009). Integrating digital literacies into outreach services for underserved youth populations. *Reference Librarian*, 50(1), 85-98.
- Ammon, C.(2020). Results Section for Research Papers, Shkarkuar më: 15.07.2023 nga <https://www.sjsu.edu/writingcenter/docs/handouts/Results%20Section%20for%20Research%20Papers.pdf>
- Anderson, L.W., and D. Krathwohl (Eds.) (2001). *A Taxonomy for Learning, Teaching and Assessing: a Revision of Bloom’s Taxonomy of Educational Objectives*. Longman, New York.
- Buleshkaj, O. (2021). Analizë e gjendjes së sistemit të licencimit të mësimdhënësve dhe rekomandimet për veprim – version i shkurtuar nga Analiza e gjendjes në PSAK 2022-2026. Prishtinë.
- Bhandari, P. (2023, January 30). *What Is Qualitative Research? | Methods & Examples*. Scribbr. Retrieved February 6, 2023, from <https://www.scribbr.com/methodology/qualitative-research>.
- Council of Europe. (n.d.). *Common European Framework of Reference for Languages - CEFR*. Language Policy Unit, Strasbourg. DigCompEdu. Punie, Y. (ed). EUR 28775 EN. Publications Office of the European Union, Luxembourg, 2017.
- Dexter, S. (2008). Leadership for IT in schools. In J. Voogt & G. Knezek (Eds.), *International handbook of information technology in primary and secondary education* (pp. 543–554). New York: Springer.
- Digital Competence of Educators (DigCompEdu): Development and Evaluation of a Self-Assessment Instrument for Teachers' Digital Competence.
- Erstad, O. (2010). Educating the Digital Generation. *Nordic Journal of Digital Literacy*, 1, 56–70. Shkarkuar më: 18.01.2023 nga: <http://www.oecd.org/dataoecd/47/61/35070367.pdf>.
- Erstad, O., & Quale, A. (2009). National policies and practices on ICT in education: Norway. In T. Plomp, R. E. Anderson, N. Law, & A. Quale (Eds.).
- European Countries. CIDREE Yearbook 2021. Amersfoort: SLO, Netherlands Institute for Curriculum Development.
- Ghomi.M & Redecker. Ch.(2018). *Digital Competence of Educators (DigCompEdu): Development and Evaluation of a Self-Assessment Instrument for Teachers' Digital Competence*, Universitet Berlin.
- Hatlevik, O. E., & Christophersen, K.-A. (2013). Digital competence at the beginning of upper secondary school: Identifying factors explaining digital inclusion. *Computers & Education*, 63, 240–247.

Ilomäki, L., Kantosalo, A & Lakkala, M (2011). What is digital competence? in Linked portal. European Schoolnet (EUN), Brussels, pp. 1-12. ISBN 978-92-79-73494-6, doi:10.2760/159770, JRC107466.

Ilomäki, L., Paavola, S., Lakkala, M., & Kantosalo, A. (2016). Digital competence – An emergent boundary concept for policy and educational research. *Education and Information Technologies*, 21(3), 655–679. Instefjord, E. (2014). Appropriation of digital competence in teacher education. *Nordic Journal of Digital Literacy*, 4(9), 313–329.

Instefjord, E., & Munthe, E. (2016). Preparing pre-service teachers to integrate technology: An analysis of the emphasis on digital competence in teacher education curricula. *European Journal of Teacher Education*, 39(1), 77–93.

Jones-Kavalier, B., & Flannigan, S. L. (2008). Connecting the digital dots: Literacy of the 21st century. *Teacher Librarian*, 35(3), 13-16.

KEC (2014). *Koordinimi i Zhvillimit Profesional me bazë në shkollë*.

Kivunja, C. (2013). Embedding digital pedagogy in pre-service higher education to better prepare teachers for the digital generation. *International Journal of Higher Education*, 2(4), 131–142.

Krumsvik, R. J.(2011). Digital competence in Norwegian teacher education and schools. *Hëgre Utbildning*, 1(1), 39–51.

Kuvendi i Republikës së Kosovës.(2016).*Ligji për profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës - GZ. nr. 38-21-nëntor 2016*.

Mehmeti, S., Rraci, E. & Bajrami, K. (2019). *Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve në Kosovë*.

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2011). *Ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës*.

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2017). *UA 5/2017 Sistemi i licencimit dhe zhvillimit të mësimdhënësve në karrierë*.

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2017). *UA Korniza për Zhvillimin Profesional të Mësimdhënësve*.

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2018). *UA 10/2018 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm*.

Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit. (2021). *Katalogu i programeve të akredituara dhe të aprovuara për zhvillim profesional të mësimdhënësve dhe udhëheqësve të arsimit, Edicioni i pestë, Prishtinë*.

- Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit.(2022). Katalogu i programeve të akredituara dhe të aprovuara për zhvillim profesional të mësimit dhe udhëheqësve të arsimit, Edicioni i gjashtë, Prishtinë.
- Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2022). Shënime Statistike për Arsimin Parauniversitar 2022/23.
- Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit. (2022). Strategjia e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin Parauniversitar në Kosovë 2012-2026, Prishtinë.
- Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2018). UA 14/2018 për Vlerësimin e Performancës së Mësimit dhe Udhëheqësve.
- Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit. (2022). STRATEGJIA E ARSIMIT 2022-2026. Prishtinë. Shkarkuar më: 01. 18. 2023.
- Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit. (2021). UDHËZIM ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 08/2021, për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm.
- Mishra, P., & Koehler, M. J. (2006). Technological pedagogical content knowledge: A framework for integrating technology in teachers' knowledge. Teachers College Record, 108 (6), 1017–1054.
- OECD (2005). The OECD Program Definition and Selection of Competencies. Shkarkuar më: 26.01.2023, nga <https://www.oecd.org/education/skills-beyond-school/definitionandselectionofcompetenciesdeseco.htm>
- OECD.(2005). PISA and selection of key competencies. Executive summary. 30 qershor 2005. Shkarkuar më 24.01.2023, nga <https://www.oecd.org/pisa/definition-selection-key-competencies-summary.pdf>
- Preteni, I. (2021). Zbatimi i vlerësimit të performancës së mësimit dhe udhëheqësve – përmbledhje dhe rekomandime.
- Punie, Y. & Cabrera, M. (Eds.) (2006). The Future of ICT and Learning in the Knowledge Society.
- Qeveria e Kosovës. (2021). Programi i Qeverisë së Kosovës 2021-2025. Prishtinë. Shkarkuar më 01. 13. 2023.
- Redecker, C.(2017). European Framework for the Digital Competence of Educators: DigCompEdu. Punie, Y. (ed). EUR 28775 EN. Publications Office of the European Union, Luxembourg, 2017, ISBN 978-92-79-73494-6, doi:10.2760/159770.
- McKenzie, M, Robert (2010). The Social Psychology of English as a Global Language (pp.95-138): Results and Discussion.
- Ruiz Mezcuca. (2019). Digital competence and ICT in interpretation: «to renew or to perish». EDMETIC 2019, 8.

Selim Mehmeti, Naser Zabeli dhe Luan Sahitaj. (2020). Raport i analizës së programeve të aprovuara për ZhPM dhe udhëheqësve të arsimit (Katalogu 2020 & Katalogu 2019). Prishtinë.

Tolboom, J.L.J. & Van Rooyen, L. (Eds.) (2021). Digital Literacy: Curriculum Development and Implementation in

Wanjala, M. S. (2016). Information communication technology pedagogical integration in mathematics instruction among teachers in secondary schools in Kenya. *Journal of Education and Practice*.

J. Fredericks Volkwein. (2010). Chapter 11: Reporting Research results effectively. Shkarkuar më 20.07.2023, nga

[https://www.researchgate.net/publication/229974301\\_Reporting\\_research\\_results\\_effectively](https://www.researchgate.net/publication/229974301_Reporting_research_results_effectively)

Wastiau, P., Blamire, R., Kearney, C., Quittre, V., Van de Gaer, E., & Monseur, C. (2013). The use of ICT in education: A survey of schools in Europe. *European Journal of Education*, 48 (1).

Wei, L. M., Piaw, C. Y., Kannan, S., & Moulod, S. A. (2016). Relationship between teacher ICT competency and teacher acceptance and use of school management system (SMS). *Malaysian Online Journal of Educational Technology*.

Williamson, B. Potter, J., & Eznon, R. (2020). New research problems and agendas in learning, media and technology: the editors' wishlist, *LEARNING, MEDIA AND TECHNOLOGY* 2019, VOL. 44, NO. 2, 87–91 <https://doi.org/10.1080/17439884.2019.1614953>

Shulman, L. (1987). Knowledge and teaching: Foundations of the new reform. *Harvard Educational Review*, 57(1), 1-22.

Arbnesha Mexhuani

**PËRFSHIRJA E KOMPETENCËS DIGJITALE NË TEKSTET  
SHKOLLORE TË LËNDËS SHKATHTËSI PËR JETË  
(KLASAT 1-5)**

Prishtinë

103



## **Përfshirja e kompetencës digjitale në tekstet shkollore të lëndës Shkathësi për jetë (klasat 1-5)**

### **Abstrakt**

*Shoqëria e dijes po zhvillohet gradualisht, në një epokë të re digjitale, mirëpo, për t'u integruar, të gjitha moshave të nxënësve u nevojitet të zotërojnë kompetencat digjitale. Nxënësit e sotëm janë të rrethuar me pajisje digjitale dhe kanë filluar t'i përdorin në një moshë shumë të re, mirëpo shkollat tona ende i përkufizojnë tekstet shkollore si mjetin kryesor dhe më të preferuar për të mësuar, apo si burim kryesor të informacionit. Meqenëse shoqëria është duke iu nënshtruar një revolucioni digjital, atëherë edhe tekstet shkollore duhet të mbajnë përgjegjësi për përfshirjen e kompetencave digjitale në përmbajtjet e tyre.*

*Studimi Përfshirja e kompetencës digjitale në tekstet shkollore të lëndës Shkathësi për jetë (klasa 1-5), të fushës Jeta dhe puna, nxjerr në pah përfshirjen e kompetencës digjitale në përmbajtjet e njësisve mësimore. Tekstet shkollore, të cilat janë analizuar, janë tekstet e shtëpisë botuese "Dukagjini", që Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit, për herë të parë, lejoi përdorimin e tyre në shkolla në vitin akademik 2020-2022.*

*Në këtë studim përdorëm metodën e analizës së dokumenteve. Është analizuar përputhshmëria e kompetencave digjitale që kemi hasur në tekstet shkollore të lëndës Shkathësi për jetë (klasa 1-5) me kompetencat e Kornizës Digjitale për Qytetarët - DigComp2, të publikuar nga Komisioni Evropian, e cila në të ardhmen do të shërbejë si referencë për avancimin e kësaj kompetence të nxënësit, referuar PSAK 2022-2026, objektivit strategjik (OS5).*

*Gjetjet tregojnë se autorët e teksteve i kanë dhënë shumë pak rëndësi përfshirjes së kompetencave digjitale në përmbajtjet e teksteve. Përmbajtja në këto tekste është kryesisht e orientuar në „qasje në informacion” dhe shumë pak ka përmbajtje, të cilat përfshijnë kompetenca digjitale më të avancuara, që kanë përputhshmëri edhe me kompetencat digjitale të DigComp2.*

*Rekomandohet që në përmbajtjet e teksteve shkollore të ketë më shumë përfshirje të kompetencave digjitale për klasat 1 deri në 5, të hyjë lëndë e veçantë lënda e TIK-ut, sepse teksti i lëndës Shkathësi për jetë nuk i përmbush kërkesat e nxënësve për zhvillimin e kompetencave digjitale, të cilat i nevojiten për jetë.*

*Fjalët çelës: fusha Jeta dhe puna, kompetenca digjitale, Lënda Shkathësi për jetë, përfshirja, teksti shkollor, arsimi fillor.*

## Hyrje

Tekstet shkollore ende janë duke luajtur një rol shumë të rëndësishëm dhe parësor në edukimin e nxënësve që përgatiten për të ardhmen, edhe pse shoqëria është duke iu nënshtruar një ndryshimi digjital. Shumica e mësimit nxënësve janë duke i përdorur tekstet shkollore si burim parësor të informacionit, për arsye se tekstet shkollore mbulojnë atë se çfarë do të mësojnë apo duhet të mësojnë nxënësit gjatë vitit shkollor, duke përfshirë në mënyrë të detajuar përmbajtjet sipas plan programeve dhe Kornizës Kurrikulare të Arsimit, e cila bazohet në kompetenca, dhe qëllimi i saj është t'i mundësojë çdo nxënësi zotërimin e kompetencave për jetë dhe punë, në të cilën është e integruar edhe kompetenca digjitale, apo integrimi i TIK-ut në mësimit dhe nxënie. Duke e parë rëndësinë e mësimit dhe nxënies me bazë kompetence, që është shumë e rëndësishme për sistemin arsimor në Kosovë, pasi nxënësit ndërthurin njohuritë e tyre teorike me aftësitë praktike, atëherë edhe tekstet shkollore duhet të mbajnë përgjegjësi për përfshirjen e kompetencave digjitale në përmbajtjet e tyre.

Studimi Përfshirja e kompetencës digjitale në tekstet shkollore të lëndës Shkathësi për jetë, të nivelit 1-5, të fushës jeta dhe puna, ka për qëllim t'i analizojë tekstet shkollore në kontekstin e kompetencës digjitale dhe të sjellë një pasqyrë të detajuar të përmbajtjeve të teksteve shkollore karshi kërkesave të dokumenteve zyrtare dhe Kornizës Digjitale të Komisionit Evropian, Korniza Evropiane për Kompetencën Digjitale për Qytetarët – DigComp, e cila do të shërbejë si referencë për avancimin e kësaj kompetence të nxënësit në të ardhmen, referuar PSAK-ut 2022-2026, objektivit strategjik (OS 5). Kultivimi i kompetencës digjitale të të gjitha palët e përfshira në fushën e arsimit dhe të të gjitha institucionet arsimore të të gjitha llojeve dhe niveleve, është një ndër fushat e planifikuara për intervenim (MASHTI, 2022).

Tekstet shkollore të lëndës Shkathtësi për jetë (fusha jeta dhe puna) për klasën e parë dhe të dytë, për herë të parë kanë filluar të përdoren me vendimin e MASHT-t, në vitin 2019. Ndërsa, teksti shkollor i lëndës Shkathtësi për jetë për klasën e tretë për herë të parë është lejuar të përdoret me vendimin e MASHTI-t, në vitin 2021. Ndërsa tekstet për klasën e katërt dhe të pestë kanë filluar të përdoren për herë të parë me vendim të MASHTI-t, në vitin 2022.

Qëllimi i lëndës Shkathtësi për jetë është që nxënësi të njihet me rolet e ndryshme të individëve në jetë dhe në punë, të njihet me mjedisin dhe shëndetin, në përgjithësi me materialet e ndryshme dhe përdorimin e tyre, për trafikun dhe sjelljen e tij në trafik, profesionet, përdorimin e mjeteve të thjeshta, kompjuterin, TV-në, mediat, dhe planifikimin. Nëpërmjet lëndës Shkathtësi për jetë, rritet niveli i njohurive dhe shkathtësive për jetën e përditshme. Në kuadër të lëndës Shkathtësi për jetë, një ndër qëllimet e rëndësishme të saj është zhvillimi i kompetencave digjitale të nxënësit, përmes përdorimit të kompjuterit. Prandaj, misioni i shkollave është të mbështesë nxënësit në zhvillimin e aftësive digjitale. Ndër të tjera, edhe kurrikula, përmes çështjeve ndërkurrikulare dhe planit dhe programit të kësaj fushe pasqyron se nxënësve duhet t'u krijohen kushte për të përdorur mjete cilësore, materiale mësimore dhe tekste cilësore, për të forcuar aftësitë gjuhësore dhe digjitale të nxënësve.

## **KONTEKSTI TEORIK**

Çështja e zhvillimit të kompetencave digjitale të nxënësve për jetë dhe punë është bërë temë e epokës digjitale. Tekstet e lëndës Shkathtësi për jetë (klasat 1-5), të fushës Jeta dhe puna, për nivelin 1-5, janë të hartuara në bazë të Kurrikulës lëndore/programit mësimor për arsimin fillor të Kosovës për klasat (0,1,2,3,4 dhe 5) dhe Standardeve për tekste shkollore. Lejimi i përdorimit të këtyre teksteve në shkollë është bërë me vendimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Kosovës. MASHTI në Planin Strategjik të Arsimit 2022-2026 i ka dhënë rëndësi të veçantë zhvillimit të kompetencës digjitale për nxënësit, me qëllim të avancimit të arsimit.

Në Kosovë ende nuk ekzistojnë materiale mësimore digjitale shumëdimensionale, të cilat janë institucionale dhe në përputhje me specifikat e lëndës mësimore, fushës kurrikulare dhe nivelit të klasës, të cilat do të ndihmonin në zhvillimin e kompetencave digjitale për nxënës (MAShTI, 2022-2026).

Të vetmet materiale/mjete mësimore, të cilat janë duke e përdorur nxënësit e shkollave tona, janë tekstet shkollore, prandaj është shumë me rëndësi të vlerësohen se sa tekstet shkollore e përfshijnë në përmbajtjet e tyre kompetencën digjitale. Koncepti i kompetencës digjitale përbën objektin kryesor të këtij studimi dhe e shohim të dobishme të specifikojmë së pari se çfarë nënkuptohet me fjalën kompetencë dhe kompetencë digjitale. Në Kurrikulën e Kosovës kompetencat përfshijnë një sistem të integruar dhe koherent të njohurive, të shkathtësive dhe të qëndrimeve të aplikueshme dhe të transferueshme, të cilat do t'u ndihmojnë nxënësve që të ballafaqohen me sfidat e epokës digjitale, të ekonomisë së tregut të lirë dhe të bazuar në dije, në një botë të marrëdhënieve të ndërvarura (MAShT, 2016).

Kompetenca përkufizohet në raportin e OECD (2002) si "aftësia për të përmbushur kërkesat ose kryen një detyrë me sukses dhe përbëhet nga dimensione njohëse dhe jo konjitive".

Marrëdhënia ndërmjet kompetencës dhe aftësive, sipas OECD-së, është përkufizuar: "Kompetenca është më shumë se njohuri dhe aftësi". Ajo përfshin aftësinë për të përmbushur kërkesat komplekse, duke përdorur dhe promovuar burimet psikosociale (përfshirë aftësitë dhe qëndrimet) në një kontekst të caktuar (OECD, 2005, f. 4).

Studiuesit Ilomäki, Kantosalo dhe Lakkala (2011) përmendën këndvështrime të ndryshme sa i përket përkufizimit të këtij termi. Nga këndvështrimi i Komisionit të Bashkimit Evropian, kompetenca digjitale përfshin përdorim të sigurt dhe kritik të informacionit për biznes, argëtim dhe komunikim. Ai mbështetet nga vijnë aftësitë bazë në TIK, si: përdorimi i kompjuterëve për të marrë, vlerësuar, ruajtur, prodhuar, paraqitur dhe shkëmbyer informacione, për të komunikuar nëpërmjet

internetit, dhe për të marrë pjesë së bashku në rrjetet (European Commission, 2006). Në raportin e Qendrës së Përbashkët të Kërkimit (JRC); Ferrari (2012) termin e kompetencës digjitale e përkufizon: Kryerja e detyrave, zgjidhja e problemeve; kontakti; menaxhimi, informacioni; për të bashkëpunuar; njohuritë dhe aftësitë e nevojshme kur përdorni TIK-un dhe mediat digjitale për të krijuar dhe shkëmbyer përmbajtje, si dhe për të strukturuar informacionin në një mënyrë efektive, të përshtatshme, kritike, krijuese, autonome, në mënyrë fleksibile, etike, reflektuese për punë, kohë të lirë, pjesëmarrje, mësim dhe socializim, qëndrim, aftësia, strategjia dhe ndërgjegjësimi (DigComp, 2012).

Sipas UNESCO-s (2018), kompetenca digjitale përkufizohet si aftësia për të përdorur pajisje digjitale, aplikacionet dhe rrjetet e komunikimit për të aksesuar dhe menaxhuar informacionin; të komunikojnë, të bashkëpunojnë, të zgjidhin probleme, të krijojnë dhe të shpërndajnë përmbajtje digjitale për mësim dhe punë në veprimtaritë e përgjithshme dhe shoqërore.

Sa i përket kompetencës digjitale, janë krijuar shumë korniza mbi këtë temë, një ndër to është Korniza Evropiane e Kompetencës Digjitale për Qytetarët, e njohur si DigComp 2.1, që për herë të parë u publikua në vitin 2013. Kjo kornizë ofron udhëzime për të përmirësuar kompetencën digjitale te qytetarët. Ndërsa në qershor të 2016, JRC publikoi DigComp, duke përditësuar terminologjinë dhe modelin konceptual, si dhe duke shfaqur shembuj të zbatimit të tij në nivel evropian, kombëtar dhe rajonal. Qëllimi i kësaj kornize është të mbështesë palët e interesuara me zbatimin e mëtejshëm të kompetencave digjitale për të gjithë qytetarët. (DigComp 2.1).

Korniza Evropiane e Kompetencës Digjitale (DigComp 2.1) është bërë një referencë për zhvillimin dhe planifikimin strategjik të iniciativave të kompetencës digjitale, si në nivel shteti anëtar. Fushat e kompetencave digjitale dhe kompetencat specifike të kësaj kornize janë: (shih tabelën 1.)

*Tabela 1. Fushat e kompetencës digjitale të Kornizës Evropiane (DigComp 2.1) dhe kompetencat specifike*

<b>Fushat e Kompetencës</b>	<b>Kompetencat specifike</b>
<p><b>1. Informacioni</b></p> <p>Për të artikuluar nevojat për informacion, për të gjetur dhe marrë të dhëna, informacione dhe përmbajtje digjitale. Për të gjykuar rëndësinë e burimit dhe përmbajtjes së tij. Për të ruajtur, menaxhuar dhe organizuar të dhëna, informacione dhe përmbajtje digjitale.</p>	1.1. Shfletimi, kërkimi, filtrimi, informacioni dhe përmbajtja digjitale
	1.2. Vlerësimi i të dhënave, informacionit dhe përmbajtjes digjitale
	1.3. Menaxhimi i të dhënave, informacionit dhe përmbajtjes digjitale
<p><b>2. Komunikimi dhe bashkëpunimi</b></p> <p>Të komunikosh dhe të bashkëpunosh përmes teknologjive digjitale, duke qenë të vetëdijshëm për diversitetin kulturor dhe brezash. Për të marrë pjesë në shoqëri, përmes shërbimeve digjitale publike dhe private dhe qytetarisë pjesëmarrëse</p>	2.1. Ndërveprimi nëpërmjet teknologjive digjitale;
	2.2. Ndarja e teknologjive digjitale;
	2.3. Angazhimi në qytetari nëpërmjet teknologjive digjitale;
	2.4. Bashkëpunimi nëpërmjet teknologjive digjitale;
	2.5. Ndërgjegjësimi kulturor.
<p><b>3. Krijimi i përmbajtjes digjitale</b></p> <p>Krijimi dhe modifikimi i përmbajtjes digjitale. Për të përmirësuar dhe integruar informacionin dhe përmbajtjen në një grup njohurish ekzistuese, duke kuptuar se si duhet të zbatohen të drejtat e autorit dhe licencat. Të dijë të</p>	3.1. Zhvillimi i përmbajtjes digjitale (nga përpunimi i tekstit te imazhi dhe videoja);
	3.2. Integrimi dhe ripërpunimi i përmbajtjes digjitale;
	3.3 E drejta e autorit dhe licencat;
	3.4 Programimi.

japë udhëzime të kuptueshme për një sistem kompjuterik.	
<b>4. Siguria</b> Për të mbrojtur pajisjet, përmbajtjen, të dhënat personale dhe privatësinë në mjediset digjitale. Të mbrojë shëndetin fizik dhe psikologjik dhe të jetë i vetëdijshëm për teknologjitë digjitale për mirëqenien sociale dhe përfshirjen sociale. Të jenë të vetëdijshëm për ndikimin mjedisor të teknologjive digjitale dhe përdorimin e tyre..	4.1. Njohuri për pajisjet mbrojtëse - masa sigurie;
	4.2 Mbrojtja e të dhënave personale dhe privatësisë;
	4.3 Mbrojtja e shëndetit dhe mirëqenies;
	4.4 . Mbrojtja e mjedisit.
<b>5. Zgjidhja e problemeve</b> Për të identifikuar nevojat dhe problemet dhe për të zgjidhur problemet konceptuale dhe situatat problemore në mjediset digjitale. Për të qenë të përditësuar me evolucionin digjital.	5.1. Zgjidhja e problemeve teknike;
	5.2. Identifikimi i nevojave dhe burimeve teknologjike;
	5.3. Përdorimi kreativ i teknologjive digjitale;
	5.4 Zgjidhja e problemeve përmes mjeteve digjitale.

Sa i përket kurrikulës së vendit tonë, nuk ka asnjë përkufizim për kompetencën digjitale, kompetencës digjitale i referohen vetëm në çështjet ndërkurrikulare përmes temave, siç është Edukimi për media. “Çështja e edukimit për media përfshin përmbajtjet lidhur me mediat tradicionale dhe digjitale: televizionin, radion, filmin, gazetatat, revistat, fotografitë, reklamat, lojërat elektronike, dhe etikën në media” dhe realizimi i mësimit bëhet në mënyrë të integruar (MASHt, 2016). Po ashtu, edhe në standardet për tekstet shkollore, të cilat i hartoi MASHtI në vitin 2011, në tekstin për lëndën Shkathtësi për jetë, për nivelin 1-5, parasheh që teksti shkollor duhet të përmbajë materiale, të dhëna dhe metoda të reja pune, që do t’u ndihmojnë

nxënësve dhe mësimdhënësve për përvetësimin e njohurive dhe shkathtësive të nevojshme për integrim në proceset globale, ku përparimet teknologjike janë shtysë e rëndësishme e zhvillimit shoqëror në përgjithësi dhe zhvillimit ekonomik në veçanti (MASHTI, 2011). Ndërsa, sipas planeve dhe programeve të klasave 1 deri në 5, të lëndës Shkathtësi për jetë, kjo lëndë duhet të orientohet drejt përvetësimit të njohurive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave për të ngritur vetëdijësimin dhe vetëbesimin për përdorimin e TIK-ut (MASHTI, 2018-22).

Në Kurrikulën e Shqipërisë kompetenca digjitale është e veçantë, që nënkupton njohuri për përdorimin kritik dhe efektiv të TIK-ut në shkollë, gjatë kohës së lirë dhe në komunikimin e përditshëm. Kjo kompetencë mbështetet tek aftësitë themelore për të gjetur, për të krijuar, për të shkëmbyer informacion, për të komunikuar, si dhe për të bashkëpunuar me rrjetet sociale në internet. Kompetenca digjitale i jep një kornizë më të qartë nxënësit se si ai/ajo të gjejë, të përpunojë, dhe të analizojë një informacion të caktuar, i cili e ka burimin nga interneti (MAS, 2014).

Sa u përket studimeve për përfshirjen e kompetencave digjitale në tekstet shkollë, në Kosovë nuk ka asnjë studim. Ndërsa, sipas literaturës së huaj, studiuesit (Doğan & Torun, 2018) theksojnë se tekstet shkollë janë burimi i parë i udhëzimit dhe ndihmës në fitimin e njohurive, aftësive ose qëndrimeve që lidhen me lëndë, mësimdhënës dhe nxënës. Meqë tekstet mbulojnë “çfarë do të mësohet apo duhet të mësohet gjatë arsimit, po ashtu këta libra përfshijnë një përshkrim të detajuar të përmbajtjes sipas planit dhe programit, për këtë arsye shumica e mësuesve përdorin tekstet shkollë si burim parësor për planet ose aktivitetet e mësimin. Në studimin e Yüksel dhe Taneri (2020), tekstet shkollë të Jetës dhe punës janë shqyrtuar në aspektin e përfshirjes së kompetencave kyçe brenda kuadrit të kualifikimeve turke dhe në përputhje me rrethanat. Në këto tekste, kompetencës digjitale i jepet një normë e ulët në libra, në të gjitha nivelet. Në studimin e Kanës dhe Kiler (2021), tekstet e shkollës së mesme turke ishin shqyrtuar në kuadrin e kompetencave në kurrikulën turke, gjë që kompetenca digjitale ishte ndër kompetencat që përfshiheshin më së paku. Studiuesja Pala (2020) ka shqyrtuar planin dhe programin e teksteve të lëndëve shoqërore të klasave të pesta dhe rezultatet e studimit tregojnë se marrëdhënia ndërmjet qëllimeve

mësimore në klasën e 5-të të lëndëve shoqërore lidheshin drejtpërdrejt me kompetencën digjitale.

Në studimin e Otuz, Kayabaşı dhe Ekici (2018), Mësimdhënia e lëndës së studimeve sociale dhe përmbajtja e kurrikulës 2017, studiuesit kanë shqyrtuar përmbajtjet dhe kanë analizuar rezultatet e nxënies në lëndët - Shkathtësitë bazë, gjetjet e tyre treguan se kompetenca digjitale në përmbajtjet e teksteve shkollore dhe në kurrikulën e tyre zë shumë pak vend, ose aspak.

Yalkın dhe Işık (2019), nga ana tjetër, analizuan arritjet e kurrikulës së lëndëve shkencore të shkollës fillore (klasat e 3-ta dhe të 4-ta dhe klasat e 5-ta dhe të 8-ta) sipas çelësit të mësimit gjatë gjithë jetës për kompetencat e përcaktuara në Kornizën e Kualifikimeve të Turqisë. Ata deklaruan se ata kanë arritur kompetencën digjitale vetëm në një nënarritje në klasën e 8-të.

Në studimin Vlerësimi i Teksteve të Shkencave dhe Matematikës në Kontekst të Kompetencës digjitale, që autorët e këtij studimi analizuan tekstet për klasë e gjashtë dhe të tetë, për përfshirjen e kompetencës digjitale në librat e shkencës dhe matematikës, rezultatet tregojnë se nuk ekziston një dallim i dukshëm në numrin e përmbajtjes së kompetencës digjitale në tekstet shkollore të klasave të gjashta dhe të teta (Çelikoglu, Tas, Ayyıldız & Yesiltas, 2022).

Ndërsa, sipas (Skolverket, 2018), Kurrikula thotë se mjedisi i shkollës dhe i punës së nxënësve është i krijuar në mënyrë që të gjithë nxënësit duhet të kenë qasje dhe kushte për të përdorur materiale mësimore cilësore, si dhe mjete të tjera mësimore për një arsim bashkëkohor, duke përfshirë mjetet digjitale, bibliotekat e shkollave dhe tekstet mësimore, të cilat përdoren si pjesë e mësimdhënies për të forcuar aftësitë gjuhësore dhe digjitale të nxënësve. Shkollat mund të zgjedhin se çfarë pajisje dhe metodë do të përdorin, prandaj është e qartë se shkollat, duke filluar nga klasat parafillore e deri tek arsimi i mesëm i lartë, duhet të kenë një mision të përbashkët për të mbështetur nxënësit në zhvillimin e kompetencave digjitale. Mungesa e pajisjeve nuk duhet të kufizojë aftësinë e nxënësve për të zhvilluar njohuritë dhe aftësitë digjitale që i nevojiten për jetë.

Përveç rolit të teksteve shkollore në mësimdhënie dhe në nxënie, mësimdhënia, po ashtu, është praktikë që kërkon një ndërthurje të shumë llojeve të njohurive të specializuara. Në këtë mënyrë, mësimdhënia është disiplinë që kërkon nga mësuesit të aplikojnë struktura komplekse njohurish në raste dhe në kontekste të ndryshme (Mishra, Spiro, & Feltovich, 1996; Spiro & Jehng, 1990).

Mishra dhe Koehler, studiues nga Universiteti Shtetëror i Miçiganit, në mungesë të teorive të mjaftueshme për të shpjeguar ose drejtuar integrimin efektiv të kompetencave digjitale në edukim, zhvilluan teorinë TPACK. Që nga publikimi i tij nga Punya Mishra dhe Matthew J. Koehler, në vitin 2006, teoria TPACK është bërë një nga teoritë kryesore, e cila përqendrohet në njohuritë teknologjike (TIK), njohuritë pedagogjike (PK) dhe njohuritë e përmbajtjes (CK), që ofron një qasje produktive. Duke bërë dallimin midis këtyre tre llojeve të njohurive, teoria TPACK përshkruan se si përmbajtja (ajo që mësohet) dhe pedagogjia (si mësuesi e transmeton atë përmbajtje) duhet të formojnë themelin për çdo integrim efektiv. Ky udhëzim është i rëndësishëm, sepse teknologjia që zbatohet duhet të komunikojë përmbajtjen dhe të mbështesë pedagogjinë, në mënyrë që të përmirësojë përvojën e të mësuarit të studentëve. (Kurt, 2019) Ndërsa, në publikimin e The future of education and skills Education, 2030, të OECD-së, projekti Arsimi 2030, ka identifikuar tri kategori të tjera të kompetencave: "Kompetencat Transformuese, siç janë Krijimi i vlerës së re, Pajtimi i tensioneve dhe dilemave dhe Marrja e përgjegjësisë. Në bazë të kompetencës Krijimi i vlerave të reja përfshihen: përshtatshmëria, kreativiteti, kurioziteti dhe mendja e hapur. Duke e ditur se jetojmë në një botë të karakterizuar me pabarazi, të rinjtë duhen të kultivojnë kompetencën për të trajtuar tensionin dhe dilemat, prandaj kompetenca Pajtimi i tensioneve dhe dilemave përfshin balancimin e barazisë dhe lirisë, autonomisë dhe komunitetit, inovacionit dhe vazhdimësisë, si dhe efikasitetit dhe procesit demokratik. Kompetenca e tretë: Marrja e përgjegjësisë, që është një kompetencë transformuese dhe një parakusht i dy kompetencave të tjera, përfshin ballafaqimin me risitë, ndryshimin dhe diversitetin. Të vepruarit në mënyrë etike nënkupton duke bërë pyetje që lidhen me normat, vlerat, kuptimet dhe kufijtë, si dhe duke ditur pasojat e asaj që ke bërë, apo duhet ta kishe bërë. Në qendër të kësaj

kompetence është koncepti i vetërregullimit, i cili përfshin vetëkontrollin, vetëfikasitetin, përgjegjësinë, zgjidhjen e problemeve dhe përshtatshmërinë (OECD 2018). Ndërsa, sipas Shulman, kur mësuesi interpreton dhe reflekton në mënyrë kritike lëndën, gjen mënyra të ndryshme për të paraqitur informacionin, si me demonstrime dhe aktivitete në klasë, duke përshtatur materialin dhe nivelet e aftësisë (Shulman, 1986).

### **Pyetja kryesore e hulumtimit**

Si është e përfshirë kompetenca digjitale në përmbajtjet e teksteve shkollore të fushës Jeta dhe puna, lënda Shkathtësi për jetë (klasat 1 - 5)?

### **Pyetjet ndihmëse**

1. Si është e shpërndarë kompetenca digjitale në kapitujt e teksteve shkollore të lëndës Shkathtësi për jetë?
2. Si ndryshon shpërndarja e kompetencave digjitale në tekstet shkollore sipas klasave?
3. Kultivimi i kompetencës digjitale në tekstet shkollore sa është në përputhshmëri me kërkesat digjitale të Kornizës Evropiane Digjitale për Qytetarët (DigComp 2.1)

## **METODOLOGJIA**

### **Qëllimi i hulumtimit**

Qëllimi i hulumtimit është të pasqyrojë se si në tekstet shkollore të lëndës Shkathtësi për jetë, të fushës Jeta dhe puna, është e përfshirë kompetenca digjitale dhe sa janë në përputhshmëri me kërkesat digjitale të Kornizës Evropiane të Kompetencës Digjitale për Qytetarët (DigComp 2.1)

### **Modeli i hulumtimit**

Për të marrë një pasqyrë të përgjithësuar rreth studimit, është përdorur qasja hulumtuese cilësore dhe sasiore. Janë analizuar dokumentet shkollore zyrtare: Korniza Evropiane për Kompetencën digjitale të qytetarëve

(DigComp 2.1) dhe tekstet shkollore, në kontekstin e përfshirjes së kompetencës digjitale në tekstet shkollore.

### **Instrumentet e hulumtimit**

Për shqyrtimin e teksteve shkollore është përdorur listë kontrolli për analizë/vlerësim të teksteve shkollore. Për analizën e të dhënave është krijuar një listë kontrolli, duke përdorur kompetencat digjitale të Kornizës Digjitale të Komisionit Evropian (DigComp). Të gjitha të dhënat e mbledhura janë grupuar në kategori tematike, që lidhen me pyetjet kërkimore, për të cilat kemi bërë interpretime dhe përshkrime.

### **Procedura e mbledhjes së të dhënave**

Për mbledhjen e të dhënave është përdorur metoda për analizën e dokumentacionit. Kjo është realizuar përmes hulumtimit kabinetik. Mbledhjen e të dhënave e kemi bërë duke shfletuar (analizuar) literaturë shkencore - Kornizën Evropiane të Kompetencës Digjitale për qytetarët (DigComp), dokumente zyrtare - Kornizën Kurrikulare, planin dhe programin e lëndës Shkathtësi për jetë për klasën e parë, të dytë, të tretë, katërt dhe të pestë, Standardet për hartimin e teksteve shkollore, si dhe tekstet e lëndës për klasat në fjalë.

### **Procedura e analizës së të dhënave**

Tekstet shkollore janë analizuar me kujdes dhe të gjitha gjetjet janë shënuar në listën e kontrollit, pastaj janë përshkruar në tabela. Është shqyrtuar mënyra e përfshirjes së kompetencës digjitale në përmbajtjet e teksteve shkollore dhe përputhshmëria ndërmjet rezultateve të të nxënit për kompetencën digjitale të teksteve shkollore dhe planeve e programeve lëndore, si dhe përputhshmëria e tyre karshi kërkesave të Kornizës Evropiane për Kompetencën Digjitale. Të gjitha gjetjet janë përshkruar përmes programit Microsoft Office Word 2010.

## **Rëndësia e studimit**

Studimi ka rëndësi profesionale dhe shkencore dhe përmes rekomandimeve synon të kontribuojë në ngritjen e cilësisë së teksteve shkollore, duke qenë sa më bashkëkohore për nga përmbajtja që trajton, që t'u ndihmojë mësimdhënësve dhe nxënësve në kultivimin e kompetencës digjitale, për t'u integruar në proceset globale ku përparimet e teknologjisë janë shtysë e rëndësishme e zhvillimit shoqëror. Studimi është një ndihmesë për institucionet përkatëse, mësimdhënësit, nxënësit dhe autorët e teksteve, që në të ardhmen të kenë mundësi për rishikimin e tyre.

## **REZULTATET**

### **I. PËRFSHIRJA E KOMPETENCËS DIGJITALE NË KAPITUJT E TEKSTEVE SHKOLLORE TË LËNDËS SHKATHTËSI PËR JETË (KLASAT 1- 5)**

#### **1.1. Libri Shkathtësi për jetë i klasës së parë**

Libri shkathtësi për jetë për klasën e parë është i përbërë prej gjashtë kapitujve/temave: 1) Materialet dhe përpunimi i tyre, 2) Trafiku, 3) Profesionet, 4) Planifikimi, 5) Kujdesi ndaj ambientit dhe ruajtja e shëndetit, 6) Mjedisi

Në temat Materialet dhe përpunimi i tyre, Trafiku, Planifikimi, Kujdesi ndaj ambientit dhe ruajtja e shëndetit, dhe në temën Mjedisi, autorët nuk kanë të përfshirë asnjë kompetencë digjitale, ndërsa në temën Profesionet, në faqen 26. Autorët i kanë ilustruar pjesët e kompjuterit, pra e kanë të përfshirë Kompetencën digjitale, e cila përputhet me kompetencën specifike digjitale DigComp 2, Informacion për përmbajtjen digjitale, të fushës digjitale Informimi (*përmes ilustrimeve*).

#### **1.2. Libri Shkathtësi për jetë i klasës së dytë**

Libri Shkathtësi për jetë i klasës së dytë është i përbërë prej gjashtë kapitujve/temave: 1) Materialet dhe përpunimi i tyre, 2) Trafiku, 3) Profesionet, 4) Planifikimi dhe shpenzimet, 5) Mjedisi dhe shëndeti, 6)

Mediet.. Përveç në temën Media, në asnjë nga këto tema nuk është e përfshirë ndonjë kompetencë digjitale.

### **Kapitulli/tema 6: Media**

Kapitulli/tema Media është e përbërë nga njësitë: Media dhe llojet e tyre dhe Loja skenike (personazhet janë mediat). Në këto njësi autorët shumë pak e kanë të përfshirë kompetencën digjitale në dy njësi mësimore, prej faqeve (73, 74, 75, 77), që përputhet me kompetencën digjitale specifike të DigComp2, ndarja e teknologjive digjitale, të fushës digjitale Komunikim dhe bashkëpunim.

#### **1.3. Libri Shkathtësi për jetë i klasës së tretë**

Libri Shkathtësi për jetë i klasës së tretë është i përbërë prej gjashtë kapitujve /temave:1) Materialet dhe përpunimi i tyre, 2) Njohja e rreziqeve, 3) Karriera ime, 4) Planifikimi, 5) Mjedisi dhe shëndeti, 6) Mediet.

### **Kapitulli/tema 2: Njohja e rreziqeve**

Në kapitullin e dytë, Njohja e rreziqeve, në f. 14, autorët flasin për rreziqet që mund të shkaktohen nga interneti dhe telefoni, po ashtu edhe në faqen 25, në njësinë mësimore Rreziku nga valët e telefonit dhe internetit, autorët thonë se përdorimi i tepërt i telefonit mund të shkaktojë probleme të shumta shëndetësore. Në faqen 26, autorët kanë paraqitur pyetje të hapura për rreziqet që mund të shkaktohen nga përdorimi i telefonit për një kohë të gjatë. Ndërsa në faqen 27, në njësinë mësimore - tregimin “Amari, Fiona dhe lojërat kompjuterike”, autorët tregojnë rreziqet që ndodhin nga lojërat kompjuterike. Në këtë kapitull, në dy njësi mësimore (përmbajtje) ka të përfshirë dy kompetenca, të cilat përputhen me kompetencat digjitale specifike të Komisionit Evropian (DigComp2). Mbrojtja e shëndetit dhe mirëqenies së fushës Mbrojtja.

### **Kapitulli/tema 6: Media**

Në faqen 64, në njësinë mësimore Aktivitetet në internet, autorët paraqesin rëndësinë e internetit për mësimnxënie dhe japin tre shembuj të ilustruar se

si realizohet përmbajtja digjitale. Në këtë njësi mësimore e kemi të përfshirë kompetencën digjitale, e cila përputhet me kompetencën specifike DigComp2, zhvillimin e përmbajtjes digjitale të fushës Krijimi i përmbajtjes digjitale.

Në faqen 70, në fjalorthin në fund të librit, autorët japin informacione për domethënien e fjalëve Powerpoint dhe Word. Ndërsa mungon domethënia e fjalës websitet. Këtu kemi përfshirje të kompetencës digjitale, e cila përputhet me kompetencën specifike të DigComp2 Informimi për përmbajtjen digjitale, të fushës Informacioni.

#### **1.4. Libri Shkathtësi për jetë i klasës së katërt**

Libri shkathtësi për jetë i klasës së katërt është i përbërë nga 6 kapituj/tema, me përmbajtje të ndryshme, si: Kapitulli 1. Materialet dhe përpunimi i tyre, Kapitulli 2. Njohja me rreziqet, Kapitulli 3. Karriera ime, Kapitulli 4. Planifikimi, Kapitulli 5. Mjedisi dhe shëndeti dhe Kapitulli 6 Mediet.

##### **Kapitulli/tema 1: Materialet dhe përpunimi i tyre**

Në përmbajtjen e kapitullit/temës *Materialet dhe përpunimi i tyre* autorët japin informacione për format e figurave dhe trupave gjeometrikë, si dhe punimin e tyre nga letra. Po ashtu, në këtë modul jepen informacione edhe për modelimin e qepjes, qëndisjes ,thurjes, llojet e materialeve dhe mjeteve për përpunimin e tyre, dhe për ekspozimin e punimeve. Në fund të këtij moduli, në rubrikën Ekspozimi i punimeve, përfshihet kompetenca digjitale, e cila përputhet me kompetencën specifike të DigComp2 shfletimi, të fushës Informacioni dhe të dhënat, që kërkohet nga nxënësit të hulumtojnë në internet për veshjet tradicionale të shteteve të Ballkanit.

Ndërsa në asnjë njësi tjetër të këtij kapitulli dhe as në aparaturën didaktike (rubrikën e pyetjeve, fjalorthit dhe rubrikën fjalë dhe shprehje kyçe) autorët nuk kanë të përfshirë në përmbajtjen e njërive mësimore asnjë kompetencë digjitale, edhe pse në këtë moshë fëmijët gjithmonë po janë në kontakt me teknologjinë dhe u nevojiten shkathtësitë për epokën digjitale.

## **Kapitulli/tema 2: Njohja me rreziqet**

Në përmbajtjen e kapitullit *Njohja me rreziqet* autorët nuk kanë të përfshirë asnjë kompetencë digjitale, në asnjë njësi mësimore dhe as në aparaturën didaktike të këtij moduli. Autorët në përmbajtjen e këtij moduli kanë dhënë informacione për rreziqet që mund të ndodhin gjatë përdorimit të aparateve elektrike (shporetit, tosterit, hekurit, mikserit, aparatit për bluarje frigoriferit, rrobalarësës). Autorët në asnjë paragraf të këtij kapitulli nuk kanë të përfshirë kompetenca digjitale, nuk kanë dhënë informacione për rreziqet që mund të shkaktohen nga interneti dhe po ashtu nuk kanë përshkruar strategji për t'u mbrojtur nga sulmet dhe kërcënimet në internet, megjithëse në modulën e gjashtë e kanë të përfshirë përmbajtjen për sigurinë në internet. Mirëpo, përmes këtij moduli ka pasur mundësi që autorët të japin informacione për nxënësit, se si të përdorin platformat e mediave sociale dhe të kuptojnë rrezikun e postimeve dhe kontaktit me njerëzit e panjohur.

## **Kapitulli/tema 3: Karriera ime**

Në përmbajtjen e këtij kapitulli autorët flasin për punën e të rriturve dhe profesionet. Autorët japin informacione që në ditët e sotme profesioni i programerit është një nga profesionet më tërheqëse për të rinjtë. Po ashtu, ky modul ka të përfshirë edhe profesionin e të rriturve që merren me TIK-un. Kemi të përfshirë kompetencën që përputhet me kompetencën specifike të DigComp2: Angazhimi në qytetari nëpërmjet teknologjive të fushës digjitale Komunikim dhe bashkëpunim.

Në faqen 36, në njësinë *Mësojmë programin me kompjuter*, autorët e kanë të përfshirë kompetencën digjitale Programimi të fushës, Krijimi i përmbajtjes digjitale. Po ashtu, në rubrikën e fjalorthit autorët kanë përshkruar vetëm domethënien e fjalës Windows. Autorët e kanë të përfshirë kompetencën digjitale Informacione për përmbajtjen digjitale, të fushës **Informacioni**.

## **Kapitulli/tema 4: Planifikimi**

Në këtë kapitull autorët në dy njësitë mësimore: *Mësojmë të vizatojmë me kompjuter* dhe *Si të vizatojmë me programin Paint*, e kanë të përfshirë

kompetencën digjitale Përdorimi kreativ i teknologjive digjitale, të fushës Zgjidhja e problemit.

### **Kapitulli/tema 5: Mjedisi dhe shëndeti**

Ky kapitull është i përbërë nga njësitë: Shkalla e rrezikut nga mbeturinat e caktuara, Ndikimi i cilësisë së mjedisit në cilësinë e shëndetit të njeriut; Disa porsit dhe këshilla për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit, Çfarë mund të bëni ju që të ndihmoni mjedisin? Përpunimi i gjërave të ndryshme me materiale ricikluese. Në asnjërën njësi nuk ka integrim të kompetencave digjitale, të cilat do të edukonin nxënësit për përdorimin e drejtë dhe të pavarur të teknologjisë, duke i ndihmuar për punë dhe jetë në të ardhmen.

### **Kapitulli/tema 6: Media**

Kapitulli Media është i përbërë prej pesë njësive mësimore, të cilat në përmbajtjet e tyre i kanë të përfshira kompetencat digjitale. Në njësinë mësimore Siguria në internet (f. 58.) autorët kanë dhënë udhëzime dhe praktika për mbrojtje personale. Në faqen 60 jepen informacione si të veprojnë nxënësit nëse diçka i shqetëson, sa i përket përdorimit të kompjuterit. Në faqen 61 autorët i udhëzojnë nxënësit se si të kërkojnë në internet dhe në faqen 62 flasin për ndarjen dhe funksionin e mediave digjitale, duke përfshirë radion, televizorin dhe mediet sociale. Autorët, po ashtu, edhe në aparaturën didaktike të këtyre njësive i kanë të përfshira kompetencat digjitale të fushës Siguria në internet.

Në këtë kapitull i kemi të përfshira këto kompetenca digjitale: Në njësitë Siguria në internet është e përfshirë kompetenca që përputhet me kompetencën digjitale të DigComp2. Mbrojtja e të dhënave personale dhe privatësisë të fushës Siguria në internet, në njësinë Përdorimi i kompjuterit për sigurinë në internet po ashtu e kemi të përfshirë kompetencën digjitale e cila ka përputhshmëri me kompetencën digjitale të DigComp2. Mbrojtja e të dhënave personale dhe privatësisë, të fushës Siguria në internet. Në njësinë mësimore Kërkimi i informacioneve në internet është e përfshirë kompetenca digjitale, e cila ka përputhshmëri me kompetencën digjitale të DigComp Shfletimi i përmbajtjeve dhe informacioneve digjitale, të fushës Informacioni. Në njësinë Radioja, televizioni dhe mediet sociale e kemi të

përfshirë kompetencën digjitale Ndarja e teknologjisë digjitale, të fushës Komunikim dhe Bashkëpunim.

### **1.5. Libri Shkathtësi për jetë i klasës së pestë**

Ky libër përbëhet prej gjashtë kapitujve: 1) Shkathtësi për jetë, 2) Puna me projekt përmes TIK-ut, 3) Mjedisi dhe shëndet, 4) Ekonomia familjare, 5) Karriera; 6) Mediat.

Kompetencat reflektohen nëpërmjet rezultateve të të nxënësve, të cilat janë të përgjithshme dhe të cilat shprehin atë se çfarë duhet të arrijnë nxënësit në mënyrë progresive dhe të vazhdueshme deri në fund të arsimit të detyrueshëm.

#### **Kapitulli/tema 1: Shkathtësi për jetë (Punë dore)**

Në kapitullin Shkathtësi për jetë (Punë dore) në asnjë njësi mësimore nuk kemi integrim të asnjë kompetence digjitale.

#### **Kapitulli/tema 2: Puna me projekte përmes TIK-ut**

Në kapitullin Puna me projekte përmes TIK-ut, në të gjitha njësitë mësimore janë të përfshira kompetencat digjitale. Në njësinë mësimore Punojmë një bateri nga limoni - krijim punëdore, autorët udhëzojnë nxënësit që të vizitojnë uebfaqet ku mund të shohin demonstrimin e shembullit në mënyrë virtuale. Autorët kanë paraqitur edhe linqet e uebfaqeve për hulumtim. Po ashtu, në njësinë mësimore Punojmë furrën diellore (solare, f. 30) është një krijim punëdore, në fund të njësisë autorët japin udhëzime që të hyjnë në uebfaqe të internetit dhe të shfletojnë faqe të internetit për të marrë ide për punë praktike. Në të gjitha këto njësi kemi përfshirje të kompetencave digjitale; shfletimi dhe gjetja e informacionit të fushës digjitale *Informacioni*.

Në njësinë mësimore Si ta bëjmë projektin përmes TIK-ut, (f. 31), autorët projektin e krijimit të baterisë me limonë japin adresën në internet për të shikuar se si përgatitet projekti. Këtu kemi përfshirje të kompetencës digjitale Integrimi dhe ripërpunimi i përmbajtjes digjitale të fushës të Dig Comp Krijimi i përmbajtjes digjitale. Në njësinë mësimore Punojmë

praktikisht teknika origami autorët japin detyra të shtëpisë që të hulumtojnë në internet rreth përdorimit të teknikës Origami. Në këtë njësi përfshijnë kompetencën digjitale Shfletimi dhe kërkimi në internet i fushës digjitale **Informacioni**. Po ashtu, edhe në faqet 40, 41, 42 dhe në faqen 43, ku është fjalorthi, autorët japin ilustrime dhe udhëzime se si të punojmë origamin me kompjuter. Këtu kemi përfshirjen e kompetencës digjitale Integrimi dhe ripërpunimi i përmbajtjes digjitale, të fushës Krijimi i përmbajtjes digjitale.

### **Kapitulli/tema 3: Mjedisi dhe shëndeti**

Kapitulli/tema Mjedisi dhe shëndeti është përbërë prej pesë njësive mësimore: Diversiteti individual, Diversiteti ekologjik në mjedisin jetësor, Ditët ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit, Projekti për aktivitet sipas kalendarit mjedisor, Ndikimi negativ i mbetjeve të pazbërthyeshme në mjedis dhe në shëndetin njerëzor. Në asnjërën nga këto njësi dhe as në rubrikën e pyetjeve dhe fjalorthit nuk ka integrim të kompetencave digjitale, të cilat do të edukonin nxënësit për përdorimin e drejtë dhe të pavarur të teknologjisë, duke i ndihmuar për punë dhe jetë në të ardhmen.

### **Kapitulli/tema 4: Ekonomia familjare**

Kapitulli Ekonomia familjare përbëhet prej pesë njësive mësimore: Menaxhimi i buxhetit në vendbanime të ndryshme, Organizimi i buxhetit familjar, Kursimet e fëmijëve ndihmojnë në buxhetin familjar, Fëmijët mësojnë të kursejnë dhe të organizojnë paratë e tyre, Veshjet - paketimi dhe pajisjet e ndryshme nga materialet ricikluese. Në këtë kapitull, në asnjë nga këto njësi mësimore nuk kemi të përfshirë asnjë kompetencë digjitale, po ashtu as në fjalorthin dhe as në rubrikën e pyetjeve.

### **Kapitulli/tema 5: Karriera**

Kapitulli Karriera është i përbërë prej pesë njësive mësimore: 1) Rruga e Karrieres, 2) Hobi dhe profesioni më i pëlqyer, 3) Profesionet e ndryshme, 4) Plani i shkathësive/aftësive, 5) Ide të ndryshme për Krrierë.

Në njësinë mësimore Hobi dhe profesioni më i pëlqyer, në faqen 87, është e përfshirë kompetenca digjitale e informacionit dhe përmbajtjes digjitale të fushës Informacione dhe të dhëna. Autorët flasin për hobin që kanë nxënësit

për lojërat kompjuterike dhe mundësinë e dizajnit të tyre, si dhe mundësinë e realizimit të këtij profesioni në të ardhmen. Vetëm në një njësi mësimore është e përfshirë kompetenca digjitale, ndërsa në njësitë e tjera nuk ka përfshirje të kompetencave digjitale.

### **Kapitulli/tema 6: Mediet**

Kapitulli Mediet është i ndarë në nëntë njësi mësimore: 1) Rëndësia e mediave, 2) Organizimi i aktiviteteve shkollore përmes medias, 3) Realizimi i garave, sfidave të ndryshme mësimore - veprimtrive ndërmarrëse, 4) Zhvillimi i lojrave përmes mediave, 5) Të llogarisim së bashku, 7) Kodimi dhe zgjidhja e problemeve, 8) Micro:bit-i, projektet dhe zgjidhja e problemeve 9) Klubi i Kodimit.

Në faqen 94, në njësinë mësimore Rëndësia e Mediave, autorët japin informacione të shkurtra për programet kompjuterike dhe llojet e medieve. Në këtë njësi kemi përfshirje të kompetencës digjitale *Angazhimi në qytetari nëpërmjet teknologjive digjitale* të fushës Komunikimi dhe bashkëpunimi.

Në njësinë mësimore Organizimi i aktiviteteve shkollore përmes medias, faqe 101, autorët japin të dhëna për mundësinë e organizimit të aktiviteteve shkollore, duke përdorur media të ndryshme, po ashtu japin disa shembuj për përdorimin e kompjuterit për nxënie, p.sh. (për të shkruar ese të ndryshme, duke përdorur programin Power point, video-incizime etj). Në këtë njësi mësimore është e përfshirë kompetenca digjitale Marrja e vendimeve të informuara dhe cilat mjete digjitale janë më të përshtatshme për qëllimin, të fushës Zgjidhja e problemit.

Në njësinë mësimore Realizimi i garave, sfidave të ndryshme mësimore-veprimtrive ndërmarrëse (f. 102), autorët japin informacione për rëndësinë e kompjuterit, sidomos videove vetëdijesuese, që nxënësit mund të krijojnë për informacione të ndryshme. Këtu kemi përfshirje të kompetencës digjitale, e cila përputhet me kompetencën digjitale të (DigComp2) - Ndërveprimi nëpërmjet teknologjive digjitale të fushës Komunikimi dhe bashkëpunimi.

Në njësinë mësimore *Zhvillimi i lojërave përmes mediave* (f. 104), autorët japin informacione për rëndësinë e lojërave kompjuterike për edukim, si dhe kanë dhënë disa linqe që nxënësit të luajnë lojëra edukuese. Po ashtu, kanë dhënë një ilustrim të llojit të lojës, e cila mund të përdoret për ndërmarrësi. Në përmbajtjen e kësaj njësie mësimore kemi kompetencë digjitale, e cila përputhet me kompetencën digjitale të DigComp2 - Menaxhimi i të dhënave, informacionit dhe përmbajtjes digjitale, të fushës *Leximi i informacioneve dhe të dhënave*.

Në njësinë mësimore *Kodimi dhe zgjidhja e problemeve* (f. 107) autorët japin informacione të pakta për rëndësinë e kodimit, në përmbajtjen e kësaj njësie kanë të përfshirë kompetencën digjitale, e cila përputhet me kompetencën digjitale të DigComp2. Informacione dhe literaturë të fushës *Leximi i informacioneve dhe të dhënave*.

Në njësinë mësimore *Micro: bit-i projektet dhe zgjedhja e problemeve* (f. 109, 110, 111, 112) autorët përshkruajnë përbërjen e Micro:bit, po ashtu paraqesin edhe ilustrime për pjesët përbërëse të mikrob:it-it. Në faqe (112) autorët japin disa probleme dhe nxënësit e kanë për detyrë që përmes kodimit të bëjnë zgjedhjen e tyre. Në këtë njësi autorët kanë të përfshirë kompetencën digjitale *Përdorimi kreativ i teknologjive digjitale të fushës Zgjidhja e problemit, ndërsa në faqet 109, 110 dhe 111 është e përfshirë kompetenca digjitale, e cila përputhet me kompetencën digjitale të DigComp2 - Programimi*.

Në njësinë mësimore *Klubi i Kodimit* (113) autorët kanë dhënë informacione të ndryshme për mënyrën e krijimit të klubeve të kodimit. Në këtë njësi kemi përfshirje të kompetencës digjitale, e cila ka përputhshmëri me kompetencën digjitale të DigComp2. Zgjidhja e problemeve teknike, të fushës digjitale *Zgjidhja e problemit*.

## **II. SHPËRNDARJA E KOMPETENCAVE DIGJITALE NË PËRMBAJTJET E TEKSTEVE SHKOLLORE TË KLASAVE (1 -5)**

Në tekstin shkollor të lëndës Shkathtësi për jetë, të klasës së parë, kemi të përfshirë vetëm një përmbajtje me një kompetencë digjitale, e cila ka përputhshmëri me kompetencën specifike të fushës digjitale të DigComp 2.1, në fushën e Informacionit. Pra, teksti shkollor i klasës së parë përmban një përmbajtje për qasje në informacione. Ndërsa, sa upërket rezultateve që i parasheh plani dhe programi i lëndës Shkathtësi për jetë, për klasën e parë, ai parasheh që nxënësit të përdorin kompjuterin për komunikim fillestar. Ndërsa rezultati në nivel fushe parasheh që nxënësit në këtë klasë kuptojnë dhe përdorin teknologjinë për jetë dhe punë. Në tekstin e klasës së dytë kemi dy përmbajtje, që përfshijnë dy kompetenca specifike digjitale të fushës së Informacionit. Edhe teksti i klasës së dytë përmban përmbajtje për qasje në informacion, e cila paraqitet përmes ilustrimeve. Ndërsa rezultatet që duhet të arrihen sipas planit dhe programit të lëndës Shkathtësi për jetë janë: në nivel lënde dallon llojet e mediave, ndërsa në nivel fushe është: Përdor TIK-un për komunikim fillestar. Në tekstin shkollor të lëndës Shkathtësi për jetë, të klasës së parë, kemi të përfshirë vetëm një përmbajtje me një kompetencë digjitale, e cila ka përputhshmëri me kompetencën specifike të fushës digjitale të DigComp 2.1, në fushën e Informacionit. Pra, teksti shkollor i klasës së parë përmban një përmbajtje për qasje në informacione. Ndërsa, sa upërket rezultateve që i parasheh plani dhe programi i lëndës Shkathtësi për jetë, për klasën e parë, ai parasheh që nxënësit të përdorin kompjuterin për komunikim fillestar. Ndërsa rezultati në nivel fushe parasheh që nxënësit në këtë klasë kuptojnë dhe përdorin teknologjinë për jetë dhe punë. Në tekstin e klasës së dytë kemi dy përmbajtje, që përfshijnë dy kompetenca specifike digjitale të fushës së Informacionit. Edhe teksti i klasës së dytë përmban përmbajtje për qasje në informacion, e cila paraqitet përmes ilustrimeve. Ndërsa rezultatet që duhet të arrihen sipas planit dhe programit të lëndës Shkathtësi për jetë janë: në nivel lënde dallon llojet e mediave, ndërsa në nivel fushe është: Përdor TIK-un për komunikim fillestar.

Tabela 2. Shpërndarja e kompetencave digjitale në tekste shkollore të lëndës Shkathësi për jetë (klasat 1 dhe 2)

Tekstet Shkathësi për jetë	Kapituj në tekste	Numri i njësive në tekste	Numri i kapitujve që përfshijnë komp. digj.	Numri i njësive që përfshinë komp. digj.	Numri i Kompetencave specifike	Fusha e DigComp	Rezultatet për lëndë
Teksti i klasës së parë	6	48	1	1 (2.1%)	Gjithsej 1 kompetencë	Gjithsej 1 fushë	Rezultatet për lëndë sipas kurrikulës për klasën e parë
					Informimi për përmbytjen digjitale	Informacioni	<p>Përdor kompjuterin personal komunikim fillestar dhe realizimin e ndonjë projekti të vogël. (Te kapitulli profesionet).</p> <p>Kuptimi dhe përdorimi i teknologjisë për jetën dhe punën e përditshme.</p> <p>Rez. për fushë: Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme.</p>

Teksti i klasës së dytë	6	27	1	2 (7.4%)	Gjithsej 2 kompetenca	Gjithsej 2 fusha	Rezultatet për lëndë dhe fushë sipas kurrikulës për klasën e dytë
					Ndarja e teknologjive digjitale	Komunikim dhe bashkëpunim	(Kapitulli profesionet) Realizon projekte të vogla (duke përdorur burime të ndryshme, si kompjuterin.
					Informimi për përmbajtjen digjitale	Informacioni	Rezultati për fushë. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme.

## **Shpërndarja e kompetencave digjitale në tekste shkollore, të klasës së tretë, të katërt dhe të pestë**

Në klasën e tretë kemi katër përmbajtje, të cilat përfshijnë katër kompetenca digjitale specifike. Dy kompetencat specifike: mbrojtja e shëndetit dhe e mirëqenies, i takojnë fushës Siguria në internet, një kompetencë specifike për informimin për përmbajtje digjitale që i takon fushës së Informacionit dhe një kompetencë specifike/zhvillimi i përmbajtjes digjitale, që i takon fushës digjitale Krijimi i përmbajtjes digjitale. Sa i përket planit dhe programit të lëndës, rezultatet që duhen të arrijnë me nxënës në nivel lënde janë: Njihet me rreziqet që shkaktohen nga interneti, prezanton në klasë përmes TIK-ut imazhe që lidhen me punën dhe lloje mediash që shikon në shtëpi, ndërsa sa u përket rezultateve në nivel fushë, plani dhe programi parashohin që të përdoret kompjuteri në mënyrë të sigurt, për të krijuar projekte të ndryshme, për të hulumtuar dhe për të krijuar detyra.

Në tekstet e klasës së katërt kemi të përfshirë kompetencën digjitale në katër kapituj dhe në 11 përmbajtje mësimore. Kompetencat digjitale që janë të përfshira në këto 11 njësi mësimore përputhen me fushat e kompetencës së DigComp (2), siç janë: Fusha e Informacionit që përfshin 3 kompetenca specifike (një të informimit dhe dy shfletimi i literaturës për TIK), fusha Komunikimi dhe bashkëpunimi që përfshin 4 kompetenca specifike (angazhimi në qytetari, përmes teknologjive digjitale (2) dhe ndarja e teknologjive digjitale (2), fusha Zgjidhja e problemit që përfshin 3 kompetenca specifike (tri janë për përdorimin kreativ të TIK-ut) dhe fushën Krijimi i përmbajtjes digjitale që përfshin 1 kompetencë specifike (Programimin).

Në tekstet e klasës së pestë kompetencat digjitale janë të përfshira në tre kapitujt e tekstit dhe në 13 përmbajtje mësimore. Fushat e kompetencave që përmbajnë kompetenca specifike dhe që përputhen me DigComp (2) janë: Fusha e informimit, e cila përfshin pesë kompetenca specifike; Fusha e komunikimit dhe bashkëpunimit, e cila përfshin 2 kompetenca specifike; Fusha e krijimit të përmbajtjes digjitale, që përfshin 2 kompetenca specifike; dhe fusha e Zgjidhjes së problemeve, që përfshin katër kompetenca

specifike. Kompetencat specifike digjitale që janë të përfshira në këto përmbajtje janë: Gjetja e informacionit, integrimi dhe ripërpunimi i përmbajtjes digjitale, informacioni, krijimi i përmbajtjes digjitale, *angazhimi në qytetari nëpërmjet teknologjive digjitale*, marrja e vendimeve rreth mjeteve digjitale që duhet përdorur, ndërveprimet ndërmjet teknologjive, menaxhimi i të dhënave, programimi dhe zgjidhja e problemeve teknike.

Tabela 3. Shpërndarja e kompetencave digjitale në tekste shkollore të lëndës Shkathtësi për jetë (klasat 3, 4, 5)

Tekstet Lënda: Shkathtësi për jetë	Kapituj në tekste	Numri i njësive në tekste	Kapituj që përfshijnë kompeten cën digj.	Numri i njësive që përfshin komp. digj.	Numri i kompetencave specifike DigComp.	Fusha e DigComp	Rezultatet për lëndë dhe fushë sipas kurrikulës
Teksti i klasës së tretë	6	38	2	4 10.52%	Gjithsej 4 kompetenca	Gjithsej 3 fusha	Rezultatet për lëndë dhe fushë, sipas kurrikulës, për klasën e tretë
				Mbrojtja e shëndetit dhe mirëqenies (2)		Siguria në internet	Rezultatet për lëndë. Njihet me rreziqet që shkaktojnë valët e internetit. Përdorë sigurt TIK-un për të krijuar projekte të ndryshme, planifikim të aktiviteteve, krijim të detyrave, hulumtim dhe zhvillim të shkathtësive praktike.
				Zhvillimi i përmbajtjes digjitale (1)		Krijimi i përmbajtjes digjitale	Rezultatet për fushë: Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme;
				Informim për përmbajtjen digjitale (1)		Informacioni	Përdorimi i teknologjisë për jetë dhe për punën e përditshme.

Teksti i klasës së katërt	6	38	4	11 28.94%	Gjithsej 11 kompetenca	Gjithsej 4 fusha	Rezultatet për lëndë të klasës së katërt
				Informim për përbajtjen digjitale (1)	Informacioni	Përdor kompjuterin personal për të reflektuar ide dhe krijimtari fillestare;	
				Shfletim i përbajtjes digjitale (2)	Informacioni	Përdor sigurt TIK-un për të krijuar projekte të ndryshme, planifikim të aktiviteteve, krijim të detyrave, hulumtim dhe zhvillim të shkathësive praktike.	
				Angazhimi në qytetari nëpërmjet teknologjive digjitale (2)	Komunikim dhe bashkëpunim	Ndërgjegjësohet dhe informohet për sigurinë në internet;	
				Ndarja e teknologjive digjitale (2)	Komunikim dhe bashkëpunim	Prezanton me anë të kompjuterit sigurinë e fëmijëve në internet;	
				Përdorimi kreativ i TIK-ut (3)	Zgjidhja e problemit	Kupton rëndësinë e ruajtjes së të dhënave personale (emri, mbiemri, adresa e shtëpisë etj.);	
				Programimi (1)	Krijimi i përbajtjes digj.	Kupton që interneti përmban një sasi shumë të madhe informacioni për kërkimin dhe gjetjen e informacionit të kërkuar.	

Teksti i klasës së pestë	6	40	3	13 32.5%	Gjithsej 13 kompetenca	Gjithsej 4 fusha	Rezultatet për lëndë të klasës së pestë
				Menaxhim i të dhënave (1)	Informacion		<p>Tregon ecurinë e krijimit të një projekti në TIK me crafts;</p> <p>Përshkruan fazat e krijimit dhe prezantimit të një projekti përmes TIK-ut;</p> <p>Përdor programe kompjuterike për krijimin e modeleve siç janë origami, crafts për punëdore;</p> <p>Modelon forma të ndryshme me crafts përmes skicave dhe modeleve që gjenden në internet;</p> <p>Krijon projekte shkollore me programe kompjuterike me fokus në punëdore (crafts, origami).</p>
				Informim për përmbajtjen digjitale (4)	Informacion		
				Përdorimi kreativ i TIK (1)	Zgjidhja e problemit		
				Zgjidhja e problemeve teknike (1)			
				Integrimi dhe ripërpunimi i përmbajtjes digjitale (1)	Krijimi i përmbajtjes Digjitale		
				Zhvillimi i përmbajtjes digjitale (1)	Krijimi i përmbajtjes Digjitale		
				Angazhimi në qytetari nëpërmjet teknologjive digjitale (1)	Komunikim dhe bashkëpunim		
				Ndërveprime ndërmjet teknologjive digjitale (1)	Komunikim dhe bashkëpunim		
				Marrja e vendimeve për përdorim të mjeteve digjitale (1)	Zgjidhja e problemit		
				Programim (1)	Zgjidhja e problemit		

### **III. KULTIVIMI I KOMPETECËS DIGJITALE NË TEKSTET SHKOLLORE DHE PËRPUTHSHMËRIA E TYRE ME KËRKESAT DIGJITALE TË KORNIZËS EVROPIANE PËR QYTETARË (DIGCOMP 2.1)**

Në **tekstin e klasës së parë**, të lëndës Shkathtësi per jetë, autorët kanë përfshirë kompetenca digjitale vetëm në një kapitull, në kapitullin e tretë – Profesionet, gjë që kjo kompetencë ka përputhshmëri me kompetencën digjitale të DigComp2, Informimi, që ka të bëjë vetëm me njohjen.

Në **tekstin e klasës së dytë** autorët kanë të përfshirë kompetenca digjitale në një kapitull, në kapitullin e gjashtë - Mediet dhe llojet e tyre, dhe në tregimin Loja skenike, d.m.th. në faqet (73, 74, 75, 77). Kompetenca e kultivuar në këtë kapitull ka përputhshmëri me kompetencën specifike të DigComp2 - ndarja e teknologjive digjitale, të fushës Komunikim dhe Bashkëpunim.

Në **tekstin e klasës së tretë** autorët kanë përfshirë kompetenca digjitale në dy kapituj: Në kapitullin e dytë - Njohja e rrezeqeve dhe në kapitullin e gjashtë - Mediet.

Në kapitullin Njohja e rrezeqeve është e përfshirë kompetenca digjitale, e cila ka përputhshmëri me kërkesat digjitale të DigComp2 - Mbrojtja e të dhënave personale dhe privatësisë, të fushës Siguria.

Në kapitullin Mediet janë të përfshira dy kompetenca digjitale: Kompetenca Informimi dhe Krijimi i përmbajtjes digjitale. Mbrojtja e të dhënave personale dhe privatësisë.

Në **tekstin e klasës së katërt kompetencat digjitale janë të përfshira** në katër kapituj: në kapitullin e parë - Materialet dhe përpunimi i tyre (Ekspozimi i punimeve), që është e përfshirë kompetenca digjitale e informimi (Leximi i informacioneve dhe të dhënave).

Në kapitullin e tretë - Karriera ime, janë të përfshira dy kompetenca digjitale: Informimi (fusha Leximi i informacioneve dhe të dhënave) dhe Programimi (Krijimi i përmbajtjes digjitale).

**Në kapitullin e katërt - Planifikimi** është e përfshirë një kompetencë digjitale në dy njësi: Në njësitë Mësojmë dhe vizatojmë me kompjuter dhe në njësinë Si të vizatojmë me programin Paint. Kompetenca që është e përfshirë në këto dy njësi është Përdorimi kreativ i teknologjisë digjitale (f. Zgjidhja e problemeve).

Në kapitullin Mediet, në katër njësi mësimore janë të përfshira këto kompetenca: Mbrojta e privatësisë (fusha, Mbrojtja) dhe informimi i përmbajtje digjitale (fusha - Informacione dhe të dhëna).

**Në tekstin e klasës së pestë autorët kanë të përfshirë kompetenca digjitale në 3 kapituj:** Në kapitullin Puna me projekte, në kapitullin e Karriera dhe në kapitullin Mediet.

**Në kapitullin Puna me projekte përmes TIK-ut,** në të gjitha njësitë mësimore janë të përfshira këto kompetenca digjitale: Informimi dhe përmbajtja digjitale, të fushës digjitale të DigComp2 **Informacioni (në dy njësi mësimore)**, Integrimi dhe ripërpunimi i përmbajtjes digjitale, të fushës Krijimi i për mbajtjes digjitale.

**Në kapitullin Karriera,** i cili është i përbërë prej pesë njësive mësimore, përfshirje të kompetencës digjitale kemi vetëm në një njësi mësimore: Hobi dhe profesioni më i pëlqyer. Në këtë njësi mësimore është e përfshirë kompetenca digjitale e Informacionit dhe e krijimit të përmbajtjes digjitale.

## **Kapitulli/tema 6: Mediet**

Në kapitullin Mediet Kapitulli Mediet është i ndarë në nëntë njësi mësimore. Në të gjitha njësitë mësimore kemi të përfshirë kompetenca digjitale. Kompetencat digjitale që janë të përfshira në këtë kapitull janë: 1) *Angazhimi në qytetari nëpërmjet teknologjive dixhitale* të fushës Komunikimi dhe bashkëpunimi, 2) informimi, 3) Marrja e vendimeve të informuara rreth cilat mjete dixhitale janë më të përshtatshme për qëllimin, të fushës Zgjedhja e Probemit, 4) Ndërveprimi nëpërmjet teknologjive dixhitale të fushës „Komunikimi dhe bashkëpunimi, 5) Menaxhimi i të dhënave, informacionit dhe përmbajtjes dixhitale, të fushës **Leximi i informacioneve dhe të dhënave**, 6) **Përdorimi kreativ i teknologjive**

*dixhitale, të fushës Zgjidhja e problemit, 7) Programimi, 8) Zgjidhja e problemeve teknike, të fushës digjitale Zgjidhja e problemit.*

*Tabela 4. Fushat e Kompetencës digjitale të Kornizës Evropiane për Qytetarët (DigComp 2.1), të përfshira në tekstet shkollore të lëndës Shkathtësi për jetë (klasat 1 - 5).*

Numri i kompetencave specifike			Numri i fushave	
Klasa e parë	1	2.1%	1	Informacion
Klasa e dytë	2	(7.4%)	2	Informacion Komunikim dhe bashkëpunim
Klasa e tretë	4	10.52%	3	Informacion Siguria në internet (2) Krijimi i përmbajtjes digjitale
Klasa e katërt	11	28.94%	4	Informacion (3) Komunikim dhe bashkëpunim (4) Zgjidhja e problemit (3) Krijimi i përmbajtjes digjitale (1 Programimi)
Klasa e pestë	13	32.5%	4	Informacion (5) Komunikim dhe bashkëpunim (2) Zgjidhja e problemit (4) Krijimi i përmbajtjes digjitale (2)

## **DISKUTIM I REZULTATEVE**

Sipas tabelës 1, numri i përmbajtjeve për kompetencën digjitale, të përfshira në tekstin e klasës së parë, nuk ndryshon shumë nga numri i kompetencave të përfshira në përmbajtjet e tekstit të klasës së dytë. Teksti Shkathtësi për jetë, i klasës së parë, përmban vetëm një kompetencë digjitale, e cila ka

përputhshmëri me kompetencën digjitale të fushës së informacionit, të Kornizës Evropiane të Kompetencës Digjitale (DigComp 2.1).

Ndërsa, teksti shkollor i klasës së dytë përmban 2 kompetenca digjitale, që kanë përputhshmëri me kompetencat e DigComp 2.1, njëra i takon fushës digjitale të informacionit dhe tjetra fushës së komunikimit dhe bashkëpunimit, që përmbajtja e njësive mësimore ka të bëjë vetëm me "qasje në informacion". Kompetencat digjitale që janë të përfshira në njësitë mësimore të teksteve shkollore të klasës së parë dhe të dytë, i takojnë nivelit të njohjes (Taksonomia e Blumit).

Rezultatet që i parashih plani dhe programi i klasës së parë në kontekstin e përfshirjes së kompetencave digjitale në tekstin shkollor të lëndës Shkathtësi për jetë janë dhënë në kapitullin Këshillim dhe orientim në karrierë. Rezultatet e arritshmërisë për lëndë janë: Përdor kompjuterin për komunikim fillestar, realizimin e ndonjë projekti të vogël (hulumtim i fotografive, ruajtja e dokumentit etj.), ndërsa rezultati për fushë është Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme.

Rezultatet që i parashih Kurrikula lëndore/programi mësimor i klasës së dytë janë të paraqitura në kapitullin Këshillim dhe orientim në karrierë, te tema Profesionet, dhe në kapitullin Mediet dhe llojet e tyre, që rezultatet janë: (Realizon projekte të vogla duke përdorur burime të ndryshme, si kompjuterin, mediat, fletushkat, revista, dallon disa lloje mediash dhe liston emisionet e TV-së në bazë të moshës) që këto rezultate janë pothuajse të njëjta me rezultatet e klasës së parë. Ndërsa, rezultatet për fushë janë: Kuptimi dhe përdorimi i teknologjisë për jetën dhe punën e përditshme dhe Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme. Në bazë të këtyre rezultateve për lëndë dhe fushë, këto tekste nuk japin njohuri të mjaftueshme nxënësve për përdorimin e TIK-ut për jetë dhe punë.

Përfshirja e kompetencës digjitale në përmbajtjet e teksteve shkollore të këtyre dy klasave është shumë e mangët dhe zë shumë pak vend, si në tekste po ashtu edhe në plane dhe programe, ndërsa rezultatet e arritshmërisë sipas Kurrikulës lëndore/programit mësimor janë të nivelit më të lartë (i takojnë

pritshmërive më të larta) krahasuar me nivelin e përmbajtjeve dhe hapësirën e mangët që u jepet kompetencave digjitale në tekst. Po ashtu, rezultatet për lëndë, të cilat i parasheh Kurrikula lëndore/programi mësimor i klasës së parë dhe të dytë, pothuajse janë të njëjta, edhe pse mosha e fëmijëve ndryshon nga klasa në klasë.

Sipas tabelës nr. 2, përfshirja dhe shpërndarja e kompetencave digjitale në librat e klasës së tretë, të katërt dhe të pestë, nuk ka shumë ndryshime për nga numri i kapitujve dhe njësive, të cilat përfshijnë kompetencën digjitale. Klasa e tretë ka të përfshirë 4 kompetenca digjitale në 38 njësitë mësimore që gjithsej përfshin tekstin. Kompetencat më shumë i përkasin nivelit të njohjes (Taksonomia e Blumit). Kompetencat digjitale që janë të përfshira në këto klasë dukshëm kanë të bëjnë me përmbajtje për sigurinë në internet, ndërsa shumë pak ka përmbajtje që i informojnë nxënësit se si të mbrohen nga sulmet dhe kërcënimet në internet, që i parasheh edhe Korniza e Kompetencave Digjitale të Evropës (DigComp 2.1).

Klasa e katërt ka 38 njësi mësimore dhe 11 kompetenca digjitale dhe të gjitha kanë përputhshmëri me kompetencat e Kornizës Evropiane (DigComp2), mirëpo vetëm tri prej tyre kanë të bëjnë me zgjidhjen e problemit dhe një kompetencë ka të bëjë me krijimin e përmbajtjeve digjitale, gjegjësisht me programim që i takon nivelit më të lartë të Taksonomisë së Blumit (Krijimit/kreativitetit).

Klasa e pestë i ka 13 kompetenca digjitale, në 40 njësi mësimore; ka dy kompetenca më shumë se në klasën e katërt, që tri prej tyre i takojnë fushës së zgjedhjes së problemeve. Dy kompetenca i takojnë fushës së krijimit të përmbajtjes digjitale (programimit) dhe kompetencat e tjera i takojnë fushës së informacionit dhe komunikimit dhe bashkëpunimit. Që të gjitha kanë përputhshmëri me kompetenca digjitale të Kornizës Evropiane (DigComp2), mirëpo nivelit më të lartë sipas Taksonomisë së Blumit i takojnë vetëm pesë kompetenca digjitale (programimi, krijimi i përmbajtjes digjitale, dhe tri kompetenca për zgjidhjen e problemit).

Rezultatet tregojnë se nuk ekziston një dallim i dukshëm në numrin e njësive që përfshijnë përmbajtje me kompetencë digjitale në tekstet shkollore të

klasës së parë dhe të dytë, e po ashtu edhe për klasën e tretë, deri në klasën e pestë. Kompetencat digjitale të përfshira në këto klasa dhe shkallë pothuajse janë të njëjta. Në tekstin e klasës së pestë kemi vetëm një kompetencë më shumë se në klasën e katërt, që ka të bëjë me programimin. Ky rezultat përputhet edhe me studimin Vlerësimi i Teksteve të Shkencave dhe Matematikës në Kontekst të Kompetenca Digjitale. Autorët e këtij studimi (Çelikoglu, Tas, Ayyildiz & Yesiltas. 2022) analizuan tekstet për klasë e gjashtë dhe të tetë për përfshirjen e kompetencës digjitale në librat e shkencës dhe matematikës, që po ashtu rezultatet tregojnë se nuk ekziston një dallim i dukshëm në numrin e përmbajtjes së kompetencës digjitale në tekstet shkollore të klasave të gjashta dhe të teta.

Rezultatet që i parasheh Kurrikula lëndore/programi mësimor i lëndës Shkathtësi për jetë, për klasën e tretë, të katërt dhe të pestë, në kontekst të përfshirjes së kompetencës digjitale, janë: Nxënësit të përdorin kompjuterin personal për komunikim dhe për realizim të ndonjë projekti të vogël, ndërsa rezultatet për fushë parashohin që nxënësit të përdorin TIK-un për të avancuar cilësinë e jetës së përditshme. Po ashtu, nxënësit të përdorin kompjuterin për të krijuar projekte të ndryshme shkollore. Kompetencat digjitale që janë të përfshira në tekstet e klasës së tretë, të katërt dhe të pesë të lëndës Shkathtësi për jetë kanë përputhshmëri me kompetencat e Kornizës Digjitale të Evropës DigComp, mirëpo nuk kanë përfshirje të mjaftueshme, edhe pse kompetencat digjitale po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme, si në punë ashtu edhe në jetë, dhe bota është bërë e varur nga teknologjia.

Sipas tabelës 1, numri i përmbajtjeve për kompetencën digjitale, të përfshira në tekstin e klasës së parë, nuk ndryshon shumë nga numri i kompetencave të përfshira në përmbajtjet e tekstit të klasës së dytë. Teksti Shkathtësi për jetë, i klasës së parë, përmban vetëm një kompetencë digjitale, e cila ka përputhshmëri me kompetencën digjitale të fushës së informacionit, të Kornizës Evropiane të Kompetencës Digjitale (DigComp 2.1).

Ndërsa, teksti shkollor i klasës së dytë përmban 2 kompetenca digjitale, që kanë përputhshmëri me kompetencat e DigComp 2.1, njëra i takon fushës digjitale të informacionit dhe tjetra fushës së komunikimit dhe bashkëpunimit, që përmbajtja e njëjste mësimore ka të bëjë vetëm me "qasje

në informacion". Kompetencat digjitale që janë të përfshira në njësitë mësimore të teksteve shkollore të klasës së parë dhe të dytë, i takojnë nivelit të njohjes (Taksonomia e Blumit).

Rezultatet që i parasheh plani dhe programi i klasës së parë në kontekstin e përfshirjes së kompetencave digjitale në tekstin shkollor të lëndës Shkathtësi për jetë janë dhënë në kapitullin Këshillim dhe orientim në karrierë. Rezultatet e arritshmërisë për lëndë janë: Përdor kompjuterin për komunikim fillestar, realizimin e ndonjë projekti të vogël (hulumtim i fotografive, ruajtja e dokumentit etj.), ndërsa rezultati për fushë është Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme.

Rezultatet që i parasheh Kurrikula lëndore/programi mësimor i klasës së dytë janë të paraqitura në kapitullin Këshillim dhe orientim në karrierë, te tema Profesionet, dhe në kapitullin Mediet dhe llojet e tyre, që rezultatet janë: (Realizon projekte të vogla duke përdor burime të ndryshme, si kompjuterin, mediat, fletushkat, revista, dallon disa lloje mediash dhe liston emisionet e TV-së në bazë të moshës) që këto rezultate janë pothuajse të njëjta me rezultatet e klasës së parë. Ndërsa, rezultatet për fushë janë: Kuptimi dhe përdormi i teknologjisë për jetën dhe punën e përditshme dhe Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme. Në bazë të këtyre rezultateve për lëndë dhe fushë, këto tekste nuk japin njohuri të mjaftueshme nxënësve për përdorimin e TIK-ut për jetë dhe punë.

Përfshirja e kompetencës digjitale në përmbajtjet e teksteve shkollore të këtyre dy klasave është shumë e mangët dhe zë shumë pak vend, si në tekste po ashtu edhe në planprograme, ndërsa rezultatet e arritshmërisë sipas Kurrikulës lëndore/programit mësimor janë të nivelit më të lartë (i takojnë pritshmërive më të larta) krahasuar me nivelin e përmbajtjeve dhe hapësirën e mangët që u jepet kompetencave digjitale në tekst. Po ashtu, rezultatet për lëndë, të cilat i parasheh Kurrikula lëndore/programi mësimor i klasës së parë dhe të dytë, pothuajse janë të njëjta, edhe pse mosha e fëmijëve ndryshon nga klasa në klasë.

Sipas tabelës nr. 2, përfshirja dhe shpërndarja e kompetencave digjitale në librat e klasës së tretë, të katërt dhe të pestë, nuk ka shumë ndryshime për nga numri i kapitujve dhe njësive, të cilat përfshijnë kompetencën digjitale. Klasa e tretë ka të përfshirë 4 kompetenca digjitale në 38 njësitë mësimore që gjithsej përfshin tekstin. Kompetencat më shumë i përkasin nivelit të njohjes (Taksonomia e Blumit). Kompetencat digjitale që janë të përfshira në këto klasë dukshëm kanë të bëjnë me përmbajtje për sigurinë në internet, ndërsa shumë pak ka përmbajtje që i informojnë nxënësit se si të mbrohen nga sulmet dhe kërcënimet në internet, që i parasheh edhe Korniza e Kompetencave Digjitale të Evropës (DigComp 2.1).

Klasa e katërt ka 38 njësi mësimore dhe 11 kompetenca digjitale dhe të gjitha kanë përputhshmëri me kompetencat e Kornizës Evropiane (DigComp2), mirëpo vetëm tri prej tyre kanë të bëjnë me zgjidhjen e problemit dhe një kompetencë ka të bëjë me krijimin e përmbajtjeve digjitale, gjegjësisht me programim që i takon nivelit më të lartë të Taksonomisë së Blumit (Krijimit/kreativitetit).

Klasa e pestë i ka 13 kompetenca digjitale, në 40 njësi mësimore; ka dy kompetenca më shumë se në klasën e katërt, që tri prej tyre i takojnë fushës së zgjedhjes së problemeve. Dy kompetenca i takojnë fushës së krijimit të përmbajtjes digjitale (programimit) dhe kompetencat e tjera i takojnë fushës së informacionit dhe komunikimit dhe bashkëpunimit. Që të gjitha kanë përputhshmëri me kompetenca digjitale të Kornizës Evropiane (DigComp2), mirëpo nivelit më të lartë sipas Taksonomisë së Blumit i takojnë vetëm pesë kompetenca digjitale (programimi, krijimi i përmbajtjes digjitale, dhe tri kompetenca për zgjidhjen e problemit).

Rezultatet tregojnë se nuk ekziston një dallim i dukshëm në numrin e njësive që përfshijnë përmbajtje me kompetencë digjitale në tekstet shkollore të klasës së parë dhe të dytë, e po ashtu edhe për klasën e tretë, deri në klasën e pestë. Kompetencat digjitale të përfshira në këto klasa dhe shkallë pothuajse janë të njëjta. Në tekstin e klasës së pestë kemi vetëm një kompetencë më shumë se në klasën e katërt, që ka të bëjë me programimin. Ky rezultat përputhet edhe me studimin Vlerësimi i Teksteve të Shkencave dhe Matematikës në Kontekst të Kompetenca Digjitale. Autorët e këtij

studimi (Çelikoglu, Tas, Ayyildiz & Yesiltas. 2022) analizuan tekstet për klasë e gjashtë dhe të tetë për përfshirjen e kompetencës digjitale në librat e shkencës dhe matematikës, që po ashtu rezultatet tregojnë se nuk ekziston një dallim i dukshëm në numrin e përmbajtjes së kompetencës digjitale në tekstet shkollore të klasave të gjashta dhe të teta.

Rezultatet që i parasheh Kurrikula lëndore/programi mësimor i lëndës Shkathtësi për jetë, për klasën e tretë, të katërt dhe të pestë, në kontekst të përfshirjes së kompetencës digjitale, janë: Nxënësit të përdorin kompjuterin personal për komunikim dhe për realizim të ndonjë projekti të vogël, ndërsa rezultatet për fushë parashohin që nxënësit të përdorin TIK-un për të avancuar cilësinë e jetës së përditshme. Po ashtu, nxënësit të përdorin kompjuterin për të krijuar projekte të ndryshme shkollore. Kompetencat digjitale që janë të përfshira në tekstet e klasës së tretë, të katërt dhe të pesë të lëndës Shkathtësi për jetë kanë përputhshmëri me kompetencat e Kornizës Digjitale të Evropës DigComp, mirëpo nuk kanë përfshirje të mjaftueshme, edhe pse kompetencat digjitale po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme, si në punë ashtu edhe në jetë, dhe bota është bërë e varur nga teknologjia.

## **Përfundim**

Në tekstet shkollore të lëndës Shkathtësi për jetë shumë pak ka përfshirje të kompetencave digjitale, të cilat kanë përputhshmëri me Kornizën Evropiane për Kompetencën Digjitale për Qytetarët (DigComp2). Në tekstet shkathtësi për jetë, të klasës së parë dhe të dytë, mungojnë përmbajtje mësimore (njësi) që u ndihmojnë nxënësve si të përdorin programet kompjuterike: Word, Exel, programimin/aplikacione dhe lojëra të ndryshme, që mund të përdorin në përditshmërinë e tyre.

Përfshirja e kompetencës digjitale në përmbajtjet e teksteve shkollore të klasës së parë dhe të dytë është shumë e mangët dhe zë shumë pak vend, si në tekste po ashtu edhe në Kurrikulën lëndore/programin mësimor, ndërsa rezultatet e arritshmërisë, sipas Kurrikulës lëndore/programit mësimor, janë të nivelit më të lartë (u takojnë pritjeve më të larta), krahasuar me nivelin e përmbajtjeve dhe hapësirën e mangët që u jepet kompetencave digjitale në

tekst. Po ashtu, rezultatet për lëndë, që i parasheh Kurrikula lëndore/programi mësimor i klasës së parë dhe të dytë, pothuajse janë të njëjta, edhe pse mosha e fëmijëve ndryshon nga klasa në klasë. Në këto tekste shkollore mungojnë tema dhe njësi mësimore që edukojnë nxënësit për rregullat e komunikimit në internet, sigurinë në internet, kodimin, programe dhe platforma/aplikacione të ndryshme për të përdorur kreativitetin në teknologji, duke u bazuar në atë se jemi duke jetuar në një kohë digjitale, kur telefonat, tabletët dhe kompjuterët kanë arritur të jenë në duart e çdo nxënësi.

Sa i përket përfshirjes së kompetencave digjitale në tekstet shkollore për klasën e tretë deri në të pestën, këto tekste kanë të integruara kompetenca digjitale, të cilat i përkasin më shumë nivelit të njohjes (Taksonomisë së Blumit), ndërsa mungon përfshirja e kompetencave digjitale më të avancuara, të cilat i ndihmojnë nxënësit për programimin dhe dizajnin digjital. Është konstatuar se ka një hendek ndërmjet përmbajtjes në tekste dhe rezultateve mësimore për TIK, që priten të fitojnë nxënësit sipas Kurrikulës lëndore/programit mësimor.

Në përgjithësi tekstet shkollore të lëndës Shkathtësi për jetë (1 - 5) shumë pak i ndihmojnë nxënësit në promovimin e shkrim-leximit digjital dhe për qytetari digjitale të përgjegjshme, në përgatitjen e tyre për kompetencat digjitale në varësi të moshës dhe nivelit të nxënësve. Sa i përket përfshirjes së kompetencave digjitale më të avancuara (kodimit dhe dizajnit digjital), në këto tekste nuk ka informacione për përgatitjen e nxënësve për këto kompetenca, kryesisht mungon kultivimi i kompetencave më të avancuara për botën digjitale, në të cilën nxënësit tanë do të përballen gjatë karrierës së tyre.

## **Rekomandime**

Meqenëse kurrikula e vendit tonë kompetencës digjitale i referohet vetëm në çështjet ndërkurrikulare përmes temave, siç është Edukimi për media, dhe realizimi i mësimi bëhet në mënyrë të integruar, atëherë rekomandohet që në përmbajtjet e teksteve shkollore të ketë më shumë integrim të

kompetencave digjitale që të ndihmojnë nxënësit dhe mësime dhënësit në zhvillimin e aftësive digjitale, për ta përdorur TIK-un në mënyrë efektive dhe të përshtatshme për të pasur akses, për të krijuar dhe komunikuar informacion dhe ide, për të zgjidhur probleme dhe për të punuar së bashku në të gjitha fushat e edukimit, në shkollë dhe në jetën përtej shkollës.

Rekomandohet që në të ardhmen të sigurohet që përmbajtja mësimore në tekste shkollore të përfshijë kompetenca digjitale që ndihmojnë në arritjen e rezultateve për lëndë dhe fushë, që i parasheh Kurrikula lëndore/programi mësimor i këtyre klasave, meqenëse është konstatuar një hendek i madh ndërmjet përmbajtjes në tekste shkollore dhe rezultateve mësimore që pritet të arrijnë nxënësit në kontekst të kultivimit të kompetencës digjitale.

Të hartohen udhëzues që të ndihmojnë mësime dhënësit në kultivimin e kompetencave digjitale për nxënësit e tyre, bazuar në atë se nxënësve u nevojiten njohuri, aftësi dhe besim në TIK për të realizuar detyrat në shkollë, në shtëpi, në punë dhe në komunitetet e tyre. Si qytetarë, ata duhet të jenë të aftë të bëjnë gjykime vetjake mbi çështjet që lidhen me ndikimin e teknologjisë në jetët e tyre, në shoqëri dhe në mjedis.

Rekomandojmë që në shkolla të hyjë si lëndë e posaçme lënda e TIK-ut, nga klasa e parë deri në të pestën, sepse Lënda Shkathësi për jetë për këto klasa nuk i përmbush kërkesat e fëmijëve për zhvillimin e kompetencave digjitale, të cilat u nevojiten për jetë

## LITERATURA:

1. Carretero, S., Vuorikari, R & Punie, Y. DigComp 2.1. The Digital Competence Framework for Citizens. European Commission., 2017. Luxemburg. Marrë nga: <https://publications.jrc.ec.europa.eu/repository/handle/JRC106281> Shkarkuar më: 07.01.2023
2. Doğan, Y., & Torun, F. (2018). Where are social studies textbooks headed? Where are social studies textbooks going?. Marrë nga: <https://dergipark.org.tr/tr/pub/jilses/issue/41927/491670>. Shkarkuar më: 25.01.2023
3. European Commission, (2006). Key competences for lifelong learning, European Communities, Belgium. Marrë nga: <https://www.voced.edu.au/content/ngv:59967> Shkarkuar më: 25.02.2023
4. Ferrari, A. (2012). Digital competence in practice: an analysis of frameworks. EC. JRC.IPTS, Seville, Spain. Marrë nga: <https://ifap.ru/library/book522.pdf>. Shkarkuar më: 13.01.2023
5. Ferrari, A. (2013). DIGCOMP: A framework for developing and understanding digital competence in Europe. Marrë nga: <http://ftp.jrc.es/EURdoc/JRC83167.pdf>. Shkarkuar më: 15.02.2023
6. Kana, F., & Kiler, B. (2021). Analysis of secondary school Turkish course books in terms of key competences in the curriculum . Analysis of secondary school Turkish course books in terms of key competences in the teaching program. International Journal of Turkish Literature, Culture and Education, 10(2), 741-755. Marrë nga: <https://files.eric.ed.gov/fulltext/EJ1327726.pdf>. Shkarkuar më: 12.01.2023.
7. Koehler, M.J., & Mishra, P. (2008). Introducing TPCK. AACTE Committee on Innovation and Technology (Ed.), The handbook of technological pedagogical content knowledge (TPCK) for educators (pp. 3-29). Mahwah, NJ: Lawrence Erlbaum Associates. Marrë nga: <https://pressbooks.pub/lidtfoundations/chapter/tpack/>
8. Ilomäki, L., Kantosalo, A., & Lakkala, M. (2011). What is digital competence? In Linked portal. Brussels: European Schoolnet. Marrë nga: <http://linked.eun.org/web/guest/in-depth3>. Shkarkuar më: 01.02.2023.
9. MASHT. (2016). Korniza Kurrikulare e arsimit parauniversitar të Republikës së Kosovës. Prishtinë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë.
10. MASHT. (2016). Kurrikula Bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor në Kosovë. Prishtinë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë.
11. MASHT. (2018). Kurrikulat lëndore/Programet mësimore, klasa e parë. Prishtinë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë.

12. MASHT. (2018). Kurrikulat lëndore/Programet mësimore, klasa e dytë. Prishtinë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë.
13. MASHT. (2019). Kurrikulat lëndore/Programet mësimore, klasa e tretë. Prishtinë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë.
14. MASHT. (2020). Kurrikulat lëndore/Programet mësimore, klasa e katërt.. Prishtinë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë.
15. MASHT. (2021). Kurrikulat lëndore/Programet mësimore, klasa e katërt.. Prishtinë: Ministria e Arsimit Shkencës dhe e Teknologjisë.
16. MASHT. ( 2011). Standarde për Tekstet shkollore. Prishtinë . Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
17. MASHT.(2022). Strategjia e Arsimit 2022-2026. Prishtinë. Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë.
18. MAS. (2014). Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Shqipërisë. (pp. 9-10). Ministria e Arsimit dhe e Sportit . Tiranë.
19. Organisation for Economic Co-operation and Development, (2002). Definition and selection of competencies (DeSeCo): Theoretical and conceptual foundations. Marrë nga : [http://www.statistik.admin.ch/statch/ber15/desecco/deseccstrate\\_gypaperfinal.pdf](http://www.statistik.admin.ch/statch/ber15/desecco/deseccstrate_gypaperfinal.pdf). Shkarkuar me: 12.02.2023
20. Organisation for Economic Co-operation and Development, (2005). The definition and selection of key competencies. Marrë nga: <https://www.Oecd.org/pisa/35070367.pdf> . Shkarkuar me: 11.01.2023
21. Otuz, B., Görkaş-Kayabaşı, B., & Ekici, G. (2018). Analysis of the skills and values of the social studies curriculum in terms of key competencies (Analysis of the skills and values of the 2017 social studies curriculum in terms of key competencies). Marrë nga: <http://acikerisim.aku.edu.tr/xmlui/handle/11630/8876> . Shkarkuar me 2.02.2023.
22. OECD (2018). The future educations and skills – Education 2030. Marrë nga: Shkarkuar me : 27.05.2023 [https://www.oecd.org/education/2030/E2030%20Position%20Paper%20\(05.04.2018\).pdf](https://www.oecd.org/education/2030/E2030%20Position%20Paper%20(05.04.2018).pdf).
23. Pala, Ş. M. (2020). The relationship between the gains in the fifth grade social studies lesson curriculum and the key competences. Marrë nga: <https://www.yumpu.com/en/document/read/49382311/fifth-grade-social-studies-curriculum> . Shkarkuar më: 06.02.2023
24. Skolverket.T. (2018). Digitaliseringen i skolan. Marrë nga: <https://www.skolverket.se/publikationer> . Shkarkuar me 22 Janar.2023.

25. Serhat Kurt (2019). TPACK: Technological Pedagogical Content Knowledge Framework. Marrë nga : <https://educationaltechnology.net/technological-pedagogical-content-knowledge-tpack-frameëork/>.Shkarkuar me: 13.05.2023
26. Shulman, L. S. (1987). Knowledge and teaching: Foundations of the new reform. *Harvard Educational Review*, 57, 1-22. Marrë nga: <https://www.rebeccaestburns.com/my-blog-3/notes/shulman-pedagogical-content-knowledge> . Shkarkuar me:24.03.2023
27. UNESCO (2018). Digital skills critical for jobs and social inclusion.
28. Marrë nga:<https://en.Unesco.org/news/digital-skills-critical-jobs-and-social-inclusion>.Shkarkuar me. 02.02.2023
29. Yalkın, B.,&Işık,A.D.(2019). Fen Bilimle ri Dersi Öğretim Programındaki Kazanımların Yaşam Boyu Öğrenme Yetkinlikleri Açısından İncelenmesi. *The Journal of Limitless Education and Research*, Marrë nga: <https://dergipark.org.tr/tr/pub/sead/issue/47078/549235>. Shkarkuar më: 11.02.2023
30. Yüksel,S.,&Taneri,A. (2020). Examination of life science textbooks in terms of key competencies (Examination of life science textbooks in terms of key competencies). *Gazi Journal of Educational Sciences*, 6(2), p. 185-209. Marrë nga : <https://eric.ed.gov/?id=EJ1268540> . Shkarkuar me 18.03.2023

## Shtojcat

### Shtojca 1. Rezultatet e plota për fushën Komunikimi organizativ, të shprehura në %

1.1. Komunikimi organizativ - Përdorimi i <i>teknologjive digjitale për të përmirësuar komunikimin me kolegët dhe/ose nxënësit dhe/ose prindërit</i>	
E di se teknologjitë digjitale mund të përdoren për komunikim organizativ (p.sh. e-mail, mesazhe të çastit, rrjetet sociale, platformat e mësimit në internet).	21.6
Jam përpjekur të përdor teknologjitë digjitale për të më ndihmuar të komunikoj me kolegët, nxënësit dhe/ose prindërit (p.sh. e-mail, mesazhe të çastit, rrjetet sociale, platformat e mësimit në internet).	22.1
Unë përdor teknologji të ndryshme digjitale sipas nevojave të mia të komunikimit organizativ (p.sh. qëllimi, objektivi dhe konteksti i komunikimit).	23
Unë analizoj dhe zgjedh teknologjitë digjitale bazuar në veçoritë dhe përshtatshmërinë e tyre për nevojat e mia të komunikimit organizativ (p.sh. komunikim efektiv, efikas dhe personal).	16.7
Unë i mbështes dhe u jap këshilla kolegëve se si të përdorin teknologjitë digjitale për komunikim organizativ (p.sh. për komunikim efektiv, efikas, të sigurt, të përgjegjshëm dhe gjithëpërfshirës në nivel shkolle).	7.0
Unë kontribuoj në zhvillimin e praktikave organizative për komunikimin duke përdorur teknologjitë digjitale (p.sh. për komunikim efektiv, efikas, të sigurt, të përgjegjshëm, gjithëpërfshirës).	8.8
Nuk jam në dijeni të kësaj kompetence.	0.9
1.2. Mjediset e të mësuarit në internet - <i>Menaxhimi i mjediseve të të mësuarit në internet, duke marrë parasysh menaxhimin e të dhënave dhe etikën</i>	
E di se gjatë menaxhimit të mjediseve të mësimit në internet duhet të merren parasysh çështjet etike dhe përdorimi i metodave të përshtatshme të menaxhimit të të dhënave (p.sh. qasja e hapur ose e kufizuar, pajtueshmëria me GDPR.)	33.8
Kam provuar raste të ndryshme për të siguruar që mjediset e mësimit në internet të përputhen me konsideratat etike dhe strategjinë e menaxhimit të të dhënave (p.sh. mbrojtja e të dhënave të përdoruesve, politika e qasjes, kushtet e përdorimit, menaxhimi i të dhënave, çështjet e privatësisë).	16
Unë administroj mjedise të mësimit në internet në përputhje me konsideratat etike dhe strategjinë e menaxhimit të të dhënave (p.sh. veçoritë e administrimit, menaxhimi i përmbajtjes dhe të dhënave të studentëve).	23.9
Unë analizoj veçoritë e mjediseve të të mësuarit në internet dhe zbatoj ato që i përgjigjen më së miri konsideratave etike dhe strategjisë së menaxhimit të të dhënave të kontekstit tim të punës (p.sh. siguria, përdoruesit dhe menaxhimi i të dhënave, politika e qasjes, mbajtja e të dhënave).	6.5

Unë mbështes dhe u jap këshilla kolegëve mbi konsideratat etike dhe praktikrat e menaxhimit të të dhënave kur përdor një mjedis të mësimin në internet (p.sh. përdorimi i fjalëkalimeve, enkriptimi, procedurat e sigurisë, transparenca e menaxhimit të të dhënave).	9.9
Unë inicioj dhe promovoj një politikë të të dhënave të nivelit të shkollës dhe kodin e sjelljes etike në mjediset e të mësuarit në internet (p.sh. menaxhimi i të dhënave personale, qasja për të gjithë, siguria, privatësia).	9.9
Nuk jam në dijeni të kësaj kompetence.	0.0
<b>1.3. Bashkëpunimi profesional - Përdorimi i teknologjive digjitale për t'u përfshirë në bashkëpunim dhe ndërveprim me kolegët dhe/ose aktorë të tjerë të arsimit</b>	
E di se teknologjitë digjitale mund të përdoren për bashkëpunim dhe ndërveprim me kolegët dhe/ose aktorë të tjerë të arsimit (p.sh. shkëmbimi i përmbajtjes përmes bashkëngjitjeve/shtojcave me e-mail).	28.1
Jam përpjekur të përdor teknologjitë digjitale për të bashkëpunuar dhe ndërvepruar me kolegë dhe/ose aktorë të tjerë të arsimit (p.sh. shkëmbimi i përmbajtjes duke përdorur shërbime në internet, ose duke marrë pjesë në rrjetet profesionale në internet).	17.6
Unë përdor teknologji të ndryshme digjitale për të bashkëpunuar dhe ndërvepruar me kolegët dhe/ose palët e tjera të interesuara, sipas nevojave të bashkëpunimit (p.sh. shkëmbimi i përmbajtjes, praktikave dhe/ose ideve).	29.1
Unë analizoj dhe zgjedh teknologjitë digjitale bazuar në veçoritë e tyre dhe mënyrën se si ato mund të mbështesin detyrat e bashkëpunimit në të cilat duhet të angazhohem me kolegët dhe/ose aktorët e tjerë të arsimit (p.sh. aktivitete bashkëpunuese në internet).	9.4
Unë drejtoj detyra bashkëpunuese me kolegët dhe/ose aktorë të tjerë të arsimit, duke përdorur teknologjitë digjitale (p.sh. bashkëpunimi dhe bashkëkrijimi i modeleve mësimore, zbatimin e projekteve të përbashkëta).	5.7
Unë inicioj dhe promovoj aktivitete bashkëpunuese midis shkollës sime dhe komunitetit të saj më të gjerë, duke përdorur teknologjitë digjitale (p.sh. rrjetet, komunitetet dhe sinergjitë, partneritetet me komunitetin lokal dhe më gjerë).	8.5
Nuk jam në dijeni të kësaj kompetence.	1.6
<b>1.4. Teknologjitë digjitale dhe infrastruktura e nivelit të shkollës - Përdorimi i teknologjive digjitale (pajisje, platforma dhe softuer) dhe infrastruktura (qasja në internet, rrjeti lokal) e disponueshme në shkollën time për të përmirësuar arsimin</b>	
Di për teknologjitë digjitale të disponueshme në shkollën time, që mund të mbështesin praktikën time profesionale (p.sh. pajisje, aplikacione, infrastrukturë).	25.3

Kam provuar të përdor teknologjitë digjitale të disponueshme në shkollën time, që mund të mbështesin praktikën time profesionale (p.sh. tabela të bardha interaktive, tableta, intranet).	17.2
Unë përdor teknologji të ndryshme digjitale të disponueshme në shkollën time, sipas nevojave të praktikës sime profesionale (p.sh. sistemin e menaxhimit të mësimi, shërbimet cloud).	18.6
Unë analizoj dhe zgjedh teknologjitë digjitale të disponueshme në shkollën time bazuar në veçoritë dhe përshtatshmërinë e tyre për të përmirësuar praktikën time profesionale (p.sh. mjediset e të mësuarit në internet, teknologjitë gjithëpërfshirëse).	15.3
Unë i mbështes dhe u jap këshilla kolegëve se si të përdorin teknologjitë digjitale të disponueshme në shkollën tonë për praktikën e tyre profesionale (p.sh. dhënie e prezantimeve, organizimin e seminareve, zhvillimin e burimeve mësimore).	5.6
Unë propozoj teknologji të reja digjitale për praktikën profesionale që do të përdoren në shkollën time (p.sh. teknologjitë e reja, aplikacionet, infrastruktura).	14.2
Nuk jam në dijeni të kësaj kompetence.	3.7
<i>1.5. Praktika reflektuese - Reflektim në praktikën time profesionale dhe kolektive me përdorimin e teknologjive digjitale</i>	
E di se reflektimi mbi mënyrën se si i përdor teknologjitë digjitale mund të përmirësojë praktikën time profesionale (p.sh. ditari në internet, reflektimet me kolegët).	41.8
Kam provuar metoda reflektimi mbi përdorimin e teknologjive digjitale për të zhvilluar më tej kompetencën time digjitale (p.sh. mjetet e vetëreflektimit në internet, ditari i reflektimit, tregimi digjital).	12.8
Unë përdor metoda të ndryshme reflektimi në mënyrë që të përmirësoj dhe të përditësoj praktikën time profesionale digjitale (p.sh. bashkëmësimdhënia, regjistrimi me video i mësimave, sesionet e raportimit me kolegë).	20.8
Unë analizoj rezultatet e reflektimit tim për të përmirësuar përdorimin e teknologjive digjitale në praktikën time profesionale (p.sh. duke analizuar komentet e kolegëve, duke përdorur mjetet e hartës së mendjes, softuerin që lejon mësimdhënësit dhe studentët të krijojnë dhe ndajnë paraqitje vizuale të ideve dhe gjërave dhe se si ato lidhen dhe ndërveprojnë me njëra-tjetrën dhe mjete të tjera që mbështesin shënime, komentet audio, ditarët në internet).	10.2
Unë i mbështes dhe u jap këshilla kolegëve për përmirësimin e përdorimit të teknologjive digjitale në praktikën e tyre profesionale përmes reflektimit kritik (p.sh. përmes forumeve të diskutimit, blloqeve, rrjeteve sociale, komuniteteve profesionale në internet).	4.5

Unë inicioj dhe kontribuoj në zhvillimin e një kulture të të mësuarit reflektues që rrit përdorimin e teknologjive digjitale në shkollën time dhe më gjerë (p.sh. studimi i mësimit, dizajni i të nxënit bashkëpunues, stërvitja, mentorimi).	6.6
Nuk jam në dijeni të kësaj kompetence.	3.3
<i>1.6. Jeta digjitale - Kontributi pozitiv dhe etik në botën digjitale, duke marrë parasysh praktikat digjitale të sigurta dhe të përgjegjshme</i>	
E di se aktiviteti im digjital mund të ketë implikime për reputacionin tim dhe atë të shkollës sime (p.sh. ndarja e informacionit privat, përdorimi i gjuhës së papërshtatshme).	23.6
Njoh rreziqet dhe kërcënimet e mundshme për reputacionin tim dhe atë të shkollës sime në lidhje me aktivitetin tim digjital (p.sh. privatësia, të dhënat personale, ngacmimi, keqinformimi).	25
Unë përdor masa lehtësuese për të mbajtur një profil digjital pozitiv (p.sh. të kuptuarit e kushteve të dhëna të përdorimit, përcjellja e gjurmëve të mia digjitale, menaxhimi i cilësimeve të mia të privatësisë).	19.3
Unë i analizoj dhe i vlerësoj gjurmët e mia digjitale për të rregulluar sjelljen time dhe për të ndihmuar në kurimin e reputacionit tim në internet dhe atë të shkollës sime (p.sh. përcjellja e gjurmëve të mia digjitale, menaxhimi i cilësimeve të privatësisë, bllokimi i përmbajtjes dhe njerëzve të dyshimtë, zbatimi i udhëzimeve të shkollës për aktivitetet digjitale).	14.2
Unë i mbështes dhe u jap këshilla kolegëve për krijimin dhe kurimin e profileve digjitale etike dhe të përgjegjshme (p.sh. prezantime, seminare, materiale mbështetëse, aktivitete).	6.2
Unë inicioj dhe promovoj strategji të nivelit të shkollës që inkurajojnë stafin dhe studentët të kontribuojnë pozitivisht, me përgjegjësi dhe në mënyrë etike në një botë digjitale (p.sh. ofroj procedura transparente të të dhënave dhe menaxhimit të përmbajtjes, zhvilloj një kod etik sjelljeje).	5.7
Nuk jam në dijeni të kësaj kompetence	6.0
<i>1.7. Të nxënit profesional (përmes teknologjive digjitale) - Përdorimi i teknologjive digjitale për të nxënit profesional</i>	
E di se teknologjitë digjitale mund të mbështesin dhe përmirësojnë të nxënit tim profesional (p.sh. mjetet dhe burimet digjitale, mjediset dhe kurset e mësimit në internet).	30
Kam provuar të përdor teknologji digjitale për mësimin tim profesional (p.sh. kërkoj informacion në internet, anëtarësohem në kurse në internet, përdor aplikacione të mësimit në internet, vizitoj bibliotekat dhe magazinat në internet).	33.5

Unë përdor teknologji të ndryshme digjitale për të mësuarit tim profesional (p.sh. diskutimet në një forum, ngarkimi i materialit, dhënia dhe marrja e komenteve, prezantimi).	16.6
Unë analizoj dhe zgjedh burimet dhe aktivitetet e të mësuarit në internet që i përshtaten më së miri nevojave të mia të të mësuarit (p.sh. webinarët, kurset interaktive në internet, komunitetet e të mësuarit në internet).	12.2
Unë mbështes dhe u jap këshilla kolegëve për përdorimin e teknologjive digjitale për mësimin e tyre profesional (p.sh. komunitetet e të mësuarit në internet, magazinat në internet, portofolet elektronike).	3
Unë inicioj dhe promovoj një plan për të mbështetur të nxënit profesional të përmirësuar në mënyrë digjitale të kolegëve të mi (p.sh. ofroj uebinarë, trajnime në internet, komunitete në internet, magazina burimesh, distinktivë digjitalë).	4
Nuk jam në dijeni të kësaj kompetence.	0.7
<i>1.8. Të nxënit profesional (për teknologjitë digjitale) - Angazhimi në aktivitete të të nxënit profesional për zhvillimin e kompetencës digjitale të mësuesve</i>	
E di se angazhimi në aktivitete të të nxënit profesional për përdorimin e teknologjive digjitale mund të zhvillojë kompetencën time digjitale (p.sh. webinarë ose seminare mbi përdorimin e teknologjive digjitale në mësimdhënie dhe mësimnxënie).	29.9
Kam ndjekur aktivitete të të nxënit profesional për përdorimin e teknologjive digjitale për të zhvilluar kompetencën time digjitale (p.sh. mikro-mësimdhënie, seminare mbi përdorimin e teknologjive digjitale në mësimdhënie dhe mësimnxënie).	24.6
Marr pjesë në aktivitete të ndryshme të të nxënit profesional formal dhe joformal në lidhje me përdorimin e teknologjive digjitale për të zhvilluar kompetencën time digjitale (p.sh. trajnim praktik mbi përdorimin pedagogjik të teknologjive digjitale, qasjet e të nxënit në internet, vlerësimi digjital).	21.5
Unë analizoj dhe zgjedh aktivitetet profesionale të të nxënit në lidhje me përdorimin e teknologjive digjitale bazuar në nevojat e mia (p.sh. përdor një mjet vetë-reflektimi për kompetencën time digjitale, vendos qëllime të të nxënit, dizajnoj të nxënit tim, reflektoj mbi të nxënit tim).	15.1
Ofroj aktivitete të të nxënit për përdorimin e teknologjive digjitale dhe mbështes kolegët në zhvillimin e kompetencës së tyre digjitale (p.sh. seminare, sesione joformale me kolegë, mikromësimdhënie mbi përdorimin e teknologjive digjitale).	2.4

Unë kontribuoj në hartimin e programeve të të nxënit profesional që synojnë zhvillimin e kompetencës digjitale të mësimdhënësve (p.sh. të nxënit e bazuar në projekte me përdorimin e teknologjive digjitale, dizajnimin e të nxënit të përmirësuar në mënyrë digjitale, shkëmbimin e praktikave të mira).	4.1
Nuk jam në dijeni të kësaj kompetence.	2.4
<i>1.9. Të menduarit kompjuterik - Angazhimi me konceptet dhe proceset e të menduarit kompjuterik si pjesë e kompetencës digjitale të mësimdhënësit</i>	
Di për konceptet dhe proceset e të menduarit kompjuterik dhe se si këto lidhen me kompetencën digjitale (p.sh. analizimi i një problemi për të gjetur një zgjidhje, njohja e aspekteve të të menduarit kompjuterik rreth nesh).	31.4
Jam përpjekur të përdor proceset e të menduarit kompjuterik për të eksploruar zgjidhjet e një problemi (p.sh. zbërthimi i një problemi, zgjidhja përmes një përkufizimi hapash, analizimi i një grupi udhëzimesh të zbatuara për një zgjidhje).	23.7
Unë përdor mjete të ndryshme digjitale për të eksploruar zgjidhjet e një problemi pas proceseve të të menduarit kompjuterik (p.sh. mjetet e programimit vizual, mjetet e autorizimit dhe redaktorët).	23.7
Unë analizoj dhe zgjedh përgjigjet e krijuara nga algoritmet (p.sh. renditja e rezultateve të kërkimit, reklamat, mënyra se si mund të përgjigjet një robot).	8.5
Unë drejtoj aktivitete të të menduarit kompjuterik në shkollën time për të mbështetur zhvillimin e kompetencës digjitale të kolegëve dhe studentëve (p.sh. klasa programimi, konkurse, hakatone).	3.5
Unë kontribuoj në hartimin dhe zhvillimin e aplikacioneve digjitale arsimore (p.sh. lojëra, aplikacione celulare, mjete vlerësimi, personalizimi i mjediseve virtuale).	3.7
Nuk jam në dijeni të kësaj kompetence.	5.5

## Shtojca 2. Rezultatet e plota për fushën Burimet Digjitale, të shprehura në përqindje

2.1. Kërkimi dhe përzgjedhja (Përdorimi i kriterëve të kërkimit dhe përzgjedhjes për të identifikuar burimet digjitale për mësimdhënie dhe mësimnxënie)	
E di se mund të kërkoj burime në internet (p.sh. duke përdorur një makinë kërkimi, duke ndjekur një vegzë, duke vizituar një magazinë burimesh).	19.9
Kam provuar të kërkoj në internet për të gjetur burime digjitale (p.sh. duke ndjekur një vegzë, duke përdorur fjalë kyçe në një makinë kërkimi, duke filtruar burimet në magazinat në internet).	15.5
Unë përdor mjete dhe portale të ndryshme në internet për të kërkuar një grup të gjerë dhe të larmishëm burimesh digjitale që u përgjigjen nevojave arsimore (p.sh. përzgjedhje me shënime të burimeve, makina të kërkimit, magazina të burimeve, bibliotekat digjitale, rrjetet sociale, komunitetet e të mësuarit).	29.2
Unë analizoj dhe zgjedh burimet digjitale bazuar në kriterë që plotësojnë synime specifike të mësimdhënies dhe të nxënit (p.sh. vlera pedagogjike, rëndësia, besueshmëria, vlefshmëria, cilësia, licencimi).	17.6
Unë reflektoj mbi rezultatet e kërkimit tim dhe ripërshtat kriteret e mia të përzgjedhjes (p.sh. duke marrë parasysh që rezultatet e mia të kërkimit mund të ndikohen nga vendndodhja ime gjeografike ose nga kërkimet dhe preferencat e mëparshme).	7.1
Unë propozoj strategji dhe mjete për të ndihmuar kolegët të kërkojnë dhe të zgjedhin burime digjitale nga burime të ndryshme në përputhje me kërkesat e kurrikulës dhe qëllimet e të nxënit (p.sh. grupe fjalësh kyçe, lista kontrolli të përzgjedhjes, rubrika të vlerësimit të burimeve digjitale, referenca në portalet e burimeve).	5.0
Nuk jam në dijeni të kësaj kompetence.	5.5
2.2. Krijimi (Krijimi i burimeve digjitale që mbështesin dhe përmirësojnë qëllimet e mësimdhënies dhe mësimnxënies)	
E di se mund të krijoj burime në formë digjitale (p.sh. tekst, imazhe, foto, audio, video digjitale).	30.4
Unë jam përpjekur të përdor mjete digjitale për të krijuar burime (p.sh. redaktues teksti, vegla redaktuese audio dhe vizuale, mjete të autorizimit multimedia).	15.4
Unë përdor mjete të ndryshme digjitale sipas veçorive të tyre për të krijuar burime digjitale për të përmbushur nevojat e nxënësve (p.sh. tekst interaktiv, prezantime multimediale, kuize, lojëra, aktivitete dhe mësim në internet).	33.2
Unë zbatoj parimet dhe proceset e projektimit për të krijuar burime digjitale për të përmbushur qëllimet e mësimdhënies dhe të nxënit (p.sh. identifikimi i një nevoje, dizajnimi, zhvillimi, zbatimi, vlerësimi, përshtatja, shkëmbimi).	12.4

Unë ndaj burimet digjitale që krijoj dhe i reflektoj e i rregulloj ato sipas reagimeve që marr (p.sh. përfshirja e qasjeve pedagogjike të përqendruara te nxënësi, të përmirësuara nga mundësitë e teknologjive digjitale).	2.8
Unë inicioj dhe kontribuoj në bashkëkrijimin e burimeve arsimore digjitale me njerëz dhe organizata përtej shkollës sime (p.sh. studiuës, botues të përmbajtjes arsimore, kompani të teknologjisë arsimore).	2.8
Nuk jam në dijeni të kësaj kompetence.	3.0
2.3 Modifikimi (Modifikimi i burimeve ekzistuese digjitale për të mbështetur dhe përmirësuar qëllimet e mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke respektuar të drejtat e autorit dhe rregullat e licencimit)	
E di se kur modifikoj burimet ekzistuese digjitale duhet të respektoj të drejtat e autorit dhe rregullat e licencimit (p.sh. shtimi i një fotografie në tekst, shtimi i përmbajtjes së re, redaktimi ose fshirja e pjesëve, shtimi i hiperlinkave).	28.4
Kam provuar mënyra për të modifikuar burimet ekzistuese digjitale, duke respektuar të drejtat e tyre të autorit dhe atributet e licencës (p.sh. redaktimi i një prezantimi, modifikimi i një imazhi, ndryshimi i formatit të një videoje, redaktimi i kuizeve, përshtatja e cilësimeve të përgjithshme).	16.2
Unë përdor mjete të ndryshme digjitale bazuar në veçoritë e tyre për të modifikuar dhe ripërdorur burimet digjitale për të përmbushur nevojat arsimore (p.sh. personalizoj përmbajtjen e një mësimi në internet, shfrytëzoj veçoritë e një mjedisi virtual, përdor redaktuesit e librave elektronikë).	16.4
Zgjedh burimet digjitale ekzistuese, duke marrë parasysh të drejtat e autorit dhe licencat e shpërndarjes, për t'i modifikuar dhe përshtatur ato për të përmbushur qëllimet e mësimdhënies dhe mësimnxënies (p.sh. burime të hapura arsimore, përmbajtje nën Licencën e Përbashkët Kreative, përmbajtje pa të drejtë autori, burime të redaktueshme).	18.9
